

LIGJ
Nr. 27/2018

PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË¹

Në mbështetje të neneve 59, pika 1, shkronja “g”, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I
QËLLIMI DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 3

Parimet në trashëgiminë kulturore

1. Zbatimi i këtij ligji bazohet në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, të politikave të qëndrueshme të zhvillimit të saj dhe sigurimin e qasjeve të barabarta të qytetarët për vlerat kulturore, duke respektuar parimet e mëposhtme:

a) Trajtim të barabartë të tipologjive të ndryshme të trashëgimisë kulturore në rrjedhën e mbrojtjes së saj;

b) Transparencë në menaxhimin e aktiviteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore;

c) Decentralizim të administrimit dhe financimit të veprimtarive, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen

1. Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/60/BE të Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian, datë 15 maj 2014, “Për kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar” dhe amendon rregulloren (EU) nr. 1024/2012. Celex: 32014L0060; Fletore Zyrtare e BE-së, L. 159, datë 28.5.2014 f. 1–10.

- Rregulloren 116/2009/BE të Këshillit të Evropës, datë 18 dhjetor 2008, “Mbi eksportin e mallrave kulturore”, Celex 3A32009R0116, Fletore Zyrtare e BE-së, seria L. 139/1, datë 10.2.2009 f. 1–7.

e trashëgimisë kulturore.

2. E drejta për akses në trashëgiminë kulturore përbën një mundësi për të përdorur vlerat kulturore, duke siguruar akses fizik ose intelektual ndaj tyre, pa i dëmtuar apo ekspozuar ato ndaj çdo rreziku.

3. Strukturat e qeverisjes qendrore e vendore dhe subjektet private krijojnë kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut te vlerat kulturore.

Neni 4

Pasuritë kulturore

1. Trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, që kanë rëndësi shkencore ose kulturore.

2. Vlerat kulturore janë “pasuri publike” dhe gëzojnë mbrojtje nga strukturat e qeverisjes qendrore e vendore në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

3. Vlerat kulturore mbarten në pasuri, të cilat mund të jenë në pronësi të shtetit, të bashkësive fetare të regjistruara, si dhe personave fizikë ose juridikë privatë.

4. Pasuritë kulturore, sitet arkeologjike dhe objektet që janë me origjinë nga nëntoka dhe hapësira ujore kombëtare e Republikës së Shqipërisë, në kuptimin e këtij ligji, përbëjnë pronë shtetërore publike.

Neni 5

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditimi i muzeve” është procesi i pavarur për vlerësimin e kritereve, i cili përcakton nëse muzeu dhe/ose aktiviteti muzeor i tij përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, edukimit, sigurisë, ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave kulturore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. “Ansambël historik urban” është një strukturë e dallueshme urbanistike-arkitekturore, pjesë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, elementet e së cilës janë në ndërlidhje të caktuara, të rëndësishme, hapësinore dhe estetike ndërmjet tyre dhe me mjedisin përreth.

3. “Arkiv” është përcaktimi sipas ligjit “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”.

4. “Artizanat” është puna, nëpërmjet së cilës objektet e nevojshme dhe dekorative janë të punuara tërësisht me dorë dhe mjete të thjeshta. Veprimtaria e artizanëve rregullohet me ligj të veçantë.

5. “Bazë të dhënash shtetërore e pasurive kulturore” është grumbullimi i organizuar i informacionit për të gjitha pasuritë kulturore kombëtare, në pronësi publike e private, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues.

6. “Bibliotekë” është përcaktimi sipas ligjit “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.

7. “Certifikatë e pasurive kulturore” është dokumenti zyrtar, i lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, që përcakton statusin juridik të pasurive kulturore, në pronësi publike dhe private, sipas dispozitave të këtij ligji dhe përmban tërësinë e të dhënave identifikuese të pasurive kulturore në Republikën e Shqipërisë, referuar kritereve dhe standardeve ndërkombëtare, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive.

8. “Dëmtimi” është tërësia e veprimeve, të qëllimta ose jo, në pasuritë kulturore, që cenojnë tërësinë ose elemente të veçanta të këtyre pasurive.

9. “Dokument regjistrimi” është çdo akt publik, vendim gjykate apo i një organi tjetër shtetëror kompetent, i lëshuar në rastet e parashikuara nga ky ligj dhe që është i detyrueshëm për regjistrimin e pasurive kulturore, sipas dispozitave të këtij ligji.

10. “Folklor gojor” është një tekst i krijuar nga populli, i pashoqëruar me muzikë, i cili përcillet gojarisht ose lexohet.

11. “Folklor instrumental” është një krijim muzikor popullor i interpretuar me vegla muzikore popullore.

12. “Folklor koreografik” janë valle dhe krijime të tjera që kërcëhen, me ose pa shoqërim muzikor.

13. “Folklor vokal” është krijimi muzikor i kënduar apo interpretuar me tekst dhe muzikë.

14. “Fond muzeor kombëtar” është e gjithë pasuria, publike dhe private, me vlera muzeore në administrim të muzeve publike ose private të akredituar, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

15. “Gërmim-shpëtimi” është misioni i shërbimit publik, pjesë përbërëse e arkeologjisë. Ai drejtohet nga parime të zbatueshme si në çdo gërmim shkencor dhe ka si objekt të sigurojë nëntokë dhe nën ujë, në afatet e duhura, zbulimin, konservimin ose ruajtjen, me anë të studimit shkencor të elementeve të trashëgimisë arkeologjike, të prekur apo që mund të preken nga punimet ndërtuese të çdo natyre apo nga planet për zhvillimin e territorit. Gërmim-shpëtimi ka, gjithashtu, si objekt, interpretimin dhe shpërndarjen e rezultateve të arritura.

16. “Gërmim arkeologjik” është ndërhyrja e plotë në nëntokën arkeologjike. Ai kryhet sipas mënyrës frontale të avancimit, zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit të mëparshëm, ose nëpërmjet parcelimit (copëzimit) të sipërfaqes arkeologjike, të diktuar prej hapave paralelë të ndërtimit. Për të gjitha këto raste, secilës njësi arkeologjike që zbulohet do t’i bëhet prerja, hulumtimi dhe dokumentimi. Ajo do të kryhet nga arkeologu (drejtuesi i gërmimit), tekniku i gërmimit, konservuesi i mjediseve arkeologjike, personeli plotësues teknik (skicograf, fotograf).

17. “Hulumtim arkeologjik” është vlerësimi i potencialit arkeologjik, vëzhgimi sipërfaqësor (sipas nocionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjeoradar etj.), sondazhet arkeologjike, gërmimi arkeologjik, monitorimi, konservimi, administrimi arkeologjik, si dhe përpilimi i dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare, deri në botimin e rezultateve.

18. “Inventarizim” është regjistrimi dhe identifikimi i objekteve të pasurive kulturore.

19. “Katalogim” është regjistrimi i të dhënave, sipas kritereve të caktuara shkencore, për identifikimin dhe administrimin e pasurive kulturore.

20. “Katalogu Kombëtar i Pasurive Kulturore” është baza e të dhënave shtetërore, që mbledh dhe administron, në nivel qendror, të dhënat mbi pasuritë kulturore kombëtare nëpërmjet Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore.

21. “Kryevlerë e trashëgimisë jomateriale” është krijimi, praktika ose dukuria e trashëgimisë jomateriale, e cila, për karakteristikat e saj të veçanta, kombëtare dhe më gjerë, gëzon statusin e mbrojtjes ligjore nga ana e shtetit.

22. “Koleksion” është një bashkësi objektivsh muzeore me karakteristika të përbashkëta në vlera historike dhe kulturore.

23. “Koleksione publike” janë ato koleksione që janë të aksesueshme për publikun, pavarësisht të drejtave të pronësisë së mbajtësit, ku përfshihen objekte me interes artistik, dokumentar, historik, shkencor.

24. “Koleksion muzeor” është tërësia e objekteve muzeore të pandashme, të cilat janë të lidhura nga një ose disa karakteristika dhe nga vlera e tyre historike, edukative dhe artistike.

25. “Kompleks historik arkitektonik” është një tërësi ndërtimesh të periudhave të njëjta, por edhe të ndryshme historike, pjesë të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, të cilat kanë një lidhje të ngushtë funksionale dhe kulturore ndërmjet tyre.

26. “Konservimi paraprak” janë të gjitha masat e ndërmarrja, që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloji dëmtimi.

27. “Konservim i integruar” është metodologjia, që nënkupton pajtimin e kërkesave të konservimit me objektivat e planifikimit dhe menaxhimit urban, të cilat duhet të kenë për qëllim krijimin e harmonisë, shmangien e funksioneve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e nivelit ekzistues të vlerave funksionale dhe

kulturore.

28. “Kthim” është kthimi fizik i pasurisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

29. “Listë kombëtare e kryevlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale që kanë status ruajtjeje të shpallur zyrtarisht nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore jomateriale, e cila krijohet, mbahet dhe përditësohet pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

30. “Listë e kryevlerave të trashëgimisë jomateriale në rrezik” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale që kanë nevojë urgjente për ruajtjen dhe transmetimin e tyre.

31. “Mbrojtja” është ndërmarrja e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit.

32. “Ministria” është ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

33. “Mirëmbajtja” janë të gjitha masat praktike dhe teknike që duhen ndërmarrë, në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh që japin kënaqësinë maksimale, pa dëmtuar vlerat kulturore. Ky është një proces i vazhdueshëm, programi i të cilit monitorohet.

34. “Monitorimi arkeologjik” është një program vëzhgimi dhe hetimi i kryer gjatë zbatimit të një projekti zhvillimor, brenda një zone të caktuar apo siti, në tokë ose nën ujë, ku ekziston mundësia që depozitimet arkeologjike mund të prishen ose të shkatërrohen. Ky proces nënkupton praninë e specialistëve arkeologë gjatë zhvillimit të punimeve të projektit deri në përfundim të gërmimeve dhe rezulton me përgatitjen e një raporti dhe arkivimin e të dhënave.

35. “Mbikqyrje arkeologjike” është procesi i këqyrjes në terren, nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe subjektet e licencuara, i proceseve arkeologjike dhe ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore, të miratuara nga organi vendimmarrës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

36. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në:

a) “Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

b) “Monument kulture i kategorisë II” është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.

37. “Muze” është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

38. “Objekt muzeor” është një pasuri e luajtshme, që pas hulumtimeve dhe vlerësimit njihet si një objekt me rëndësi kulturore e historike, që ruhet, mbrohet, administrohet dhe vlerësohet në një muze.

39. “Parandalim” është tërësia e veprimeve për kufizimin e situatave të rrezikut, të lidhura me pasurinë kulturore në kontekstin e saj.

40. “Pasuri kulturore materiale” është tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51, të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve.

41. “Pasuri kulturore jomateriale” janë vlerat kulturore jomateriale, praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, dijet, veprat, objektet, artefaktet e hapësirat kulturore që i krijojnë dhe bashkëshoqërojnë ato, të cilat, bashkësisht, grupet dhe individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Ato

krijohen dhe përcillen brez pas brezi, të ndikuara nga mjedisi e historia, të cilat u japin atyre identitet dhe vazhdimësi biokulturore.

42. “Pasuri peizazhi kulturor” është pjesë territori, karakteri i të cilave është formuar nga veprimi i faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë, si dhe nga ndërveprimi i tyre, që kanë interes historik, kulturor, natyror, morfologjik dhe estetik.

43. “Pasuri arkeologjike” janë monumente, vendbanime historike të llojeve të ndryshme, objekte ose pjesë veprash ndërtimore apo vendbanimesh, të dala prej gjurmëve arkeologjike, me vlera historiko-kulturore.

44. “Park arkeologjik” është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

45. “Partnerë strategjikë” në fushën e trashëgimisë kulturore, janë personat fizikë dhe juridikë, të cilët, nga eksperiencia e tyre në fushë, vlera dhe cilësia e sponsorizimit, marrëveshja e gjatë e bashkëpunimit, shkëmbimi i vlerave intelektuale dhe burimeve njerëzore e financiare, intensiteti dhe kohëzgjatja e bashkëpunimit me Qeverinë Shqiptare ose ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e saj të varësisë, vlerësohen si thelbësorë në zbatimin e politikave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sigurimin e objektivave të përbashkëta në zhvillimin e fushës.

46. “Plani i menaxhimit” është një dokument që përcakton në detaje të gjitha strategjitë dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë dhe, në të njëjtën kohë, duke iu përgjigjur nevojave të jetës bashkëkohore. Ai përmban dokumentet legjislative, financiare, administrative dhe të ruajtjes, përveç planeve të ruajtjes dhe monitorimit.

47. “Politika të ruajtjes” janë ndërhyrje në shkallë të ndryshme, intensiteti i të cilave përcaktohet nga gjendja fizike, shkaqet e përkeqësimit dhe pritshmëria për të ardhmen e pasurisë kulturore që është duke u trajtuar.

48. “Qendër historike” është territor i dallueshëm urban, përfaqësues e një periudhe historike ose një faze të zhvillimit të qytetit/fshatit, që përbëhet nga elemente të trashëgimisë kulturore materiale, ku përfshihen, përveç strukturës urbane, elemente arkitektonike, mjedisore, kulturore, historike, peizazhe, brenda dhe rreth zonës, dëshmitë arkeologjike, panoramat, profilet urbane, perspektivat dhe pikat e referencës.

49. “Raport vjetor i menaxhimit dhe ruajtjes së koleksionit” është raporti që hartohet nga çdo muze publik e privat dhe prezantohet pranë Këshillit Kombëtar të Muzeve. Të dhënat e raportit vjetor verifikohen nga një grup ekspertësh të Ministrisë së Kulturës në mënyrë periodike.

50. “Restaurim” është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.

51. “Regjistri kombëtar i pasurive kulturore” është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e çdo certifikate pasurie kulturore, të krijuara në letër dhe/ose në formë elektronike, në pronësi publike e private, materiale dhe jomateriale në Republikën e Shqipërisë. Përcakton qëndrueshmërinë në terma cilësorë dhe sasiorë të pasurive kulturore kombëtare, si dhe përgjegjësinë e institucioneve që i posedojnë për regjistrim e përditësim.

52. “Rijetëzimi” është dhënia në përdorim e pasurisë kulturore për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.

53. “Ruajtja” është proces i vazhdueshëm, sistematik, i koordinuar dhe i programuar hulumtimi, studimi, kërkimi, dokumentimi, regjistrimi, parandalimi, mirëmbajtjeje, konservimi, restaurimi, përshtatjeje dhe vlerësimi të trashëgimisë kulturore.

54. “Ruajtje të trashëgimisë jomateriale” janë masat që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë

kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, vlerësimin, përcjelljen, nëpërmjet edukimit formal e joformal, si dhe rigjallërimin e aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie.

55. “Ruajtja e objekteve muzeore” është tërësia e veprimeve, që nga momenti kur një objekt muzeor hyn në muze, në lidhje me fitimin e pronësisë, regjistrimin në katalogun kombëtar, regjistrimin në listën kombëtare të pasurive kulturore, magazinimin, konservimin dhe restaurimin.

56. “Site” janë vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.

57. “Thesar kombëtar” është një vlerë kulturore me rëndësi të veçantë për shkencën, kulturën, natyrën ose zhvillimin teknologjik, shkatërrimi i së cilës, dëmtimi ose humbja do të përbënte humbje të pariparueshme për shoqërinë.

58. “Trashëgimi arkitektonike” janë pasuritë e përhershme si më poshtë:

a) Monumente: të gjitha ndërtesat dhe strukturat me interes të spikatur historik, arkeologjik, artistik, shkencor, social ose teknik, duke përfshirë edhe anekset e tyre dhe pajisjet;

b) Grupe ndërtesash: grupe homogjene të ndërtesave urbane ose rurale, të dukshme për interesin e tyre historik, arkeologjik, artistik, shkencor, social ose teknik, të cilat janë mjaft koherente për të formuar njësi topografike të caktueshme;

c) Sitet: vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.

59. “Trashëgimi kulturore” është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individit, grupit ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruan në të tashmen, për t’u përçarur brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

60. “Trashëgimi arkeologjike” është pjesë e trashëgimisë kulturore, elemente të së cilës janë të gjitha gjurmët e ekzistencës së njerëzimit, ruajtja dhe studimi i të cilave lejojnë ndjekjen e zhvillimit të historisë së tij dhe marrëdhëniet e njerëzimit me mjedisin natyror.

61. “Veprimtari arkeologjike nënujore” janë gërmimet, sondazhet, kërkimet, zhvendosjet dhe shfaqjet në zonën arkeologjike nënujore.

62. “Trashëgimi kulturore nënujore” janë të gjitha gjurmët e ekzistencës njerëzore, të cilat kanë një karakter kulturor, historik ose arkeologjik, që kanë qenë pjesërisht ose plotësisht nën ujë, periodikisht ose vazhdimisht, për të paktën 100 vjet, si:

a) Objektet e karakterit parahistorik, vendet, strukturat, ndërtesat, veglat e punës dhe mbetjet njerëzore, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror;

b) Anijet, avionët ose mjete të tjera, ose pjesë të tyre, ngarkesa e tyre apo përmbajtje të tjera, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik e natyror.

Tubacionet dhe kabllot e vendosura në shtratin detar nuk konsiderohen si trashëgimi kulturore nënujore. Instalimet e ndryshme nga tubacionet dhe kabllot, të vendosura në shtratin detar dhe që vazhdojnë të përdoren, nuk konsiderohen trashëgimi kulturore nënujore.

63. “UNESCO” është Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara.

64. “Vlerë kulturore” është:

a) Dëshmi materiale e jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, fenomene apo peizazhe, të cilat janë të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë dhe kanë vlerë shkencore apo kulturore;

b) Dëshmi materiale ose jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, e cila është domethënëse për institucionet fetare të regjistruara;

c) Fragmente të objekteve arkeologjike, etnografike apo objekteve të tjera, që janë të fragmentarizuara, të cilat përbëjnë një pjesë të vogël të autenticitetit të objektit origjinal, që janë dëmtuar në masë të madhe, pa ndonjë vlerë të rëndësishme kulturore, shkencore ose artistike, dhe pjesa më e madhe e tyre mund të përkufizohet si materiale. Këto nuk janë subjekt i identifikimit, por janë të tilla kur janë pjesë e fondeve muzeore.

65. “Vlerësimi” është ushtrimi i funksioneve dhe veprimtarive që kanë për qëllim promovimin e zhvillimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimin e kushteve më të mira për përdorimin dhe gëzimin publik të saj. Në lidhje me peizazhin kulturor, vlerësimi përfshin, gjithashtu, rikualifikimin e objekteve të paluajtshme dhe të hapësirave të vendosura në mbrojtje, të dëmtuara ose degraduara.

66. “Zonë arkeologjike” është vendi ose peizazhi natyror ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gërmuara ose jo, që janë gjendur ose gjenden në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujërat territoriale shqiptare, që mund të studiohen duke përdorur metoda arkeologjike.

67. “Zonë mbrojtëse” është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe monumentit të kulturës, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku.

Neni 6

Aksesi i publikut në trashëgiminë kulturore

1. Pasuritë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në pronësi shtetërore janë të destinuara për shfrytëzim nga ana e publikut, në përputhje me nevojat e përdorimit, me përjashtim të rasteve kur nevojat e mbrojtjes e ndalojnë atë.

2. Për pasuritë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në pronësi private, ndonëse i nënshtrohen regjimit ligjor të parashikuar nga Kodi Civil, interesi publik i vlerave kulturore që këto prona mbartin legjitimon kufizimin e ushtrimit të tagrave të pronarëve të ligjshëm, në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në këtë ligj.

3. Pronarët dhe poseduesit e pasurive kulturore në pronësi private, përfshirë bashkësitë fetare të njohura zyrtarisht, kanë detyrimin të garantojnë ruajtjen e këtyre pronave dhe vlerave që ato mbartin dhe të bashkëpunojnë me institucionet publike të specializuara për të kryer mbrojtjen, vlerësimin dhe aksesin në pasuritë kulturore.

Neni 7

Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive kulturore

1. Ruajtja e pasurive kulturore është procesi sistematik i kërkimit, studimit, identifikimit, dokumentimit, regjistrimit, konservimit, restaurimit dhe përshtatjes.

2. Mbrojtja e pasurive kulturore është sistemi i masave të ndërmarra, përfshirë iniciativat ligjore, të cilat synojnë harmonizimin e praktikave të vlefshme për sigurimin e ruajtjes së këtyre pasurive për shfrytëzim me interes publik.

Neni 8

Vlerësimi i trashëgimisë kulturore

1. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore është ushtrimi i atyre funksioneve e aktiviteteve që kanë si qëllim njohjen dhe promovimin e pasurisë kulturore dhe që sigurojnë kushtet më të mira të shfrytëzimit publik të pasurive e vlerave kulturore për një zhvillim të qëndrueshëm.

2. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore kryhet në forma që garantojnë dhe nuk vështirësojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore.

3. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore të peizazhit përfshin dhe rikualifikimin e ndërtesave dhe siteve

të rrënuara ose rivlerësimin e vlerave të reja apo të integruara të peizazhit.

4. Shteti nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e subjekteve private, individualisht apo të organizuara, në vlerësimin e trashëgimisë kulturore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Shteti mund të krijojë dhe subjekte juridike, me qëllim vlerësimin/administrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira botërore.

Neni 9

Politikat mbi trashëgiminë kulturore

1. Politikat shtetërore në fushën e trashëgimisë kulturore udhëhiqen nga Këshilli i Ministrave. Këto politika zbatohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore e vendore, si dhe me shoqërinë civile.

2. Qëllimet strategjike të administrimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore parashikohen në strategjinë kombëtare mbi kulturën, të hartuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Këshilli i Ministrave:

- a) Miraton plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore të paluajtshme;
- b) Krijon institucione dhe subjekte juridike me propozim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- c) Miraton kalimin në administrim të pasurive kulturore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- ç) Deklaron pasuritë kulturore të paluajtshme, të grupuara sipas parashikimeve të këtij ligji;
- d) Krijon, mbyll dhe riorganizon muzetë publike në Republikën e Shqipërisë;
- dh) Ushtron çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë ligj.

Neni 10

Pasuritë kulturore të klasifikuara “me rëndësi universale”, “me rëndësi kombëtare” dhe “thesare kombëtare”

1. Me propozimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kalimin e pasurive kulturore të paluajtshme me vlera arkeologjike dhe atyre që gëzojnë statusin “me rëndësi universale” ose “me rëndësi kombëtare”, në pronësi shtetërore, në administrim institucioneve publike qendrore, pushtetit vendor, subjekteve juridike, të themeluara prej tyre, me qëllim miratimin, vlerësimin dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse konservuese e mbrojtëse të vlerave kulturore.

2. Aktivitetet përkatëse ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, sipas pikës 1, të këtij neni, si dhe çdo aktivitet tjetër shkencor, kulturor, arsimor, si dhe aktivitetet e lidhura me turizmin, do të kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

3. Kriteret dhe procedurat standarde të kalimit të pronës në administrim miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Pasuria kulturore e paluajtshme, e kaluar në administrim sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mund të përdoret për qëllime të ndryshme apo të administrohet nga subjekte të ndryshme nga ato të përcaktuara në aktin e kalimit.

5. Në rast shkeljeje, mospërbushjeje të çdo parashikimi të marrëveshjes ose keqadministrim të pasurisë kulturore, të konstatuara nga Inspektorati Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore ose institucionet e specializuara, kjo marrëveshje zgjidhet sipas procedurës së parashikuar në të.

6. Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurisë kulturore, sipas pikës 1, të këtij neni, administrohen nga subjekti që administron pasurinë, me qëllim kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve për ruajtjen e mbrojtjen e pasurive kulturore.

Neni 11

Funksioni i institucioneve publike

1. Shteti siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

2. Autoritetet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.

3. Shteti siguron marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura. Këto masa ruajtëse propozohen nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ministri përgjegjës për mbrojtjen, ministri përgjegjës për punët e brendshme dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Funksionet e ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

2. Ministri i ushtron këto funksione vetë ose nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore.

3. Ministria ushtron funksionet e mbrojtjes për pasuritë kulturore në pronësi shtetërore edhe pse ato mund t'u jenë huazuar apo dhënë në përdorim subjekteve juridike të ndryshme nga ministria. Në ushtrim të këtij funksioni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore monitoron dhe vlerëson periodikisht veprimet e subjekteve në administrim të pasurive kulturore dhe i rekomandon autoritetit kontraktues vazhdimin apo ndërprerjen e marrëdhënies juridike me subjektin privat apo publik. Rregullat e monitorimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

4. Në ushtrim të funksioneve të parashikuara me këtë ligj, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me iniciativë apo kërkesë të partnerëve strategjikë, themelon subjekte juridike, të cilat kanë si qëllim vlerësimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore. Rregullat e administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimi i këtyre subjekteve juridike rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Titulli i pronës së pasurive kulturore i mbetet shtetit, në çdo rast.

5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me QKVT-në, merr masa dhe krijon kushte lehtësuese për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale jashtë kufijve të vendit, të grupeve apo bartësve popullorë, për pjesëmarrje në turne, festivale apo takime ndërkombëtare të kësaj fushe.

Neni 13

Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore:

- a) Harton strategjinë kombëtare të kulturës;
- b) Propozon regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të vlerave materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore kombëtare;
- c) Deklaron “pasuri kulturore” dhe “thesare kombëtare” për vlerat kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme;
- ç) lëshon licenca për veprimtaritë arkeologjike në vend;
- d) Lëshon licenca për riprodhimin e vlerave kulturore;

- dh) Lëshon licenca për subjektet private për projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim të punimeve të mbrojtjes e ruajtjes, sipas parashikimeve të këtij ligji, në objektet me pasuri kulturore pas deklarimit;
- e) Lëshon licenca për ekspert vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme;
- ë) Lëshon licenca për subjektet tregtare të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme;
- f) Lëshon leje për prezantimin e vlerave kulturore në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare;
- g) Lëshon leje dhe autorizime të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- gj) Harton planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore;
- h) Ndjek zbatimin e kontratave të rjetëzimit, në përputhje me këtë ligj;
- i) Koordinon, organizon dhe mbikëqyr aktivitetet që lidhen me:
 - i. kthimin e vlerave kulturore të luajtshme “thesare kombëtare”, të eksportuara në mënyrë të paligjshme;
 - ii. mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, lidhur me historinë shqiptare dhe kulturën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - iii. monitorimin e vlerave të paluajtshme kulturore;
 - iv. metodologjinë dhe përcaktimin e rregullave për ruajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore dhe mjedisin e tyre;
- j) Koordinon:
 - i. termat e referencës për planet e projektimit, ruajtjes dhe planet menaxhuese, skemat e ndarjes, planet dhe ndryshimet e tyre, rregullat e normat e tyre specifike dhe projektet e zhvillimit, në respekt me vlerat kulturore të paluajtshme, të vetme dhe të grupit, brenda kufijve të tyre dhe zonat e ruajtura, sipas rasteve të përcaktuara si më poshtë;
 - ii. termat e referencës për projektimin e ndërtesave-muze dhe ekspozita të përthershme të saj;
 - iii. projektet e zhvillimit për ndërtimin dhe vendosjen e monumenteve, strukturat monumentale-dekorative dhe elementet në hapësirat publike, në zonat urbane dhe jurbane, si dhe mënjanimin ose heqjen e tyre;
- k) Ka përgjegjësinë e administrimit të pronave publike me vlera kulturore;
- l) Kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore;
- ll) Ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar nga ky ligj.

Neni 14

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore , sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Funksionet e ruajtjes e të mbrojtjes, të parashikuara në këtë ligj, të cilat kanë si objekt dorëshkrime, autografe, korrespondenca, libra të shtypur para vitit 1500, koleksione bibliotekare, si dhe libra të tjerë, vula, gdhendje, harta gjeografike, partitura muzikore, fotografi, pelikula dhe materiale të tjera audiovizive, të cilat nuk i përkasin pushtetit qendror, ushtrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të marrëveshjeve specifike me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Përveç parashikimeve më sipër, mund të identifikohen mënyra të tjera koordinimi dhe bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së pasurive kulturore.
3. Funksionet administrative dhe mbrojtja e pasurive kulturore të peizazhit ushtrohen nga pushteti qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, duke siguruar një qeverisje uniforme dhe të përshtatshme me synimet që kërkohen të arrihen.
4. Në lidhje me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas para-shikimeve

të pikës 2, të këtij neni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron kompetencat e ruajtjes, të mbrojtjes, si dhe të ndërhyrjes zëvendësuese, në raste mosveprimi të vazhdueshëm ose në rastet e mospërfundimit brenda afateve ligjore të ndërhyrjeve të ndryshme në pasuritë kulturore.

Neni 15

Trashëgimia kulturore e bashkësive fetare

1. Bashkësitë fetare të regjistruara me ligj i propozojnë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore regjistrimin e vlerave kulturore të rëndësishme, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Autoritetet, sipas pikës 1, të këtij neni, në konsultim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, miratojnë rregullat për administrimin e vlerave kulturore nga ana e tyre, si dhe krijojnë organe për administrimin, në përputhje me objektivin për ruajtjen e tyre.

3. Brenda gjashtëmuajorit të parë të çdo viti, bashkësitë fetare i paraqesin ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore një raport mbi aktivitetet e tyre për ruajtjen e vlerave kulturore gjatë vitit paraardhës.

Neni 16

Shprehje të identitetit kulturor kolektiv

1. Shprehjet e identitetit kulturor kolektiv, të përfshira në konventat e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe për mbrojtjen dhe promovimin e identitetit kulturor, janë pjesë e dispozitave të këtij ligji, nëse prezantohen si dëshmi materiale dhe përmbushin kushtet për zbatimin e parashikimeve të nenit 51 të tij.

2. Vlerat e krijuara nga pakicat kombëtare në Shqipëri konsiderohen si pjesë të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Neni 17

Lista përfaqësuese e dukurive kulturore jomateriale të UNESCO-s

Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ndërmerr nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe për regjistrimin, ndryshimin e emërtesave të këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të propozimeve për regjistrimin e këtyre dukurive, mbështetur në kriteret e parashikuara nga konventa “Për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale”.

Neni 18

Financimi i veprimtarive të fushës së trashëgimisë kulturore

Financimi i veprimtarive në fushën e trashëgimisë kulturore nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik, por dispozitave të këtij ligji.

Neni 19

Fondi kombëtar i kujdesit për trashëgiminë kulturore materiale

1. Për të siguruar ruajtjen e vlerave kulturore materiale krijohet “Fondi kombëtar i kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, në formën e një fondi financiar publik, që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale.

2. Burimet e financimit të fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale janë:

- a) Të ardhurat e krijuara nga vendet e artit e të kulturës, në kuptim të këtij ligji, si dhe muzetë;
- b) Financime vendase apo të huaja për këtë qëllim, të cilat burojnë në mënyrë të ligjshme nga organizata publike, private ose persona fizikë;
- c) Buxheti i shtetit.

3. Ky fond krijohet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe administrohet sipas

rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Financimi për trashëgiminë kulturore

1. Fondet për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, ekspozimin, prezantimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore sigurohen nëpërmjet buxhetit të shtetit, buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm nga persona juridikë apo fizikë, vendas ose të huaj, përfutuar në formën e donacioneve ose sponsorizimeve.

2. Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore vlerëson projektet e propozuara, të paraqitura nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore është përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e këtyre projekteve, në baza proporcionale, nga buxheti i saj.

3. Pezullimi i aktivitetit për më shumë se 90 ditë, nga subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në pasuritë kulturore të paluajtshme, veçmas apo të grupuara, përbën shkelje, dhe subjekti përgjegjës mban përgjegjësi në përputhje me këtë ligj.

4. Të ardhurat e krijuara nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucioneve të specializuara në varësi të saj dhe në administrim të institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve publikë janë të ardhura dytësore dhe shkojnë në favor të fondit të trashëgimisë kulturore, të parashikuar në nenin 19 të këtij ligji.

5. Të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e fondacioneve të krijuara në bazë të këtij ligji rregullohen në bazë të marrëveshjes së fondacionit me institucionin publik, sipas parashikimeve të këtij ligji.

TITULLI II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRONARËVE DHE POSEDUESVE TË PASURIVE KULTURORE

Kreu I

Pasuritë e paluajtshme

Neni 21

Të drejtat e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore

Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme kulturore kanë të drejtë:

a) Të përfitojnë konsultime, ekspertiza dhe rekomandime nga autoritetet kompetente për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave kulturore;

b) Të përfitojnë të ardhurat e marra nga biletat e hyrjes, materialet promovuese, si dhe riprodhimet e vlerës kulturore në formë fotografike, kompjuterike, videoje ose me çdo mjet tjetër riprodhimi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) Të aplikojnë për mbështetje financiare, në kuadër të programeve të financuara nëpërmjet buxheteve të qeverisjes qendrore apo vendore ose burimeve të tjera, për qëllime të kryerjes së emergjencës ose të konsolidimit, konservimit dhe restaurimit të nevojshëm për mbrojtjen e vlerës kulturore;

ç) Të marrin ndihmë financiare ose të ardhura të tjera, në formën e donacionit apo sponsorizimit nga persona dhe institucione të veçanta.

Neni 22

Detyrimet e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore

1. Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme kulturore:

a) Kujdesen për të ruajtur dhe mbajtur në gjendje të mirë pasuritë kulturore, duke respektuar

dispozitat e këtij ligji;

b) Informojnë institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, inspektoratin përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për çdo dëmtim, zbulim, apo çdo veprim të parashikuar në këtë ligj;

c) Koordinohen në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, për hartimin, miratimin e projekteve të ndërhyrjeve dhe zbatimin e punimeve me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore;

ç) Bashkëpunojnë me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore për ushtrimin e të drejtave të tyre dhe zbatimin me efikasitet të detyrimeve që lindin nga ky ligj;

d) Paraqesin dokumentacionin e nevojshëm dhe vënë në dispozicion pasurinë për verifikim dhe për të siguruar mbështetjen e autoriteteve përkatëse në ushtrimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj;

dh) Ofrojnë akses për publikun në rastet e parashikuara në këtë ligj;

e) Sigurojnë akses të lirë dhe akses me pagesë për publikun në lidhje me vlerat kulturore të paluajtshme për qëllime kërkimore, me kusht që kjo të mos dëmtojë interesat legjitime të pronarit ose poseduesit.

2. Në rast të dëmtimit ose shkatërrimit të pasurisë kulturore për arsye të mospërmbushjes së detyrimeve të tyre, pronarët ose poseduesit e pasurisë kulturore detyrohen ta rivendosin atë në formën e saj origjinale, nëse është e mundur, me parametrat e saj origjinale hapësinore, tiparet arkitektonike dhe artistike, brenda një afati kohor që përcaktohet në kushtet e lejes së ndërhyrjes.

3. Pronarët ose poseduesit e pasurive të paluajtshme, në të cilat është zbuluar një vend arkeologjik ose një objekt, apo ka të dhëna të ekzistencës së një vendi apo objekti të tillë, detyrohen të zbatojnë parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Pronarët ose poseduesit e pasurive të paluajtshme, në të cilat është ruajtur dhe shfaqet një vlerë e paluajtshme arkeologjike, sigurojnë aksesin e publikut, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 23

Detyrimi për njoftim dhe kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse

1. Në rast të paraqitjes së rrethanave të rrezikut të dëmtimit të një pasurie kulturore të paluajtshme ose shkatërrimit të saj, pronari, ose poseduesi i pasurisë së paluajtshme përkatëse, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore dhe institucionet e tjera të specializuara, ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të siguruar pasurinë kulturore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Në rastin e mosveprimit nga ana e pronarit, poseduesit të pasurisë kulturore dhe kryerjes nga ana e shtetit të projektimit e zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, me fonde publike apo të siguruar nga partnerët e tij, bazuar në dispozitat e Kodit Civil për mjetet për garantimin e detyrimeve, për të siguruar arkëtueshmërinë e shpenzimeve të bëra, vendoset një barrë ligjore mbi pasurinë kulturore, e barabartë me vlerën e certifikuar të shpenzimit. Të drejtat e pronarit, poseduesit, sigurohen nëpërmjet zbatimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj.

Kreu II

Pasuritë e luajtshme

Neni 24

Të drejtat e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore të luajtshme

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët janë pronarë ose posedues të koleksioneve apo pasurive të veçanta, të luajtshme, kulturore, të regjistruara në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kanë të drejtë:

a) Të kërkojnë ofrimin e konsultimeve, ekspertizën dhe rekomandimet nga ana e autoriteteve kompetente për ruajtjen e vlerave kulturore;

b) Të ofrojnë pasuritë për ruajtje të përkohshme në një muze, kur nuk kanë mundësi për të siguruar ruajtjen e sigurt e të duhur, për arsye që nuk varen prej tyre;

c) Të shfaqin pasuritë kulturore përkohësisht në muzetë publikë dhe privatë, në zbatim të marrëveshjeve paraprahe me shkrim;

ç) Të kërkojnë kompensim për ekspozimin e pasurisë kulturore në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare;

d) Të aplikojnë për mbështetje financiare, me qëllim ruajtjen e pasurisë kulturore, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare;

dh) Të kërkojnë ndihmë nga organet kompetente për rikthimin e pasurive kulturore, në rast të vjedhjes ose trafikimit të paligjshëm.

2. Pronari i një objekti të lidhur me një koleksion apo koleksione, nëse është i ndryshëm nga pronari i koleksionit, ka të drejtë:

a) Të kërkojë vlerësim shkencor pranë komisionit të vlerësimit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, sipas tarifave të miratuara me akt nënligjor;

b) Të depozitojë për ruajtje, pa pagesë, objektin e lidhur me koleksionin apo koleksionet pranë muzeut që posedon koleksionin ose, në pamundësi nga ky i fundit, në një muze publik, pas miratimit nga ana e Këshillit Kombëtar të Muzeve;

c) Të kërkojë muzeut që posedon koleksionin udhëzime të specializuara në lidhje me ruajtjen profesionale të objektit/eve;

ç) Të bëjë të disponueshëm për publikun objektin e lidhur me koleksionin.

Neni 25

Detyrimet e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore të luajtshme

1. Personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë pronarët ose poseduesit e koleksioneve apo pasurive kulturore të veçanta të luajtshme, kanë këto detyrime:

a) Të ruajnë pasurinë kulturore me shpenzimet e tyre dhe në mirëbesim, si dhe të përmbushin udhëzimet e dhëna për ruajtjen e sigurinë e tyre;

b) Të sigurojnë akses dhe të ndihmojnë autoritetet mbikëqyrëse në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore;

c) Të informojnë autoritetet kompetente në rast dëmtimi;

ç) Të bashkëpunojnë me IKRTK-në për identifikimin, regjistrimin, katalogimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore të Luajtshme.

2. Pronari ose poseduesi i një objekti të lidhur me koleksionin apo koleksionet, të regjistruar sipas parashikimeve të këtij ligji, është i detyruar ta mbrojë këtë pasuri kundër dëmit, zhvlerësimit dhe vjedhjes.

TITULLI III

INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 26

Sistemi kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore

1. Sistemi kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore përfshin autoritetet shtetërore qendrore, autoritetet e vetëqeverisjes vendore, për pronat që ato kanë në pronësi dhe administrim, institucionet e specializuara, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe bashkësitë fetare të regjistruara me ligj.

2. Autoritetet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kryejnë aktivitetet e tyre në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Akademinë e Studimeve Albanologjike, institucionet përgjegjëse për arsimin e lartë, sindikatat, shoqatat profesionale dhe organizatat e tjera jofitimprurëse.

3. Autoritetet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, kryejnë aktivitetin e tyre në përputhje

me objektivat e këtij ligji dhe me strategjinë kombëtare të kulturës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore

1. Inspektorati Kombëtar Përgjegjës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKMTK-ja), është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. IKMTK-ja ushtron këto kompetenca:

a) Inspekton ecurinë e gërmimeve arkeologjike në tokë dhe ato nënujore;
b) Zbaton masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar;
c) Zbaton masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, fonde muzeore, fonde të arkivave, fonde të bibliotekave dhe çfarëdolloj fondi tjetër;

ç) Zbaton masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme;

d) Zbaton parashikimet e kontratave të nënshkruara nga autoritete të ndryshme shtetërore, në kuptim të këtij ligji, të marrëveshjeve të administrimit, rijetëzimit, përdorimit dhe të çdo lloj forme tjetër marrëveshjeje të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me institucione publike e private;

dh) Zbaton masat mbrojtëse të vlerave kulturore bibliografike e letrare, që mbahen në biblioteka dhe arkiva, dorëshkrime, artikuj të arkivit dhe libra të vjetër të shtypur;

e) Zbaton masat për regjistrimin e pasurive kulturore pranë IKMTK-së;

ë) Zbaton procedurat e qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme;

f) Kontrollon ligjshmërinë e transaksioneve që përfshijnë vlerat e luajtshme kulturore;

g) Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë ligj.

3. Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ushtron kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të IKMTK-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe u nënshtrohet dispozitave të Kodit të Punës dhe ligjit mbi Inspektimin në Republikën e Shqipërisë. Kryeinspektori emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Struktura dhe organika miratohet me urdhër të Kryeministrit.

Neni 28

Institucione të specializuara

1. Institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore janë:

a) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;

b) Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

c) Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore;

ç) Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale;

d) Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar;

dh) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë;

e) Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Arteve;

ë) Instituti i Arkeologjisë.

2. Funksionimi dhe mënyra e zhvillimit të veprimtarisë së institucioneve të specializuara, parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të pikës 1, të këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e tyre miratohet me urdhër të Kryeministrit.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

1. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, më poshtë IKTK, është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

3. IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

4. IKTK-ja harton kriteret e hulumtimeve arkeologjike, shqyrton dokumentacionin teknik në lidhje me to, si dhe kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike dhe ecurisë së projekteve zhvillimorë, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.

5. IKTK-ja shtrin kompetencën në fushën e arkeologjisë parandaluese nënujore në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të këtij ligji. Pranë IKTK-së krijohet Sektori i Arkeologjisë Parandaluese Nënujore, në përputhje me funksionin e tij.

6. IKTK-ja, në mbështetje të informacionit të siguruar nga veprimtaria e tij, nga institucionet e specializuara që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik, si dhe nga subjektet e licencuara në fushën e arkeologjisë, harton, përditëson dhe publikon platformën digjitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë. Institucionet dhe subjektet e sipërpërmendura kanë detyrimin të depozitojnë, rregullisht, pranë IKTK-së të dhënat në formën digjitale, pas çdo aktiviteti nga veprimtaria e kërkimit arkeologjik.

7. IKTK-ja, në përmbushje të funksioneve të veta, monitoron dhe bashkërendon punën me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

8. Pranë IKTK-së funksionon Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim (QRKR), që kryen këto funksione:

a) Formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) Harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

9. Mënyra e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së QRKR-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. IKTK-ja, për të kryer funksionet sipas këtij ligji, mbledh tarifën, sipas parashikimeve të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

11. IKTK-ja funksionon në bazë të dispozitave të këtij ligji, si dhe statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

IKTK -ja ka këto kompetenca:

1. Asiston ministrin në ushtrimin e kompetencave të tij për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

2. Propozon ndryshime në legjislacionin për trashëgiminë kulturore materiale.

3. Zbaton konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, si dhe propozon mënyrën e implementimit të këtyre konventave në legjislacionin kombëtar.

4. Bashkërendon punën për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore në pasuritë kulturore kombëtare me rëndësi universale.
5. Gjurmon, hulumton, studion dhe përgatit vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes.
6. Harton dhe propozon standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale.
7. Harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, terma reference, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel kombëtar e vendor.
8. Harton plane menaxhimi në bashkëpunim me institucione të vetëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj.
9. Kryen punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore të luajtshme.
10. Kryen kontrollin teknik, mbikëqyr dhe kolaudon punimet në pasuritë kulturore materiale.
11. Mirëmban arkivin teknik kombëtar të vlerave kulturore materiale.
12. Harton, publikon e përditëson sistemin e informacionit digjital dhe hartën digjitale në lidhje me trashëgiminë kulturore materiale të paluajtshme.
13. Mban regjistrin publik të vlerave kulturore materiale.
14. Mban regjistrin e subjekteve të licencuara për hartimin e projekteve dhe kryerjen e punimeve në pasuritë kulturore materiale.
15. Mban regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale.
16. Harton dhe mban regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të paluajtshme.
17. Harton dhe përditëson listën e qendrave të restaurimit e të konservimit, të autorizuara të kryejnë restaurimin dhe konservimin e pasurive kulturore të luajtshme.
18. Siguron mbarëvajtjen e proceseve arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.
19. Përcakton kriteret e kryerjes së kërkimeve dhe siguron respektimin e mbikëqyrjes së proceseve arkeologjike e të ecurisë së zbatimit të projekteve zhvillimore.
20. Bashkërendon veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të trashëgimisë kulturore për riorganizimin në aspektin muzeor të trashëgimisë arkeologjike, si dhe siguron pasurimin e fondeve për ruajtjen e objekteve arkeologjike të luajtshme.
21. Përcakton zonat ku projektet e zhvillimit janë objekt i hulumtimeve arkeologjike para realizimit të tyre.
22. Mban dhe përditëson platformën digjitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, si një regjistër publik i aksesueshëm nga çdo subjekt i interesuar.
23. Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave të saj për zbatimin e politikave shtetërore në fushën e ruajtjes e të mbrojtjes së trashëgimisë arkeologjike në përgjithësi.
24. Koordinon aktivitetet e trashëgimisë kulturore nënujore sipas konventës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.
25. Propozon, mbi bazën e vlerësimeve paraprake dhe gjithëpërfshirëse, deklarin për dhënien e statusit të pasurive kulturore.
26. I propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore masat për mbrojtjen e vlerave kulturore.
27. Mban regjistrin e subjekteve të licencuara në fushën e trashëgimisë arkeologjike.
28. Mban regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në trashëgiminë arkeologjike.
29. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore

1. Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, më poshtë referuar DRTK-të, janë institucione rajonale të specializuara, tekniko-administrative, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. DRTK-të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ato administrojnë.

3. DRTK-të, për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga IKTK-ja, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve. Ato bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me institucionet e vetëqeverisjes vendore, personat fizikë ose juridikë, publikë dhe privatë, shqiptarë apo të huaj në fushën e trashëgimisë kulturore.

4. DRTK-të kanë këto kompetenca:

a) Zbatojnë konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

b) Gjurmajnë dhe përgatisin vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes;

c) Kryejnë verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura;

ç) Kryejnë verifikime dhe marrin masa, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në raste të situatave emergjente, kur rrezikohet gjendja e pasurive kulturore;

d) Hartojnë projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor;

dh) Kryejnë punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara;

e) Kryejnë mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale;

ë) Kryejnë çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

5. Pranë DRTK-ve funksionojnë:

a) Zyrat rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme;

b) Inspektorët rajonalë të inspektoratit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

c) Njësitë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore jomateriale dhe të edukimit nëpërmjet trashëgimisë.

6. DRTK-të, në përmbushje të funksioneve të tyre, sipas këtij ligji, mbledhin tarifatat sipas parashikimeve të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

7. DRTK-të funksionojnë në bazë të përcaktimeve të këtij ligji në zbatim të tij, si dhe statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

1. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, më poshtë referuar IKRTK-ja, është institucion kombëtar i specializuar i trashëgimisë kulturore në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. IKRTK-ja ka për mision krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar. IKRTK-ja, në funksion të përmbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, organet e policisë, institucionet doganore si dhe institucionet ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore.

3. IKRTK-ja ka për detyrë regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin,

promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare. IKRTK-ja monitoron dhe koordinon punën me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore. IKRTK-ja u ofron shërbime organeve të administratës shtetërore qendrore, pushtetit vendor, institucioneve shkencore, kulturore apo fetare, personave fizikë dhe juridikë privatë për evidentimin, regjistrimin dhe katalogimin e pasurive kulturore.

4. IKRTK-ja ka për kompetencë:

a) Të regjistrojë dhe të dokumentojë të gjitha pasuritë kulturore, materiale dhe jomateriale, si dhe pasuritë e peizazhit në pronësi publike e private në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) Të hartojë platformën për regjistrimin e të gjitha pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme, që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, personat privatë, institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe bashkësitë fetare të regjistruara me ligj, për krijimin dhe përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore;

c) Të administrojë Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatik kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore;

ç) Të administrojë katalogun e fondit muzeor kombëtar;

d) Të administrojë bazën shtetërore të të dhënave të pasurive kulturore;

dh) Të administrojë bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;

e) Të zhvillojë metodologjinë mbi dokumentimin e katalogimin e pasurive kulturore, si dhe të koordinojë bashkëpunimin me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore;

ë) Të lëshojë certifikata regjistrimi të pasurive kulturore, të luajtshme e të paluajtshme;

f) Të hartojë dhe të mbajë regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme;

g) Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera publike dhe private, që kanë në administrim pasuri kulturore, për të siguruar katalogimin e pasurive kulturore dhe të koordinojë aktivitetet në këtë fushë;

gj) Të asistojë ministrinë në ushtrimin e kompetencave për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore për funksionet që IKRTK-ja ka kompetencë;

h) Të akordojë licencat e eksportit, në pajtim me parashikimet e këtij ligji;

i) Të mbajë një regjistër kombëtar të licencave të eksportit të pasurive kulturore;

j) Të mbikëqyrë dhe të monitorojë respektimin e të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare;

k) Të asistojë apo të denoncojë pranë inspektoratit kombëtar përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

l) Të mbikëqyrë zbatimin apo shkeljen e procedurave (regjimit) të qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme;

ll) Të kryejë çdo funksion tjetër të parashikuara në këtë ligj.

5. IKRKT-ja ka kompetencë regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin, ruajtjen, monitorimin e qarkullimit, shërbimin *on-line* të regjistrimit në fushën e pasurive kulturore në pronësi publike dhe private në Republikën e Shqipërisë.

6. Pranë IKRTK-së krijohen dhe funksionojnë zyrat rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, në përputhje me parashikimet e këtij ligji për:

a) Regjistrimin *on-line* të pasurive kulturore kombëtare dhe çdo procedure për identifikim dhe regjistrim;

b) Zbatimin dhe monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.

7. Në përmbushje të funksioneve të veta, IKRKT-ja mbledh tarifën sipas parashikimeve të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

8. IKRTK-ja funksionon në bazë të përcaktimeve të këtij ligji dhe statutit të miratuar me urdhër të

ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 33

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale

1. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, më poshtë QKVT, është institucion i specializuar në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. QKVT-ja ushtron veprimtarinë e saj në administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar, në bashkëpunimin me subjekte publike e private.

3. Në përmbushje të funksioneve të saj, QKVT-ja bashkëpunon me specialistët e trashëgimisë kulturore jomateriale pranë drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore, si dhe me institucionet kulturore-artistike qendrore e vendore, shoqatat kulturore e individë të fushës së trashëgimisë jomateriale.

4. QKVT-ja është organizatore e festivaleve folklorike tipologjike kombëtare, FFTK-ve, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Organizimi i FFTK-ve bazohet në Rregulloren e Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. QKVT-ja, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shtetërore e private organizon Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, bazuar në rregulloren e tij, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Shpallja e organizimit të tij bëhet me urdhër të ministrit, një vit përpara zhvillimit të tij.

6. QKVT-ja ka kompetencë:

a) Të asistojë ministrinë në ushtrimin e kompetencave të saj për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale;

b) Të kërkojë, verifikojë dhe studiojë vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) Të krijojë dhe përditësojë Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit, Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale, Listën e Artizanëve, të cilët trashëgojnë dijetë të ndryshme, Regjistrin e Kryeveprave të Trashëgimisë Jomateriale dhe Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Rrezik;

ç) Të krijojë dhe mirëmbajë një hartë interaktive të trashëgimisë kulturore jomateriale në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) Të lëshojë dokumente, kopje të vërtetuara të tyre dhe kopje digjitale të arkivit, sipas tarifave të përcaktuara me udhëzim;

dh) Të monitorojë në terren të gjitha veprimtaritë e trashëgimisë jomateriale, që zhvillohen në rang vendi;

e) Të përgatisë raporte apo informacione për trashëgiminë jomateriale, të kërkuara nga organizmat ndërkombëtarë, dhe t'i paraqesë ato në KKTKJ;

ë) Të kryejë çdo funksion tjetër të parashikuara me ligj.

7. QKVT-ja funksionon si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar të Pasurive Kulturore Jomateriale.

8. QKVT-ja funksionon në bazë të përcaktimeve të këtij ligji, si dhe statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 34

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit

1. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, më poshtë AQSHF, është institucion i specializuar dhe arkivor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Funksioni themelor i AQSHF-së është studimi, kërkimi, ruajtja, mbrojtja, digjitalizimi,

restaurimi, përpunimi shkencor, promovimi, vlerësimi, publikimi, administrimi, pasurimi me materiale të reja dhe shfrytëzimi i materialeve arkivore filmike për krijime të veprave të reja kinematografike e televizive dhe veprave studimore, konsulenca dhe bashkëpunimi me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën arkivore kinematografike.

3. AQSHF-ja është subjekt i këtij ligji, në kuptim të kryerjes së funksioneve ruajtëse, mbrojtëse, vlerësim e administrim të fondit arkivor filmik, si dhe subjekt i ligjit për kinematografinë, në zbatimin e funksioneve të tjera.

4. Pranë AQSHF-së ngrihet dhe funksionon qendra e restaurimit të filmit, e cila formon restauratorët e ardhshëm të materialeve filmike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e kësaj qendre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. AQSHF-ja funksionon në bazë të përcaktimeve të këtij ligji, si dhe statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 35

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

1. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, më poshtë BKSHE, është institucion i specializuar dhe arkivor në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Funksioni themelor i BKSHE-së është studimi, kërkimi, digjitalizimi, ruajtja, mbrojtja, vlerësimi, administrimi, restaurimi, përpunimi shkencor, promovimi, publikimi, pasurimi me materiale të reja dhe shfrytëzimi i materialeve arkivore të saj për krijime të veprave studimore, konsulenca dhe bashkëpunimi, me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja në fushën arkivore të botimeve.

3. BKSHE-ja është subjekt i këtij ligji dhe i ligjit “Për bibliotekat”.

4. Pranë BKSHE-së ngrihet dhe funksionon Qendra e Restaurimit të Materialeve Bibliotekare, e cila formon restauratorët e ardhshëm të materialeve bibliotekare, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

5. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e kësaj qendre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Biblioteka Kombëtare funksionon në bazë të përcaktimeve të këtij ligji, ligjit “Për bibliotekat”, si dhe statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 36

Institucione të tjera të specializuara

1. Janë institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore edhe Akademia e Shkencave, Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimeve të Artit, Instituti i Arkeologjisë, në përputhje me fushat e tyre të kompetencës.

2. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me parashikimet e ligjeve të veçanta të fushës së kompetencës dhe për aq sa janë të zbatueshme parashikimet e këtij ligji në cilësinë e tyre si institucione të specializuara.

3. Në rastet kur institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, janë edhe pronarë ose posedues të pasurive kulturore, ato janë të detyruara të zbatojnë parashikimet e këtij ligji mbi të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të vlerave kulturore dhe janë subjekte të kontrollit dhe inspektimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

TITULLI IV
ORGANET KOLEGJIALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 37

Organet kolegjinale të trashëgimisë kulturore

1. Organe kolegjinale në fushën e trashëgimisë kulturore janë:
 - a) Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në vijim KKTKM-ja;
 - b) Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, në vijim KKTKJ-ja;
 - c) Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, në vijim KKMPK-ja;
 - ç) Këshilli Kombëtar i Muzeve, në vijim KKM-ja.
2. Përbërja, mënyra e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimi i anëtarëve të organeve kolegjinale në fushën e trashëgimisë kulturore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

**Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë
Kulturore Materiale**

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i cili kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 15 anëtarë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. KKTKM-ja ka kompetencë:
 - a) Të licencojë subjektet, personat fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, të aktiviteteve arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit;
 - b) Të miratojë projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim;
 - c) Të mbikëqyrë veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit;
 - ç) Të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligji;
 - d) Të miratojë, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;
 - dh) Të miratojë, në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve dhe zonave arkeologjike;
 - e) Të hartojë akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor;
 - ë) Të miratojë, të vlerësojë në parim planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.
3. KKTKM-ja e organizon punën e ndarë në kolegje, të cilat kanë këto kompetenca:
 - a) Këshilli Teknik, i përbërë nga 7 anëtarë, vepron si organ seleksionues dhe vlerësues i përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura në KKTKM, si dhe në lidhje me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtjeje të pasurive kulturore;
 - b) Këshilli i Trashëgimisë Kulturore Materiale, i përbërë nga 15 anëtarë, vepron si organ vendimmarrës në lidhje me kërkesat për ndërhyrje mbi pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme; pasuritë arkeologjike dhe çdo kërkesë të lidhur të fushës, sipas parashikimeve të këtij ligji.
4. KKTKM-ja ndërvepron nëpërmjet një sporteli unik dhe sekretarisë teknike pranë IKTK-së. Veprimtaria e KKTKM-së, sekretarisë teknike dhe sportelit unik të KKTKM-së rregullohet me rregullore, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky urdhër publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 39

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgimisë kulturore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përbëhet nga 11 anëtarë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKJ-ja ka kompetencë:

- a) Të mbikëqyrë veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore jomateriale;
- b) Të miratojë e të hartojë strategjinë dhe programin e zhvillimit në këtë fushë;
- c) Të miratojë, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;
- ç) Të hartojë dhe të miratojë strategjinë dhe programe të zhvillimit në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- d) Të ndjekë dhe të mbikëqyrë veprimtaritë që zhvillohen në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- dh) Të propozojë programe pune për edukimin nëpërmjet trashëgimisë kulturore jomateriale;
- e) Të miratojë planin vjetor të aktiviteteve kombëtare, që zhvillon Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale;
- ë) Të propozojë projekte dhe masa që duhen ndërmarrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, sidomos atyre që janë në rrezik;
- f) Të propozojë dhe të miratojë programin e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore jomateriale, që realizohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- g) Të propozojë dhe të miratojë vlerat e trashëgimisë jomateriale kombëtare për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s;
- gj) Të miratojë propozimet e QKVT-së për “Kryevlerat Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”.

3. KKTKJ-ja ndërvepron nëpërmjet një sekretarie teknike pranë QKVT-së.

4. Veprimtaria e KKTKJ-së dhe sekretarisë teknike parashikohet me rregullore të veçantë, që miratohet me urdhër të ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky urdhër publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 40

Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore

1. Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore (KKMPK) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgimisë kulturore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përbëhet nga 11 anëtarë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. KKMPK-ja ka kompetencë:

- a) Të miratojë strategjinë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore;
- b) Të miratojë programin e zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore;
- c) Të konsultojë ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore për tipologjinë e aktiviteteve tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura;
- ç) Të miratojë kriteret për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare;
- d) Të miratojë kriteret për akordimin e licencave për ekspert vlerësues të pasurive kulturore;
- dh) Të hartojë, të miratojë e të propozojë te ministri marrëveshjet e partneritetit publik-privat në lidhje me pasuritë kulturore;

e) Të përcaktojë tarifat e përdorimit të pasurive kulturore, mënyrën e përdorimit dhe të destinacionit të tyre;

ë) Të përcaktojë kriteret dhe formatin e deklaratës së interesit kulturor ose shkencor të ekspozitave apo panairove dhe të çdo iniciative tjetër me karakter kulturor, me qëllim zbatimin e lehtësive të parashikuara nga normativat fiskale.

3. KKMPK-ja ka sekretarinë e saj teknike pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Veprimtaria e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike parashikohet me rregullore të veçantë, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky urdhër publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 41

Këshilli Kombëtar i Muzeve

1. Këshilli Kombëtar i Muzeve (KKM-ja) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përbëhet nga 11 anëtarë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Pranë KKM-së funksionon Bordi i Akreditimit të Muzeve.

3. KKM-ja ushtron kompetencat e parashikuara në pjesën e tretë të këtij ligji.

4. KKM-ja ka sekretarinë teknike pranë Muzeut Historik Kombëtar.

5. Veprimtaria e KKM-së, Bordit të Akreditimit të Muzeve dhe sekretarisë teknike rregullohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky urdhër publikohet në Fletoren Zyrtare.

TITULLI V

MBROJTJA E PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME NË KUADËR TË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Neni 42

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në kuadër të planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në kuadër të planifikimit dhe zhvillimit të territorit përfshin:

a) Regjimet e ruajtjes, sipas parashikimeve të këtij ligji;

b) Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, me qëllim ruajtjen e pasurive kulturore të paluajtshme, si dhe rregullat specifike të lidhura me to;

c) Planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme;

ç) Vlerësim, në parim, të lejeve zhvillimore dhe dokumentacionin shoqërues të projekteve, iniciativat e investimeve e të projekteve të ndërhyrjes brenda zonave të mbrojtura, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Neni 43

Regjimet e ruajtjes

1. Regjimi i ruajtjes së pasurisë kulturore të paluajtshme specifikohet në urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Regjimi i mbrojtjes së pasurisë kulturore të luajtshme, me vendndodhje në një pasuri kulturore të paluajtshme, përcakton vendndodhjen e pasurisë, shtrirjen territoriale, si dhe udhëzimet për ruajtjen e mirëmbajtjen e saj në pasurinë e paluajtshme ku ndodhet, si dhe mjedisin përreth.

3. Shtrirja territoriale, e përmendur në pikën 2, të këtij neni, përcaktohet edhe në terma të kufijve të pasurisë së paluajtshme kulturore dhe zonën e saj mbrojtëse.

4. Pasuritë kulturore të paluajtshme dhe grupet e pasurive kulturore të paluajtshme me kufijtë e tyre dhe zonat mbrojtëse të tyre, përbëjnë zona të rëndësisë kombëtare, në kuptim të ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe pasqyrohen në hartat kadastrale, sipas dispozitave të ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe në dokumentet e planifikimit në nivel qendror e në nivel vendor, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

5. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme, e cila përfshihet në pasuritë e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, në seksionin përkatës bëhet shënimi “Pasuri kulturore”.

Neni 44

Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë

1. Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë specifikojnë objektivat, detyrat dhe mënyrat e zhvillimit të tyre, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, në përputhje me regjimet e saj të mbrojtjes.

2. Planet sektoriale në nivel rajonal, plani i përgjithshëm vendor dhe planet e detajuara vendore të zhvillimit për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kanë lidhje specifike me rregullat dhe normat që hartohen në përputhje me regjimet për mbrojtjen e pasurive të paluajtshme kulturore të njësisë përkatëse vendore.

3. Dokumentet e planifikimit, në bazë të pikës 2, të këtij neni, që kanë lidhje specifike me zhvillimin e zonave të rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, termat e referencës për hartimin e tyre dhe dokumentet finale vlerësohen, paraprakisht, nga KKTKM-ja.

4. Autoriteti përgjegjës miraton dokumentet e planifikimit, që i referohen zhvillimit të zonave të rëndësisë kombëtare, në kuptim të nenit 43, të këtij ligji, si dhe lejet e zhvillimit të pasurive kulturore specifike, ose ia rikthen për rishqyrtim autoritetit propozues në rastet kur konstaton se janë në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 45

Planet e menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore

Planet e menaxhimit të pasurive të paluajtshme të trashëgimisë duhet të përmbajnë regjimet dhe rregullat e veçanta në lidhje me:

- a) Karakteristikat e përgjithshme të territorit të mbrojtur, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme;
- b) Objektivat dhe organizimin e menaxhimit;
- c) Një program afatshkurtër dhe afatgjatë, programet për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe zbatimin e planit;
- ç) Financimin e aktiviteteve për zbatimin e planit;
- d) Përfshirjen e partnerëve në zbatimin e planit;
- dh) Kushtet dhe rekomandimet për aktivitetet zbatuese;
- e) Sistemin e monitorimit në territorin e mbrojtur dhe sigurimin e masave të shpëtimit në rastet e emergjencave;
- ë) Sistemin e kontrollit të zbatimit.

Neni 46

Hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore

1. Planet e menaxhimit, sipas nenit 45, të këtij ligji, hartohen për vlerat e paluajtshme kulturore, të përfshira në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, për:

- a) Qendrat historike;
- b) Zonat dhe parqet arkeologjike;
- c) Grupin e vlerave të paluajtshme kulturore të rëndësisë kombëtare;
- ç) Vlerat e vetme të paluajtshme kulturore me rëndësi kombëtare,

2. Planet e menaxhimit, sipas nenit 45, të këtij ligji, hartohen edhe për vlera të tjera kulturore të paluajtshme, me iniciativën dhe mbi caktimin e financimit të tyre nga pronari i tyre ose përdoruesit, apo të njësisë së pushtetit vendor, në të cilën ato ndodhen.

3. Planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme i nënshtrohen diskutimit publik, në përputhje me procedurën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave. Shtrirja, struktura, përmbajtja dhe metodologjia e përgatitjes së planeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Miratimi i planeve për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme

1. Termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme do t'i nënshtrohen miratimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore pas marrjes së mendimit paraprak nga KKTKM-ja dhe KKMPK-ja.

2. Planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore miratohen nga:

- a) Këshilli i Ministrave - për pasuritë kulturore të paluajtshme të grupuara;
- b) Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore - për pasuritë kulturore të paluajtshme të veçanta.

Neni 48

Lejet zhvillimore në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë

1. Projektet për leje zhvillimore dhe kërkesa për ndërhyrje në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore miratohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe këtij ligji.

2. Lejet zhvillimore, të rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në qendrat historike, zonat arkeologjike A, B, duhet të miratohen fillimisht në KKTKM dhe më pas, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Çdo shkëputje e pjeshme ose e plotë e një pasurie kulturore të paluajtshme, si dhe e elementeve në pasuritë kulturore të peizazhit, që përbëjnë pjesë të artit të kopshtit dhe parkut, mund të lejohen në pajtim me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, pas marrjes së një mendimi pozitiv nga ana e KKTKM-së.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të masave të parashikuara në planet për mbrojtjen territoriale dhe të zhvillimit të pasurive të paluajtshme kulturore kryhet nga Inspektorati Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, në bashkëpunim me autoritetet kompetente qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore.

Neni 49

Marrja në dorëzim e punimeve

1. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore të paluajtshme, përfshirë edhe tipologjitë e punimeve për konservim dhe restaurim fasade, konservim dhe restaurim të elementeve të brendshme artistike, ruajtje të vlerave arkeologjike kulturore, merren në dorëzim nga komisioni i përbërë nga punonjës të DRTK-së dhe pronarëve/administruesve të pasurisë kulturore të paluajtshme. Komisioni do të emërohet me urdhër të drejtorit të IKTK-së.

2. Komisioni, sipas pikës 1, të këtij neni, do të kontrollojë dokumentacionin e paraqitur nga kolaudatori, për të verifikuar cilësinë e punimeve konservuese e restauruese të kryera dhe, nëpërmjet një raporti, i propozon drejtorit të IKTK-së pranimin ose refuzimin e punimeve, duke argumentuar vendimin

e tij.

3. Brenda një jave, nga marrja e raportit nga ana e komisionit, nëse ai sugjeron pranimin e punimeve, drejtori i IKTK-së lëshon urdhrin për pranimin e punëve konservuese dhe restauruese të kryera.

4. Një kopje e dokumentacionit, i cili regjistrohet në dosjen e pasurisë kulturore të paluajtshme, i dorëzohet IKTK-së dhe IKRTK-së.

5. Në rastet kur komisioni, sipas pikës 1, të këtij neni, ka propozuar mospranimin e punimeve të bëra, raporti do të përmbajë udhëzime specifike, afatet kohore dhe caktimin e një person përgjegjës për zbatimin e tyre.

PJESA E DYTË IDENTIFIKIMI, MBROJTJA DHE VLERËSIMI I PASURIVE KULTURORE

TITULLI I PASURITË KULTURORE

Kreu I Identifikimi i Vlerave Kulturore

Seksioni I Pasuritë kulturore

Neni 50

Tipologjitë e pasurive kulturore materiale

1. Janë pasuri kulturore pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, të cilat kanë interes artistik, letrar, shkencor, historik, urbanistik, arkeologjik dhe etnografik, që janë në pronësi të institucioneve publike qendrore, njësisive të vetëqeverisjes vendore, si dhe të çdo enti tjetër e institucioni publik, duke përfshirë bashkësitë fetare të njohura ligjërisht, personat fizikë dhe juridikë privatë, dhe që janë të deklaruara si “monumente kulture” dhe pasuri kulturore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Janë, gjithashtu, pasuri kulturore:

a) Fondet e muzeve, të pinakotekave, galerive dhe ekspozitave të tjera pronë e institucioneve publike qendrore, të personave juridikë të tjerë publikë vendorë, si dhe të çdo institucioni tjetër publik;

b) Arkivat dhe çdo dokument tjetër i institucioneve publike qendrore, i personave juridikë të tjerë publikë vendorë, si dhe të çdo institucioni tjetër publik;

c) Fondet e librave të bibliotekave të institucioneve publike qendrore, të personave juridikë të tjerë publikë vendorë, si dhe të çdo institucioni tjetër publik.

3. Mund të jenë pasuri kulturore, pas deklarimit, sipas parashikimeve të nenit 61, të këtij ligji:

a) Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, që kanë interes artistik, urbanistik, historik, arkeologjik ose etnografik me rëndësi të veçantë, që u përkasin subjekteve të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni;

b) Arkivat dhe dokumente të veçanta, në pronësi private, me interes të veçantë historik;

c) Fondet e librave, në pronësi private, me interes të veçantë kulturor;

ç) Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi të kujtdo, që kanë interes të veçantë për shkak të referencës/lidhjes së tyre me historinë politike, ushtarake, letrare, artistike, shkencore, teknike, industriale e kulturore në përgjithësi, që janë dëshmi të identitetit dhe të historisë së institucioneve publike, kolektive ose fetare.

d) Koleksionet në pronësi të kujtdo, të papërfshira ndërmjet atyre të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe që, për tradita, reputacion e karakteristika të veçanta ambientale ose rëndësi artistike, historike, arkeologjike, numizmatike dhe etnografike kanë, në tërësi, një interes të veçantë.

4. Përfshihen në pasuritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 3, shkronja “a”, të këtij neni, pas deklarimit:

- a) Dorëshkrimet, autografet, korrespondencat, vizatimet origjinale të arkitekturës dhe librat, vulat, gravurat me teknikë të veçantë, që kanë karakteristika me vlerë dhe janë të rralla;
- b) Hartat gjeografike dhe partiturat muzikore, që kanë karakter të rrallë dhe me vlerë;
- c) Fotografitë, me negativat dhe stampat përkatëse, pelikolat kinematografike dhe suportet audiovizive në përgjithësi, me karakter të rrallë dhe me vlerë;
- ç) Vilat, parqet dhe kopshtet, që kanë interes artistik ose historik;
- d) Sheshet publike, rrugicat, rrugët dhe hapësirat e tjera të hapura urbane, me interes artistik ose historik;
- dh) Minierat me interes historik dhe/ose etnoantropologjik;
- e) Anijet dhe mjetet e tjera lundruese me interes artistik, historik dhe/ose etnografik;
- ë) Arkitekturat rurale me interes historik dhe/ose etnoantropologjik, dëshmi të ekonomisë rurale tradicionale.

Neni 51

Tipologji të tjera pasurish kulturore materiale në mbrojtje të veçantë

1. I nënshtrohen mbrojtjes së veçantë, si pasuri kulturore, pas deklarimit, edhe pasuritë si më poshtë:

- a) Afresket, stemat, vizatimet, varret, mbishkrimet, strehimet e Luftës së Dytë Botërore, bunkerët dhe të tjerë elemente dekorative të ndërtesave, të hapura ose jo për publikun, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- b) Veprat e pikturës, skulpturës, grafikët dhe çdo objekt arti pamor i një autori bashkëkohor, që kanë karakteristika me vlera të veçanta;
- c) Veprat e arkitekturës bashkëkohore me vlerë të veçantë artistike dhe arkitektonike;
- ç) Fotografitë me negativat dhe stampat përkatëse, ekzemplarët e veprave kinematografike, audiovizive ose të sekuencave të imazheve në lëvizje, dokumentimi i manifestimeve të realizuara me zë ose verbale, pavarësisht mënyrës së realizimit, prodhimi i të cilave është bërë më shumë se 80 vite më parë;
- d) Mjetet e transportit më shumë se 50-vjeçare;
- dh) Mekanizmat, makineri ose objekte të përdorimit të përditshëm apo ceremonial, me vlerë artizanale, etnografike ose historike, objektet e prodhuara në mënyrë artizanale me vjetërsi mbi 75-vjeçare dhe objektet e fabrikuara mbi 100-vjeçare;
- e) Pasuritë dhe instrumentet me interes për historinë e shkencës dhe teknikës, më shumë se 50-vjeçare;
- ë) Gjurmë mbetjesh njerëzore të Luftës së Dytë Botërore, pjesë e trashëgimisë historike;
- f) Vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste.

2. Për pasuritë e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen parashikimet e neneve 57 e 61, nëse verifikohen interesat e përcaktuara në nenin 50, të këtij ligji.

Neni 52

Objekte që nuk janë pasuri kulturore

Nuk janë pasuri kulturore, në kuptim të këtij ligji, objektet, të cilat nuk janë deklaruar pasuri kulturore në zbatim të parashikimeve të seksionit II, të kreut I, të titullit I, të kësaj pjese të ligjit, si dhe ato objekte, të cilat nuk janë shpallur “monument kulture”, në kuptim të ligjeve të mëparshme.

Neni 53

Klasifikimi i pasurive kulturore të paluajtshme

1. Klasifikimi i pasurive kulturore të paluajtshme bazohet në:

- a) Përkatësinë e tyre në një periudhë të caktuar historike;
- b) Hulumentimin dhe fushën kulturore së cilës ata i përkasin;
- c) Strukturën e tyre hapësinore dhe shtrirjen territoriale;
- ç) Shkallën e ekspozimit të tyre ndaj rrezikut;
- d) intensitetin e ndërhyrjes.

2. Në lidhje me hulumentimin dhe fushën e kulturës së cilës ato i përkasin, pasuritë kulturore të paluajtshme mund të klasifikohen në:

a) Arkeologjike: gjurmët materiale të aktivitetit të njeriut, të cilat janë të pandashme nga mjedisi në të cilin ato janë krijuar, duke u identifikuar nëpërmjet gërmimeve arkeologjike;

b) Historike: ndërtesat, instalimet, strukturat e tjera, që kanë lidhje me ngjarje historike dhe personalitete historike;

c) Arkitektonike dhe strukturore: ndërtesat, instalimet, strukturat, pjesë apo kombinime të tyre, të cilat kanë vlera historike, estetike, teknike, kulturore, teknologjike, hapësinore dhe funksionale. Këto pasuri janë të klasifikuara të veçuara dhe të grupuara;

ç) Artistike: veprat e arteve të bukura dhe të aplikuara, të cilat janë elemente të pandashme të mjedisit në të cilin ndodhen ose për të cilin ato janë krijuar;

d) Urbane: pjesë të dallueshme të territoreve dhe komuniteteve, elemente të të cilëve janë të ndërlydhura në hapësirë dhe mund të dallohen topografikisht;

dh) Peizazh kulturor: grupi i shtresave hapësinore të dallueshme kulturore, që rezultojnë nga ndërveprimi ndërmjet njeriut dhe natyrës, të cilat janë karakteristikë e identitetit kulturor në një territor të caktuar;

e) Arti në park dhe kopsht: parqe historike dhe kopshte me rëndësi për zhvillimin e artit dhe shkencës në kopsht;

ë) Etnografik: provat materiale të stilit të jetesës, zejtarisë, aftësitë, ritualet dhe besimet që kanë të bëjnë me mjedisin hapësinor;

f) Shtigje kulturore: kombinimi i një rruge historike, pjesë e një rruge tradicionale dhe sitet e bashkëngjitura të trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe peizazheve.

3. Për sa i përket strukturës hapësinore dhe shtrirjes territoriale, pasuritë e paluajtshme kulturore mund të jenë:

a) Të vetme;

b) Të grupuara, të cilat ndahen si më poshtë:

i. “kompleks” - një shumëllojshmëri brenda ansambllit, elementet e të cilit janë funksionalisht të ndërlydhura;

ii. “ansambël arkitektonik/urban”, - strukturë e dallueshme urbanistiko-arkitekture, pjesë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, elementet e të cilit janë në ndërlydhje të caktuara të rëndësishme, hapësinore dhe estetike midis tyre dhe me mjedisin përreth;

iii. “qendër historike” - territor i dallueshëm urban, që përbëhet nga elemente të trashëgimisë kulturore materiale, ku përfshihen, përveç strukturës urbane, elemente arkitektonike, mjedisore, kulturore, historike, peizazhe brenda dhe rreth zonës, dëshmitë arkeologjike, panoramat, profilet urbane, perspektivat dhe pikat e referencës;

iv. “zonë arkeologjike” - vendi ose peizazhi natyror ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gërmuara ose jo, që janë gjendur apo gjenden në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujërat territoriale shqiptare, që mund të studiohen duke përdorur metoda arkeologjike. Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike kategorizohen në “Zona A” dhe “Zona B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

v. “park arkeologjik” - territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës dhe nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i

organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

4. Në kushtet e ekspozimit të tyre ndaj rrezikut, vlerat e paluajtshme kulturore janë:

a) Vlera kulturore në rrezik - për të cilat ekziston një kërcënim potencial për dëmtimin ose shkatërrimin për shkak të:

i. vendndodhjes në zonat sizmike;

ii. vendndodhjes në zona me punime të ndërtimit në shkallë të gjerë;

iii. afërsisë së territoreve të ekspozuara ndaj një rreziku të madh, si rreziku i një konflikti të armatosur dhe sulmet terroriste.

b) Vlera kulturore të rrezikuara - për të cilat ekziston një kërcënim real i dëmtimit, vandalizmit, shkatërrimit ose dëmtimit të rëndë të integritetit të tyre për shkak të:

i. shpërbërjes së shpejtë nga substanca e tyre origjinale, duke çuar në ndryshim thelbësor të strukturës së tyre;

ii. degradimit të shpejtë të mjedisit;

iii. humbjes së dukshme në pamjen e tyre autentike.

5. Për sa i përket rëndësisë së tyre kulturore, kërkimore dhe rëndësisë sociale, vlerat e paluajtshme kulturore vendosen në kategoritë e mëposhtme:

a) “Me rëndësi universale” - ato që janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s;

b) “Me rëndësi kombëtare” - sitet arkeologjike, si dhe vlerat e tjera kulturore të një rëndësie të shquar në kulturën dhe historinë e vendit;

c) “Me rëndësi lokale” - ato që lidhen me kulturën dhe historinë e vendbanimeve, bashkive ose rajoneve;

ç) “Me rëndësi për ansamblin” - ato që mbështesin karakteristikat hapësinore dhe tipologjinë arkitektonike të grup-vlerave të cilave u përkasin;

d) “Vetëm për referencë” - me vlera të pakta individuale, që kontribuojnë me informacion në zonën shkencore apo kulturore së cilës i përkasin.

6. Termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme, sipas këtij neni, do të përcaktohen në udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

7. Për sa i përket intensitetit të ndërhyrjes, pasuritë kulturore të paluajtshme janë të klasifikuara pasuri kulturore të kategorisë I dhe pasuri kulturore të kategorisë II.

Neni 54

Klasifikimi i pasurive kulturore të luajtshme

1. Klasifikimi i pasurive kulturore të luajtshme bazohet në:

a) Përkatësinë e tyre në një periudhë të caktuar historike;

b) Hulumtimin dhe fushën kulturore së cilës ato i përkasin.

2. Në kuptim të përkatësisë së tyre në një periudhë të caktuar historike, pasuritë kulturore të luajtshme janë:

a) Prehistorike;

b) Antike;

c) Mesjetare;

ç) Të periudhës së Rilindjes;

d) Të kohëve të reja dhe moderne.

3. Në lidhje me hulumtimin dhe fushën e kulturës në të cilën ato kanë lidhje, pasuritë kulturore të luajtshme janë:

a) Arkeologjike: objekte të luajtshme, të zbuluara nën tokë, në sipërfaqe të saj ose nën ujë, duke dëshmuar përkatësinë e tyre në epoka dhe qytetërimi të studiuara nga arkeologjia;

b) Etnografike: sende të luajtshme, që dëshmojnë për mënyrën e jetesës dhe të punës, traditat,

zakonet, ritalet, besimet dhe zejtarinë, të cilat mundësojnë studimin e karakteristikave etnike dhe ndryshimet në kulturën materiale e jomateriale;

c) Historike: pasuri të luajtshme, të lidhura me evente të rëndësishme historike dhe personalitete;

ç) Artistike: veprat e arteve të bukura në të gjitha teknikat dhe varietetet e tyre, duke përfshirë mostrat filatelike;

d) Natyrore: materiale të lidhura me florën, faunën, palaeontologjinë dhe formacionet minerare;

dh) Teknike: produkte të kulturës teknike;

e) Arkivat: dokumente me rëndësi kulturore e shkencore, pavarësisht nga koha, vendndodhja dhe teknika e ekzekutimit të tyre; dorëshkrime me vlera kulturore, që datojnë para përfundimit të shekullit të 18-të, botime të vjetra, të rralla dhe të vlefshme, me rëndësi shkencore, kulturore, poligrafike ose bibliografike;

ë) Letrare: vlera kulturore dokumentare dhe fizike, që lidhen me historinë e përgjithshme të letërsisë.

4. Në varësi të rëndësisë së tyre shkencore e kulturore, pasuritë kulturore të luajtshme janë:

a) Thesare kombëtare - një vlerë kulturore me rëndësi të veçantë për shkencën, kulturën, natyrën ose zhvillimin teknologjik, shkatërrimi i së cilës, dëmtimi ose humbja do të përbënte humbje të pariparueshme për shoqërinë, dhe të cilat duhet të plotësojnë ndonjë ose të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. të jetë unike, tipike ose e rrallë në lidhje me aktivitetin njerëzor apo krijimtarinë për periudhën e origjinës së tij;

ii. të ketë provuar vërtetësinë dhe vlerën e lartë shkencore e artistike;

iii. të ketë lidhje ose të përfaqësojë një dëshmi të ideve, besimeve, ngjarjeve apo personaliteteve të shquara, me rëndësi vendimtare për zhvillimin e shoqërisë.

b) Pasuri kulturore me rëndësi universale - ato që janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

5. Pasuritë kulturore të luajtshme janë të veçanta ose të grupuara në koleksione. Koleksionet mund të jenë me vlerë universale, kombëtare dhe rajonale.

6. Për sa i përket intensitetit të ndërhyrjes, pasuritë kulturore të paluajtshme ndahen në monumente kulturore të kategorisë I dhe të kategorisë II, sipas përkufizimeve të këtij ligji.

Neni 55

Tipologjitë e pasurive kulturore jomateriale

Janë objekt i mbrojtjes së dispozitave së kësaj pjese tipologjite e mëposhtme të vlerave kulturore jomateriale:

a) Folklori muzikor instrumental; folklori instrumental; folklori gojor; folklori koreografik; folklori muzikor vokal; lojërat popullore të ruajtura në kujtesë, të shkruara ose të regjistruara;

b) Artet popullore të shfaqjes, ritalet dhe spektaklet popullore;

c) Dukuritë, njohjet dhe praktikat e vjetra tradicionale, të lidhura me natyrën dhe gjithësinë;

ç) Dijebërja, lidhur me artizanatin dhe gatimet tradicionale;

d) Besimet, doket dhe zakonet popullore;

dh) Praktikrat folklorike, me shprehjet e ndryshme të tyre;

e) Aftësi dhe dijëbërje të lidhura me jetën dhe ekonominë: punimi i tokës, rritja e gjedhëve; gjuetia, tregtia etj.;

ë) Dija e lidhur me natyrën;

f) Aftësi dhe dije të lidhur me zanatet tradicionale, si: zanatet folklorike, zanatet për kostumet tradicionale, për arkitekturën folklorike, për aspektet shtëpiake;

g) Format e jetëzimit të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të komuniteteve të tjera;

Seksioni II
Dokumentimi i pasurive kulturore

Neni 56

Inventarizimi dhe katalogimi i pasurive kulturore

1. Identifikimi i trashëgimisë kulturore kryhet nëpërmjet inventarizimit të realizuar nga ana e IKRTK-së, sipas parashikimeve të këtij ligji. Inventarizimi dhe dokumentimi përmbajnë, ndër të tjera, grafikën paraprake, paraqitjen pamore dhe përshkruese të të dhënave themelore të trashëgimisë kulturore, emrin e pronarit, poseduesin ose shfrytëzuesin dhe referencat për vendndodhjen.

2. IKRTK-ja është institucioni që mban, përditëson dhe administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale. Procedurat dhe mënyrat e inventarizimit, të regjistrimit dhe katalogimit përcaktohen në një udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe publikohen në Fletoren Zyrtare.

3. Të dhënat e përmendura në këtë nen krijojnë “Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore”. IKRTK-ja është institucioni që mban, përditëson dhe administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore.

4. Për të siguruar identifikimin e trashëgimisë kulturore hartohen, mbahen e përditësohen “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore Materiale” dhe “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore Jomateriale”. Këta regjistra janë objekt i përditësimit dhe plotësimit të rregullt e të vazhdueshëm nga institucionet e specializuara të fushës.

5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, identifikon, inventarizon dhe harton metodologjinë e përbashkët për mbledhjen, shkëmbimin, ndërhyrjen dhe përpunimin e të dhënave në nivel kombëtar, dhe integrimin në një rrjet të bazës së të dhënave shtetërore në platformë digjitale dhe regjistra.

6. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim edhe me universitetet dhe institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, kontribuojnë në përcaktimin e programeve të lidhura me studimet, hulumtimet dhe iniciativat shkencore në fushën e metodologjisë, inventarizimit e katalogimit.

7. Përdorimi dhe aksesimi në të dhënat e dokumenteve të lëshuara në kuptim të nenit 61, të këtij ligji, garanton sigurinë e pasurive dhe ruajtjen e të dhënave personale.

8. Informacioni i përftuar nëpërmjet procesit të identifikimit, dokumentimit, regjistrimit dhe katalogimit të trashëgimisë kulturore përfshihet në “Sistemin digjital për bazën e të dhënave të pasurive kulturore”. Funksionimi i këtij sistemi do të përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

Kreu II

Verifikimi dhe deklarimi i interesit kulturor dhe regjistrimi i pasurisë kulturore

Seksion I
Verifikimi

Neni 57

Verifikimi i interesit kulturor

1. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji, që janë krijuar më shumë se 50 vjet më parë, nëse janë pasuri të luajtshme, dhe më shumë se 70 vjet më parë, nëse janë pasuri të paluajtshme, u nënshtrohen dispozitave të këtij seksioni deri në realizimin e verifikimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e specializuara, me iniciativë

ose bazuar në kërkesën e parashtruar nga subjekte pronarë të pasurive, të shoqëruar edhe me të dhënat përkatëse, verifikojnë ekzistencën e interesit artistik, historik, arkeologjik e etnografik të pasurive të pikës 1, të këtij neni, në bazë të të dhënave të karakterit të përgjithshëm, të vendosura nga KKTKM-ja, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit, sipas procedurës së parashikuar nga ky ligj.

3. Me përjashtim të rregullimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, çdo pasuri deklarohet pasuri kulturore në kuptim të nenit 61, të këtij ligji, vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit të interesit kulturor, sipas rregullimeve të parashikuar nga ky ligj.

Neni 58

Kërkesa për verifikim

1. Kërkesa për verifikim paraqitet nga subjektet publike ose private pranë IKRTK-së, për pasuritë e luajtshme; IKTK-së, për pasuritë e paluajtshme, dhe QKVT-së, për pasuritë jomateriale. Këto institucione, brenda një afati 120-ditor, nga marrja e kërkesës, nxjerrin, me vendim të titullarit, konstatimin ose jo të interesit kulturor të pasurisë objekt verifikimi. Kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjia e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacioni shoqëruar i aplikimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që publikohet në Fletoren Zyrtare.

2. Për pasuritë e paluajtshme në pronë shtetërore, kërkesa e përmendur në pikën 2, të nenit 57, të këtij ligji, shoqërohet nga lista e pasurive dhe kartelat përshkruese të tyre. Kriteret e përpilimit të listave, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimi i tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, hartuar në bashkëpunim me institucionet kompetente për regjistrimin dhe identifikimin e pasurive kulturore.

3. Nga parashikimet e mësipërme përjashtohen verifikimet e dokumenteve arkivore, për të cilat ekziston një prej interesave të parashikuara nga pika 3, e nenit 50, të këtij ligji, dhe për të cilat, në çdo rast, procedura dhe mënyra e verifikimit parashikohen në ligjin që rregullon arkivat.

4. Tarifat e aplikimit për procedurën e verifikimit miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

Neni 59

Procedura e verifikimit

1. Me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së ngrihet, përkatësisht, një komision këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale. Mënyra e tij e funksionimit rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

2. Anëtarët e komisioneve zgjidhen nga lista e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së; IKTK-së dhe QKVT-së. Kriteret dhe pranimi në listë parashikohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Mënyra e shpërblimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Vendimi i verifikimit firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit përkatës, duke përcaktuar rezultatin e identifikimit. Në opinionin e komisionit duhet të specifikohet:

- a) Që pasuria i përmbush ose jo kriteret për t'u konsideruar një vlerë kulturore;
- b) Që ekzistojnë ose jo të dhëna të mjaftueshme për të përmbushur kriteret e deklarimit "Thesar Kombëtar", për pasuritë e luajtshme, dhe "Pasuri kulturore", për pasuritë e paluajtshme,
- c) Nëse ka elemente për të përcaktuar rëndësinë e pasurisë kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 53, të pasurive të luajtshme, sipas parashikimeve të nenit 54, dhe pasurisë jomateriale, sipas nenit 55, të këtij ligji;

- ç) Nëse ka element për të kualifikuar grupin e pasurive të paluajtshme si "pasuri kulturore të

grupuara”, sipas parashikimeve të nenit 53 të këtij ligji;

d) Nëse ka elemente për të kualifikuar grupin e pasurive të luajtshme si “koleksione”, sipas parashikimeve të nenit 61 të këtij ligji;

dh) Nëse ka element për të përcaktuar nevojën e masave paraprake të ruajtjes dhe llojin e tyre.

4. Vendimi i komisionit, së bashku me dosjen përkatëse të aplikimit, i komunikohet, përkatësisht, titullarit të IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së, brenda 7 ditëve nga zbardhja e tij.

Neni 60

Përfundimi i procedurës së verifikimit

1. Procedura e verifikimit përfundon me nxjerrjen e urdhrin të titullarit të IKRTK-së, IKTK-së ose QKVT-së, referuar vendimit të komisionit, dhe përmban vërtetimin e interesit kulturor ose mungesën e tij. Ky urdhër i komunikohet subjektit kërkues dhe institucioneve të specializuara.

2. Pasuritë, të cilat pas verifikimit janë identifikuar vlera kulturore, me qëllim ruajtjen e tyre, me vendim të titullarit të IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së shpallen në “Mbrojtje paraprake” dhe ndaj tyre zbatohen parashikimet e këtij ligji.

3. Njoftimi i vendimit të titullarit, i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, sjell, automatikisht, zbatimin e masave paraprake të mbrojtjes, të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

4. Nëse nga procedura e verifikimit rezulton se pasuritë nuk shfaqin asnjë prej interesave të veçanta, ato nuk u nënshtrohen parashikimeve të dispozitave të këtij ligji.

5. Vërtetimi i interesit artistik, historik, arkeologjik ose etnografik, që kryhet në përputhje me rregullat e përgjithshme të parashikuara në këtë ligj, përbën dokumentin bazë për deklarimin e objektit pasuri kulturore, në kuptim të nenit 61 të këtij ligji.

6. Kartelat përshkruese të pasurive të paluajtshme, pronësi shtetërore, objekt verifikimi me rezultat pozitiv, së bashku me urdhrin e titullarit, i cili konstaton vërtetimin e interesit kulturor, pasqyrohen në një bazë elektronike të dhënash apo të çdo forme tjetër që administrohet nga IKRTK-ja dhe që mund të përdoret nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara të fushës dhe inspektorati kombëtar përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me qëllim monitorimin e trashëgimisë së paluajtshme dhe programimin e ndërhyrjeve në funksion të kompetencave institucionale respektive.

7. Procedura e verifikimit mbyllet me përfundimin e një afati 120-ditor, nga marrja e kërkesës, nëse nuk ka shtyrje të afatit, sipas procedurës më sipër, kohë brenda së cilës duhet të lëshohet vendimi i titullarit të IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së. Në raste përjashtimore të nevojës, me vendim të arsyetuar, titullari i institucionit zgjat afatin e përfundimit deri në 60 ditë.

Seksioni II

Deklarimi

Neni 61

Deklarimi i pasurive kulturore materiale

1. Deklarimi konfirmon ekzistencën e interesave të parashikuara nga pika 3, e nenit 50, të këtij ligji, në objektin që i është nënshtruar vlerësimit, të cilat kanë marrë vlerësim pozitiv nga ky verifikim.

2. Deklarimi nuk kërkohet për pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji. Këto objekte mbeten në mbrojtje edhe kur subjektet që i kanë në pronësi ndryshojnë natyrën e tyre juridike.

3. Deklarimi nuk lëshohet nëse pas verifikimit pozitiv të pasurisë ka të dhëna ose fakte se pasuria mund të jetë përfituar/gjetur/transferuar/ ose të ketë hyrë në territor në mënyrë të paligjshme.

Neni 62

Procedura e deklarimit

1. Procedura e deklarimit fillon me paraqitjen e kërkesës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore nga drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore ose institucionet e specializuara, me iniciative apo edhe me kërkesë të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të tjera publike e private apo individëve të tjerë të interesuar, duke njoftuar për këtë pronarin, poseduesin dhe mbajtësin e pasurisë. Kërkesa përmban urdhrin e titullarit të institucionit përkatës, sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij ligji, për verifikimin e interesit kulturor të pasurisë objekt deklarimi, si dhe dosjen shoqëruese të aplikimit për verifikim interesi, kartelën teknike të pasurisë, të hartuar nga institucioni i specializuar, si dhe, në rastin e pasurive të paluajjtshme, propozimin për deklarimin e zonës së mbrojtur të pasurisë.

2. Brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ministri përgjegjës miraton procedurën e deklarimit.

3. Deklarimi i pasurisë kulturore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me përjashtim të deklarimit të pasurive kulturore të paluajjtshme të grupuara, sipas përkufizimeve dhe klasifikimit të parashikuar në këtë ligj, e cila kryhet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Nëse procedura është për grupim objektësh të paluajjtshme, komunikimi i dërgohet edhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Urdhri i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore përmban:

a) Deklarimin e pasurisë kulturore;

b) Urdhërimin e institucioneve të specializuara për finalizimin e kartelës së pasurisë, finalizimin e përcaktimit të zonës mbrojtëse; përcaktimin e intensitetit të ndërhyrjes, sipas kategorizimit “Monument kulture kategoria I dhe Monument kulture kategoria II”, përcaktimin e rëndësisë së pasurisë; përcaktimin e masave mbrojtëse, nëse janë të nevojshme; për përfundimin e masave mbrojtëse paraprake.

5. Me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas propozimit të institucioneve të autorizuar, të specializuara, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 4, të këtij neni, përcaktohen zona mbrojtëse, intensiteti i ndërhyrjes, rëndësia e pasurisë kulturore, masat mbrojtëse, nëse janë të nevojshme.

Neni 63

Deklarimi i interesit kulturor për koleksionet

1. Me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në bazë të verifikimit pozitiv të fazës së verifikimit, të parashikuar në nenin 62, të këtij ligji, dhe sipas propozimit të këshillit të vlerësimit pranë IKRTK-së deklarohen koleksionet, në kuptim të këtij ligji.

2. Dispozitat e seksionit të parë të këtij kreu dhe parashikimet e nenit 62, të këtij ligji, zbatohen edhe për koleksionet.

Neni 64

Deklarimi i interesit kulturor të pasurive jomateriale

1. Deklarimi i vlerave kulturore jomateriale bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore Jomateriale pranë IKRTK-së.

2. Dispozitat e seksionit të parë të këtij kreu dhe parashikimet e nenit 62 zbatohen edhe për pasuritë jomateriale.

Neni 65

Njoftimi i deklarimit

1. Deklarimi, i parashikuar në nenin 61, të këtij ligji, i njoftohet pronarit dhe poseduesit të objektit

në një nga mënyrat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative.

2. Për pasuritë që regjistrohen deklarimi, me kërkesë të DRTK-së, regjistrohet në regjistrat përkatës, duke pasur efekt njoftues të çdo pronar, përdorues, huamarrës i mëvonshëm.

3. Për pasuritë e deklaruara, përveç regjistrimit në regjistrin e pasurive kulturore, IKRTK-ja koordinon me regjistrat e tjerë publikë për pasqyrimin e të dhënave. Për pasuritë e deklaruara, organi kompetent krijon një bazë të dhënash/listë të posaçme, edhe në formë elektronike.

Neni 66

Ankimi administrativ kundër deklarimit

1. Kundër vendimit të deklarimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Seksioni III

Regjistrimi

Neni 67

Regjistrat kombëtarë të trashëgimisë kulturore

1. IKRTK-ja mban dhe përditëson regjistrin kombëtar të pasurive jomateriale, pasurive materiale, në përputhje me seksionet përkatëse të pasurive kulturore të paluajtshme; të pasurive kulturore të luajtshme dhe koleksioneve, për pasuri të deklaruara pasuri kulturore, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, si dhe atyre të shpallura në kuptim të ligjit për trashëgiminë kulturore të kohës.

2. Pasuritë e regjistruara në këta regjistra mund të jenë në pronësi shtetërore ose private, pavarësisht regjistrimit të tyre në regjistra të tjerë, të parashikuar nga ligje të tjera në fuqi.

3. Në regjistrat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, pasqyrohen të gjitha ndryshimet në statusin juridik të pronës, kushtet dhe regjimet e ruajtjes e të mbrojtjes, si dhe çdo ndërhyrje mbi pasuritë, brenda 7 ditëve nga njoftimi.

4. Institucionet publike dhe private, përfshirë institucionet e specializuara, nëse janë posedues të pasurive kulturore, muzetë e njohur zyrtarisht, koleksionistët, bashkësitë fetare të njohura zyrtarisht, duhet të mbajnë regjistra të rregullt të fondeve të tyre në kushtet dhe formatin e përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, të parashikuar në nenin 56 të këtij ligji.

5. Në përdorimin dhe aksesin në të dhënat që përmbahen në regjistrat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, garantohehet siguria e pasurive dhe ruajtja e të dhënave personale.

Neni 68

Procedura e regjistrimit

1. Në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, subjektet që kanë detyrë të njoftojnë autoritetet për regjistrimin e pasurive kulturore njoftojnë IKRTK-në brenda afateve të parashikuara në këtë ligj.

2. Procedura e regjistrimit, afatet, marrëdhënia e pronarit/poseduesit me institucionet e specializuara dhe formati i regjistrimit parashikohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, të parashikuar në nenin 56 të këtij ligji.

3. Tarifat për procedurën e regjistrimit miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

Neni 69

Publikimi i të dhënave të regjistrave kombëtarë

1. Të dhënat e regjistrave kombëtarë të trashëgimisë kulturore dhe katalogut kombëtar mund të

bëhen publike pas dhënies së miratimit me shkrim nga ana e pronarit, në bazë të një vendimi të autoriteteve gjyqësore ose me autorizimin e autoritetit kompetent, të parashikuar në udhëzimin e përmendur në nenin 56 të këtij ligji.

2. Të dhënat e këtij regjistri i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 70

Certifikata e pasurisë kulturore

1. Certifikata e pasurisë kulturore lëshohet nga IKRTK-ja në bazë të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të deklaramit të objektit pasuri kulturore.

2. Certifikata e pasurisë kulturore duhet të përmbajë, minimalisht, këto elemente identifikimi:

a) Fotografi ose imazh tjetër të pasurisë;

b) Informacion mbi koordinatat, tipin, masën dhe peshën, materialin e teknikën e prodhimit/krijimit, si dhe shenja të veçanta;

c) Emrin e autorit/krijuesit, nëse është i njohur;

ç) Datën dhe vendin e zbulimit/krijimit;

d) Përshkrim të shkurtër;

dh) Udhëzime mbi ruajtjen dhe parashikimet ligjore përkatëse;

e) Zonën e mbrojtur të pasurisë kulturore të paluajtshme.

3. Certifikata e pasurisë nuk lëshohet nëse pas lëshimit të urdhrit të ministrit për deklarimin e pasurisë ka të dhëna ose fakte se pasuria mund të jetë përfituar, gjetur, transferuar, hyrë në territor në mënyrë të paligjshme.

4. Certifikata e pasurisë kulturore nuk përbën titull pronësie në kuptim të legjislacionit në fuqi apo kalim të drejtash të ligjshme.

5. Certifikata e pasurisë kulturore lëshohet në 1 kopje, si për pasuritë e veçanta, ashtu edhe për koleksionet, dhe në rast humbjeje të saj IKRTK-ja lëshon dublikatë të saj.

TITULLI II

MBROJTJA DHE RUAJTJA E PASURIVE KULTURORE

Kreu I

Kontrolli teknik dhe inspektimi

Neni 71

Kontrolli teknik

1. Institucionet e specializuara, sipas fushës së tyre të kompetencës, të parashikuar në këtë ligj ose në akte nënligjore në zbatim të tij, kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen teknike dhe kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore, si dhe të zonave që u nënshtrohen dispozitave të mbrojtjes indirekte.

2. Institucionet e specializuara, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ushtrojnë kontrollin teknik mbi kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore të paluajtshme për pasuritë në pronësi, posedim ose administrim të subjekteve private, institucioneve të vetëqeverisjes vendore dhe subjekteve juridike të tjera publike vendore dhe të bashkësive fetare të regjistruara.

3. Pronarët, poseduesit, bashkësitë fetare të regjistruara dhe të gjitha subjektet e tjera administruese të pasurisë kulturore të paluajtshme janë të detyruar të lejojnë kontrollin e gjendjes fizike e të kushteve të ruajtjes së pasurisë nga institucionet e specializuara, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Institucioni i specializuar që fillon procedurën e kontrollit teknik njofton drejtpërdrejt pronarin, poseduesin, subjektin administrues, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, 5 ditë përpara kryerjes së kontrollit.

5. Gjatë kontrollit mbahet një procesverbal, i cili përmban identitetin e pronarit, të poseduesit ose subjektit administrues, datën, vendin dhe orën e kryerjes së kontrollit, një përshkrim fizik të pasurisë

/pasurive objekt kontrolli, si dhe një analizë të gjendjes fizike e teknike të pasurisë.

6. Një kopje e procesverbalit i njoftohet pronarit, poseduesit ose subjektit administrues brenda 5 ditëve nga përfundimi i kontrollit. Pronari, poseduesi, ose subjekti administrues kanë të drejtë të paraqesin vërejtjet e tyre brenda 10 ditëve, nga njoftimi i procesverbalit. Nëse këto subjekte nuk shprehen brenda afatit të parashikuar në këtë pikë, do të konsiderohet se kanë pranuar konkluzionet e grupit të kontrollit.

7. Pas njoftimit të observacioneve ose përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 6, të këtij neni, një kopje e procesverbalit dhe vërejtjeve të paraqitura nga pronari, poseduesi ose subjekti administrues i përcillet titullarit të institucionit të specializuar, i cili miraton raportin përfundimtar për kryerjen e kontrollit.

8. Nëse në fund të procesit të kontrollit titullari i institucionit të specializuar në raportin përfundimtar konstaton dëmtime, cenime, përdorim të pasurisë kulturore në kundërshtim me karakterin e tyre historik ose artistik apo që vënë në rrezik ruajtjen e tyre, ose ndërhyrje të paautorizuara, njofton inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e trashëgimisë kulturore.

9. Nëse në fund të procesit të kontrollit titullari i institucionit të specializuar, kur është i ndryshëm nga DRTK-ja, në raportin përfundimtar konstaton nevojën për ndërhyrje të nevojshme ruajtëse, njofton DRTK-në kompetente.

10. Në rastin kur pronari, poseduesi, bashkësitë fetare të regjistruara dhe të gjitha subjektet administruese të pasurisë kulturore të paluajtshme veprojnë në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në pikën 3, të këtij neni, grupi i kontrollit informon drejtpërdrejt inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e trashëgimisë kulturore, i cili merr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Raporti përfundimtar regjistrohet në kartelën e pasurisë kulturore.

12. Procedura për kryerjen e kontrollit teknik rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

13. Për pasuritë kulturore të luajtshme, rregullat e kontrollit teknik parashikohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 72

Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse

1. Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

2. Zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të këtij ligji dhe për aq sa është e mundur, legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Projektimi, zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Inspektimi në pasuritë kulturore të paluajtshme

1. IKMTK-ja, kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore, kryen kontrollin për të verifikuar ekzistencën ose shkallën e ruajtjes e të mbrojtjes së pasurive kulturore të paluajtshme dhe zbatimin e detyrimeve të tjera, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Pronari, poseduesi, bashkësitë fetare të regjistruara dhe të gjitha subjektet administruese të pasurisë kulturore të paluajtshme janë të detyruar të lejojnë inspektimin, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Inspektori që kryen inspektimin mban procesverbalin në vendin e inspektimit. Nëse nuk është e mundur mbajtja e procesverbalit në vendin e inspektimit, ai përfundohet në zyrat e inspektimit dhe i

njoftohet subjektit të inspektuar brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

4. Procesverbalit, së bashku me propozimin e inspektorit, i përcillet menjëherë kryeinspektorit, i cili merr një vendim përfundimtar brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit.

5. Vendimi i kryeinspektorit mund të ankimohet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

6. Procedurat e inspektimit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 74

Masat e inspektimit në pasuritë kulturore të paluajtshme

1. Kryeinspektori merr vendim përfundimtar për:

- a) Nevojën e kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse, sipas këtij ligji;
- b) Konstatimin e ndërhyrjeve të paligjshme në pasuritë kulturore të paluajtshme, sipas këtij ligji, dhe marrjen e dënimit administrativ përkatës, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- c) Marrjen e masës administrative të dënimit me gjobë, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- ç) Sipas rastit, edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme.

2. Në rastin e vendimit për dënimin me gjobë, kryeinspektori, duke marrë në konsideratë gjendjen ekonomike të shkelësit, rast pas rasti mund të vendosë shlyerjen me këste të masës së gjobës, sipas marrëveshjes të lidhur për këtë qëllim me shkelësin.

3. Të ardhurat e gjeneruara nga kundërvajtjet administrative të cituara më sipër derdhen 90 për qind në Fondin Kombëtar për Kujdesin e Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe 10 për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 75

Masat urgjente të sigurisë

1. Inspektori, gjatë procesit të inspektimit ka të drejtë që me vendim të ndërmjetëm të marrë një masë urgjente, nëse konstaton se nga ana e pronarit, poseduesit ose një personi, i cili kryen mirëmbajtjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve mbi pasurinë kulturore të paluajtshme, mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i pasurisë kulturore:

- a) Si pasojë e mostrajtimit të duhur;
- b) Si pasojë e përdorimit apo administrimit në kundërshtim me këtë ligj;
- c) Për shkak të mosveprimit për t'u mirëmbajtur.

2. Me vendim të ndërmjetëm, sipas pikës 1, të këtij neni, inspektori mund të vendosë të pezullojë dhe/ose ndalojë çdo lloj veprimi e veprimtarie mbi pasurinë kulturore.

3. Sipas pikës 1, të këtij neni, inspektori mund të vendosë me vendim të ndërmjetëm pezullim të ndërhyrjes mbrojtëse në pasuritë kulturore, nëse rezulton se punimet kryhen pa leje ose në tejkalim të afateve apo kushteve të lejes së lëshuar nga autoriteti kompetent.

4. Procedura dhe ankimi i këtyre masave të parashikuara në këtë nen kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Kreu II **Mbrojtja dhe ruajtja**

Seksioni I

Masat për mbrojtjen e pasurive kulturore materiale

Neni 76

Ndërhyrjet e ndaluara

1. Pasuritë kulturore materiale nuk mund të shkatërrohen, cenohen apo dëmtohen dhe nuk mund të përdoren për qëllime që nuk përputhen me karakterin e tyre historik ose artistik, apo që vënë në rrezik ruajtjen e tyre.

2. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që shkakton shpërbërjen e afreskeve, stemave, grafiteve, gurëve të varreve, mbishkrimeve dhe elementeve të tjera dekorative të ndërtesave të ekspozuara ose jo ndaj publikut.

3. Arkivat publikë dhe ata privatë, për të cilët është bërë deklarimi në kuptim të nenit 61, të këtij ligji, nuk mund të fragmentarizohen.

4. Cenimi, shkatërrimi, dëmtimi, shpërbërja apo përdorimi i pasurive kulturore në kundërshtim me karakterin e tyre historik ose artistik apo që vënë në rrezik ruajtjen e tyre përbën shkelje dhe personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi sipas këtij ligji.

5. Organi kompetent, përveç sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, vendos edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme. Punimet për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme kryhen nën mbikëqyrjen e DRTK-së.

Neni 77

Ndërhyrjet e lejuara

1. Çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme kryhet vetëm pas miratimit nga ana e KKTKM-së ose ministrit, sipas rastit të ndërhyrjes në pikën 3, të këtij neni, referuar intensitetit të ndërhyrjeve të parashikuara në kartelën e pasurisë.

2. Kryhen:

a) Vetëm me leje të KKTKM-së: ndërhyrjet e çdo lloji, të cilat nuk ndalohen taksativisht me këtë ligj;

b) Vetëm me leje të KKTKM-së: shpërbërjet, qofshin edhe të pjesshme, të pasurive kulturore materiale;

c) Me leje të KKTKM-së dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore: ndërhyrjet në lidhje me rindërtimin e pasurive kulturore materiale;

ç) Vetëm me leje të KKTKM-së: gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në pasuritë kulturore, si dhe çdo ndërhyrje në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre;

d) Vetëm me leje të KKTKM-së: gërmimet sistematike për qëllime shkencore dhe çdo ndërhyrje tjetër me natyrë arkeologjike.

3. Kryhen vetëm me lejen e ministrit:

a) Zhvendosja, qoftë edhe e përkohshme, e pasurive kulturore të luajtshme, sipas parashikimeve në pikave 4 dhe 5 të këtij neni;

b) Zhvendosja nga vendet e caktuara të pasurive kulturore të luajtshme, për ruajtjen, restaurimin, studimin, ekspozimin brenda ose jashtë vendit ose tjetërsimin e pronësisë;

c) Copëzimi i koleksioneve, serive dhe përmbledhjeve;

4. Në rastin kur mbajtësi i pasurive kulturore ndryshon vendbanimin ose selinë, ndryshimi i vendndodhjes së pasurive kulturore deklarohet paraprakisht në DRTK. Brenda 30 ditëve, nga data e

marrjes së njoftimit nga ana e DRTK-së, IKRTK-ja mund të parashikojë masat e nevojshme, me qëllim që pasuritë të mos pësojnë dëmtime gjatë transportit.

5. Arkivat shtetërorë dhe të institucioneve të tjera publike mund të zhvendosen pa lejen e parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Në çdo rast, institucioni publik duhet të njoftojë për zhvendosjen ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me qëllim mbikëqyrjen e këtyre pasurive, sipas parashikimeve të këtij ligji.

6. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore bëhet me vendim të KKTKM-së apo KKMPK-së, sipas tipologjisë së kërkesës. Në çdo rast, ndryshimi i destinacionit të përdorimit duhet të jetë në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

7. Kryerja e ndërhyrjeve në kundërshtim me këtë nen përbën shkelje dhe subjekti përgjegjës mban përgjegjësi në përputhje me këtë ligj. Përveç sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, organi kompetent vendos edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme.

8. Punimet për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme kryhen nën mbikëqyrjen e DRTK-së.

Neni 78

Ndërhyrjet në rastet e urgjencës

1. Pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore, në raste të jashtëzakonshme, kur rrezikohet dëmtimi i pasurive kulturore, mund të marrë masa urgjente me karakter të përkohshëm ose me karakter parandalues të rrezikut të dëmtimit të pasurisë kulturore. Në këtë rast, pronari ose poseduesi njofton menjëherë DRTK-në dhe brenda 48 orëve vë në dispozicion projektin dhe preventivin ose kërkesën për ndërhyrjen përfundimtare, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme.

2. Kërkesa, projekti dhe preventivi i punimeve, i depozituar sipas pikës 1, të këtij neni, shqyrtohet nga KKTKM-ja, në kushtet e pikës 2, të nenit 77, ose ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në kushtet e pikës 3, të nenit 77, të këtij ligji, me procedurë të përsheptuar.

3. Për ndërhyrjet e miratuara me procedurë të përsheptuar KKTKM-ja shprehet me vendim brenda 15 ditëve, për ndërhyrjet e parashikuara në pikën 2, të nenit 77, dhe ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore brenda 10 ditëve, për miratimin e ndërhyrjeve sipas pikës 3, të nenit 77, të këtij ligji.

4. Punimet e kryera nga pronari ose poseduesi, të cilat tejkalojnë nevojat e urgjencës të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe që nuk janë miratuar nga organi kompetent, konsiderohen ndërhyrje të paligjshme sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Në rastin e mosveprimit të pronarit ose poseduesit, me qëllim shmangien e dëmtimeve në pasurinë kulturore ose në rastet e kryerjes nga ana e tij të ndërhyrjeve të paligjshme, sipas pikës 4, të këtij neni, DRTK-ja ose institucioni apo subjekti i autorizuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore ndërhyr për mirëmbajtjen e pasurisë. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga pronari ose poseduesi.

6. Mosveprimi ose mosnjoftimi, sipas detyrimeve të këtij neni, përbën shkelje dhe pronari ose poseduesi mbajnë përgjegjësi sipas këtij ligji.

Neni 79

Leja për ndërhyrjet në pasuritë kulturore

1. Leja për ndërhyrje është e nevojshme për çdo ndërhyrje të parashikuar nga neni 77 i këtij ligji.

2. Dokumenti i lejes për ndërhyrje përkrahur të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve në pasuritë kulturore, në përputhje me dokumentacionin shoqërues të kërkesës, projektit e preventivit, si dhe të normave e standardeve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Leja firmoset nga kryetari i KKTKM-së dhe i jepet subjektit kërkues pas kryerjes së pagesës së tarifës së lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore.

4. Përfituesi i lejes për ndërhyrje, pronari i pasurisë kulturore, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

5. Lejet për ndërhyrje, të miratuara në kundërshtim me ligjin dhe/ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, janë të pavlefshme.

6. Leja e parashikuar në nenin 77, të këtij ligji, jepet për projektin e paraqitur nga kërkuesi ose, në rastet e mungesës së projektit, kur kërkesa për leje vlerësohet e mjaftueshme dhe përmban kushtet specifike, në funksion të qëllimit të ndërhyrjes.

7. Afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më shumë se 1 vit, nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga KKTKM-ja. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve dhe ndryshimi i subjektit zbatues të përcaktuar në lejen e ndërhyrjes kryhen nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit të pajisur me licencë. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve bëhet vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar i përcaktuar në lejen e ndërhyrjes, mbi bazën e një kërkesë të dorëzuar brenda afatit të vlefshmërisë së lejes dhe, në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes. Kërkesa për shtyrjen e afatit parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit dhe shoqërohet nga kalendarit i ri i punimeve. Kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve konsiderohet e miratuar në heshtje nëse autoriteti, që ka lëshuar lejen, nuk i njofton vendimin përkatës subjektit kërkues brenda afatit 45-ditor nga dita e depozitimit të kërkesës.

8. Për përfundimin e punimeve të papërfunduara brenda afatit të përcaktuar është e detyrueshme pajisja me një leje të re ndërhyrjeje.

9. Subjekti, i cili ka kryer ndërhyrje të paligjshme ose ka punime të filluara prej më shumë se tre vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, mban përgjegjësi në përputhje me këtë ligj. Përveç sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, organi kompetent për lëshimin e lejes së ndërhyrjes vendos edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës apo zbatimin e plotë të ndërhyrjes me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme apo është në tejkalim të afatit të lejes.

Neni 80

Procedura e lejes për ndërhyrje

1. Kërkesa për lëshimin e lejes, e parashikuar në nenin 77, të këtij ligji, paraqitet në sportelin unik të KKTKM-së pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Formatit i kërkesës dhe dokumentacioni shoqëruar përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Në varësi të kategorisë së pasurisë për të cilën kërkohet të kryhet ndërhyrja ose në varësi të llojit të ndërhyrjes, kërkesa e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i dërgohet, përkatësisht, IKTK-së, brenda 5 ditëve nga dorëzimi i kërkesës, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. KKTKM-ja shprehet me vendim brenda afatit 45-ditor nga paraqitja e kërkesës, në bazë të relacionit teknik të IKTK-së.

4. IKTK-ja mund të kërkojë informacione ose të dhëna të tjera shtesë, të cilat do ta ndihmojnë në vendimmarrje. Në këtë rast, afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, pezullohet deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

5. Nëse është e nevojshme të bëhen verifikime të natyrës teknike, IKTK-ja, në varësi të llojit të ndërhyrjes, njofton kërkuesit për nevojën e kryerjes së këtyre verifikimeve. Njoftimi përmban një përkthim të shkurtër të llojit dhe procedurës së verifikimit teknik. Në këtë rast, afati i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, pezullohet deri në paraqitjen e rezultateve të verifikimeve, por në çdo rast, jo më shumë se 60 ditë.

6. Vendimi për miratimin e lejes nga KKTKM-ja merret me shumicën absolute të anëtarëve.

Anëtarët që votojnë kundër duhet të argumentojnë me shkrim mendimin e tyre.

7. Vendimi i KKTKM-së për miratimin e lejes regjistrohët në ZVRPP, në regjistrin e pasurive kulturore materiale pranë IKRTK-së dhe regjistrin përkatës të lejeve pranë IKTK-së, dhe publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

8. Në rastin e lejeve, sipas pikës 3, të nenit 77, të këtij ligji, afati për shqyrtimin e kërkesës është 30 ditë, nga paraqitja e kërkesës në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

9. Ndaj vendimit që refuzon dhënien e lejes, sipas këtij neni, ose mosnxjerrjes së vendimit brenda afatit të parashikuar në këtë nen mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 81

Masat me karakter parandalues

1. IKTK-ja, me iniciativë apo me kërkesë të institucioneve të specializuara, kur konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me nenet 76, 77 e 78, të këtij ligji, ose në kundërshtim me lejen, urdhëron pezullimin e menjëhershëm të tyre.

2. IKTK-ja ka të drejtë të urdhërojë ndërprerjen ose pezullimin e ndërhyrjeve edhe në lidhje me pasuritë e parashikuara në nenin 50, për të cilat nuk është kryer ende verifikimi, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 57, apo deklarimi, sipas parashikimeve të nenit 61 të këtij ligji.

3. Mosfillimi i procedurës së verifikimit, sipas nenit 57, ose deklarimit, sipas nenit 61, të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga marrja e urdhrit për ndërprerjen ose pezullimin e punimeve të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, sjell, automatikisht, shfuqizimin e masës së pezullimit.

4. Efektet e ndërprerjes ose të pezullimit zgjasin deri në shqyrtimin e ndërhyrjeve të paligjshme nga ana e organit kompetent.

5. Vazhdimi i ndërhyrjeve në kundërshtim me vendimin për pezullim, sipas këtij neni, përbën shkelje dhe subjekti përgjegjës mban përgjegjësi sipas këtij ligji.

Seksioni II

Ruajtja e pasurisë kulturore

Neni 82

Funksioni i ruajtjes

1. Mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore përcaktohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me institucionet, entet e tjera publike, universitetet dhe institutet e kërkimit të specializuara, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale, ndërhyrjet në sipërfaqet e dekoruara të pasurive kulturore materiale, si dhe çdo ndërhyrje për mirëmbajtjen e këtyre pasurive kryhen nga institucione shtetërore të specializuara ose nga subjektet e licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me parashikimet ligjore në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, nëpërmjet tipologjisë së licencave të përmendura në pikën 1, të nenit 83, të këtij ligji.

3. Veprimtaria ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale nga ana e institucioneve të specializuara ose subjekteve private të përcaktuara në këtë ligj përfshihet në kategorinë VI.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.

4. Kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurat për dhënien, pezullimin ose revokimin e licencave, si dhe kuotizacioni vjetor i licencave, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kualifikimi arsimor i personave që kërkojnë të pajisen me licencat e përmendura në pikën 2, të këtij neni, duhet të jetë në nivelin master, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

6. Formimi vazhdues i personave që janë të pajisur me licencat e përmendura në pikën 2, të këtij neni, kryhet nga “Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore”, e ngritur pranë IKTK-së, ose nga subjektet publike apo private, në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi. Kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë.

7. Brenda 3 viteve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, subjektet e licencuara përpara miratimit të tij kanë detyrimin të marrin kreditet sipas një programi formimi intensiv vazhdues, miratuar me urdhër të titullarit të IKTK-së. Mospërmbushja e këtij detyrimi sjell revokimin e licencës.

Neni 83

Llojet e licencave

1. Licencat për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë licencat për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

2. Këto licenca miratohen me vendim të KKTKM-së për subjektet që plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 4, të nenit 82, të këtij ligji.

Neni 84

Revokimi i licencave

1. Licencat për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale mund të revokohen me vendim të KKTKM-së në rastet e mëposhtme:

- a) Kur ka deklarime të rreme në dokumentet që shoqërojnë kërkesën;
- b) Kur dokumentet e paraqitura janë të falsifikuara;
- c) Kur personi juridik kryen veprimtari ndërhyrëse në kundërshtim me ato të parashikuara nga drejtuesit teknikë të projektit;
- ç) Në rastin e moszbatimit të kërkesave të licencës ose kryerjes së veprimtarisë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, të konstatuara nga IKMKT-ja;
- d) Kur subjekti nuk ka ndjekur formimin vazhdues të detyruar periodik, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- dh) Në rastet e dhënies së dorëheqjes së drejtuesit teknik ose kur licenca e drejtuesit teknik revokohet, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- e) Në rastin kur ndaj administratorit, personit juridik ose drejtuesit teknik është marrë vendim i formës së prerë në një procedim penal, të lidhur me aktivitetin në fushën e projektimit/zbatimit/mbikëqyrjes/ kolaudimit;
- ë) Në rast të fillimit të procedurave për falimentim ose deklarimit me status pasiv të personit juridik;
- f) Në rast të konstatimit nga ana e inspektoratit ose institucioneve të specializuara të dypunësimit me kohë të plotë të drejtuesit teknik të një personi juridik;
- g) Nga mospagesa e kuotizacionit vjetor të licencës brenda afatit të përcaktuar;
- gj) Në çdo rast tjetër të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, të përmendur në pikën 4, të nenit 82, të këtij ligji.

2. Ndaj vendimit për revokimin e licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Neni 85

Detyrimi për ruajtjen

1. Institucionet publike qendrore e vendore, si dhe çdo institucion tjetër publik kanë detyrimin të garantojnë sigurinë dhe ruajtjen e pasurive kulturore në pronësi apo administrim të tyre.

2. Subjektet private, pronarë ose posedues të pasurive kulturore, dhe bashkësitë fetare të regjistruara kanë detyrimin të garantojnë sigurinë dhe ruajtjen e tyre, sipas kushteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 82, të këtij ligji.

3. Subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, inventarizojnë pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrim, duke specifikuar vendndodhjen e tyre. Mënyra dhe forma për mbajtjen e këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Subjektet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, që nuk përmbushin detyrimet, sipas këtij neni, mbajnë përgjegjësi në përputhje me këtë ligj.

Neni 86

Ndërhyrja ruajtëse në pasuritë publike

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore garanton dhe vepron për ruajtjen e pasurive kulturore në pronësi shtetërore edhe kur janë në administrim nga të tretët, në marrëveshje me këto subjekte.

2. Projektimi dhe zbatimi i ndërhyrjeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, realizohet nga subjekti që i ka në administrim. Në çdo rast, subjektet e sipërpërmendura duhet të ndjekin procedurat e parashikuara në nenet 80 dhe 88, të këtij ligji, dhe të lejojnë mbikëqyrjen e punimeve nga organet kompetente.

3. Në çdo rast, shpenzimet për projektimin dhe zbatimin e punimeve sipas pikës 2, të këtij neni, si dhe çdo detyrim tjetër i lidhur me të, mbulohen nga subjekti administrues.

4. Për realizimin e punimeve në pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve të pikës 1, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore i njofton projektin dhe fillimin e punimeve institucioneve publike të interesuara.

5. Organet e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet publike marrin masa për ruajtjen e detyrueshme të pasurive kulturore në pronësi të tyre, në përputhje me nenet 85, 87 e 88, të këtij ligji, dhe legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Neni 87

Ndërhyrja ruajtëse vullnetare

Restaurimi dhe ndërhyrjet e tjera ruajtëse të pasurive kulturore me iniciativë të pronarit, poseduesit apo mbajtësit, kryhen në përputhje me nenin 80 të këtij ligji.

Neni 88

Procedura për miratimin e ndërhyrjeve ruajtëse vullnetare

1. Me kërkesë të pronarit ose poseduesit, DRTK-ja deklaron nevojën e ndërhyrjes dhe përgatit një relacion teknik.

2. Mbi bazën e relacionit teknik të DRTK-së, pronari ose poseduesi merr masa për hartimin e projektit dhe të preventivit përkatës.

3. Projekti, preventivi total dhe preventivi mbi shpenzimet për mbrojtjen e vlerës kulturore të pasurisë kulturore paraqiten për miratim nga KKTKM-ja dhe duhet të përmbajnë specifikimet e nevojshme, si dhe afatin për fillimin e punimeve.

4. KKTKM-ja shprehet me vendim, në përputhje me procedurën e parashikuar në pikat 1 deri në 7, të nenit 92, të këtij ligji.

Neni 89

Shpenzimet për ndërhyrjet vullnetare ruajtëse

1. Shpenzimet për ndërhyrjet vullnetare ruajtëse, të parashikuara nga neni 88, i këtij ligji, mbulohen nga pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore.

2. Ministria, pas marrjes së mendimit të KKTKM-së, mund të zgjedhë të kontribuojë në shpenzimet e parashikuara nga pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore për një shumë jo më të madhe se gjysma e saj.

3. Kur ndërhyrjet kanë rëndësi të veçantë ose kryhen në pasuri në përdorim publik, Ministria mund të zgjedhë të mbulojë tërësisht shpenzimet e ndërhyrjes.

Neni 90

Ndërhyrjet e detyruara ruajtëse

1. Subjektet private, që kanë në pronësi ose në posedim pasuri kulturore, detyrohen të marrin masat për kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme që garantojnë ruajtjen e pasurive që kanë në pronësi ose posedim. Domosdoshmëria e ndërhyrjeve vërtetohet nga DRTK-ja, nëpërmjet përgatitjes së një relacioni teknik.

2. Në rastin e mospërmbljes së detyrimit të kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse nga subjektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr përsipër t'i kryejë vetë këto ndërhyrje.

3. Në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike, procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në rastet e nevojës për kryerjen e investimeve me fonde publike, sipas pikës 3, të këtij neni, institucionet e tjera shtetërore janë të detyruara të marrin autorizimin nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Marrëdhëniet e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me pronarin ose poseduesin e pasurisë kulturore rregullohen në përputhje me këtë ligj.

Neni 91

Ruajtja fizike e detyrueshme

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e specializuara kanë kompetencë të sigurojnë dhe të ruajnë përkohësisht në institucione publike pasuritë kulturore të luajtshme, me qëllim garantimin e sigurisë dhe ruajtjen, sipas parashikimeve të nenit 82 të këtij ligji.

2. Marrëdhënia e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me pronarin e pasurisë kulturore të luajtshme rregullohet në përputhje me këtë ligj.

Neni 92

Procedura e miratimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse

1. DRTK-ja përgatit një relacion teknik dhe deklaron nevojën e ndërhyrjes, sipas nenit 90 të këtij ligji.

2. Relacioni teknik i dërgohet, së bashku me njoftimin e fillimit të procedurës, pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore, të cilët kanë të drejtë të shprehin vërejtjet e tyre brenda 30 ditëve, nga marrja e aktet.

3. DRTK-ja i cakton pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore një afat për paraqitjen e projektit të ndërhyrjeve të nevojshme, në përputhje me relacionin teknik. Në rast se pronari nuk dërgon në KKTKM një projekt dhe preventivin përkatës në afatin e caktuar nga DRTK-ja, vetë DRTK-ja merr masa për hartimin e projektit dhe njofton menjëherë Inspektoratin Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore.

4. Projekti, preventivi total dhe preventivi mbi shpenzimet për mbrojtjen e vlerës kulturore të pasurisë kulturore paraqiten për miratim nga KKTKM-ja dhe duhet të përmbajnë specifikimet e nevojshme, si dhe afatin për fillimin e punimeve.

5. KKTKM-ja shprehet mbi projektin dhe preventivin me vendim, brenda 45 ditëve nga marrja e

kërkesës.

6. Vendimi i KKTKM-së i njoftohet pronarit, duke përcaktuar afatin për zbatimin e punimeve sipas vendimit të KKTKM-së.

7. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankimi pranë organeve gjyqësore kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të KKTKM-së.

8. Nëse pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore nuk përmbush detyrimin e depozitimit të projektit ose nuk zbaton vendimin e KKTKM-së brenda afatit të caktuar, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas komunikimit nga inspektorati/DRTK-ja për mosfillimin e punimeve nga ana e pronarit/poseduesit, ndërhyr duke filluar procedurat e përzgjedhjes së subjektit publik ose privat që do të kryejë punimet, sipas parashikimeve të këtij ligji.

9. Mënyrat e ndërhyrjes nga ministria caktohen me udhëzime të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 93

Shpenzimet për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse

1. Vlera e investimit, sipas preventivit përkatës, dhe detyrimet e tjera financiare të lidhura me ndërhyrjet në pasuritë kulturore, të urdhëruara apo të kryera nga vetë ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas parashikimeve të nenit 92, të këtij ligji, janë në ngarkim të ministrisë dhe pronarit ose poseduesit.

2. Masa e shpenzimit në ngarkim të shtetit është e njëjtë me masën e shpenzimit që mbron vlerën kulturore të pasurisë. Kjo masë, rast pas rasti, caktohet në vendimin e KKTKM-së, sipas nenit 92 të këtij ligji.

3. Shpenzimet në ngarkim të pronarit miratohen me vendim të KKTKM-së, sipas parashikimeve të nenit 92 të këtij ligji.

4. Vlera e shpenzimit dhe afati i shlyerjes së shpenzimeve të pronarit përcaktohen me urdhër të ministrit, i cili përbën titull ekzekutiv, pavarësisht ankimit ndaj vendimit të KKTKM-së, sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 92, të këtij ligji.

5. Mosshlyerja e masës së shpenzimeve sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e ministrit, sipas pikës 4, të këtij neni, e ngarkon subjektin privat me detyrimin për të paguar kamatëvonesat, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 94

Shlyerja e shpenzimeve nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

1. Kontributi financiar shlyhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në favor të subjektit që kryen punimet, i përzgjedhur sipas procedurave të parashikuara në pikën 3, të nenit 90, të këtij ligji.

2. Shlyerja e kontributit financiar bëhet pas përfundimit dhe kolaudimit të punimeve, bazuar në shpenzimet faktike të përfituesit. Me marrëveshje mund të vendoset që shlyerja e detyrimit të kryhet me pagesa periodike, gjatë progresit të zbatimit të projektit, të kontrolluara dhe vërtetuara sipas ligjit.

3. Kontributi financiar i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në rastin e ndërhyrjeve vullnetare ruajtëse, shlyhet prej saj nëpërmjet rimbursimit të pronarit ose poseduesit të pasurisë, sipas marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim.

Neni 95

Hapja për publikun e pasurive kulturore që i janë nënshtuar punimeve për ruajtjen

1. Pasuritë e trashëgimisë kulturore që nuk përdoren për banim nga pronari ose poseduesi i tyre janë të hapura për publikun.

2. Afatet, mënyrat, oraret, shpërblimi dhe të drejtat e detyrimet e pronarit ose të poseduesit për përdorim publik përcaktohen në marrëveshjen e pronarit ose të poseduesit me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Në çdo rast, afatet për hapjen për publikun nuk mund të jenë më shumë se 50 ditë në një vit kalendarik, me përjashtim të rastit kur pronari është dakord për zgjatjen e këtij afati.

3. Në rastin e mosarritjes së një marrëveshjeje ndërmjet pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore me ministrinë, DRTK-ja njofton KKMPK-në. KKMPK-ja vendos vetë për afatet, mënyrat, oraret, shpërblimin dhe të drejtat e detyrimet e pronarit ose të poseduesit dhe i komunikon vendimin pronarit ose poseduesit.

4. Pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore, që nuk zbaton vendimin e KKMPK-së ose marrëveshjen me ministrinë, mban përgjegjësi, sipas parashikimeve të vendimit të KKMPK-së ose marrëveshjes së parashikuar në këtë nen.

Seksioni III

Forma të tjera të mbrojtjes dhe ruajtjes

Neni 96

Masat e mbrojtjes indirekte

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në lidhje me pasurinë kulturore të paluajshme, si dhe Këshilli i Ministrave, për grupimin e pasurive kulturore të paluajshme, kanë kompetencë të përcaktojnë zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, dritën, kushtet mjedisore dhe peizazhin.

2. Kushtet mjedisore dhe peizazhi përcaktohen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

3. Këto masa, për aq sa prekin pasuri të tjera të paluajshme, përbëjnë servitut ligjor dhe regjistrohen si të tilla në kartelat e pasurive që preken nga këto masa, në regjistrin e pasurive të paluajshme, si dhe në regjistrat përkatës pranë IKRTK-së.

4. Shtrirja e zonës mbrojtëse përcaktohet nga organi që deklaron pasurinë kulturore, sipas studimit të bërë nga IKTK-ja ose një institucion tjetër i specializuar.

5. Masat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të miratuara dhe njoftuara sipas parashikimeve të neneve 61, 97 e 98, të këtij ligji, janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga organet kompetente qendrore e vendore në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit dhe pronarët e poseduesit e këtyre pasurive.

6. Moszbatimi i masave të mbrojtjes indirekte përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji.

Neni 97

Procedura për mbrojtjen indirekte

1. Institucionet e specializuara fillojnë procedurën për mbrojtjen indirekte, duke njoftuar drejtpërdrejt pronarin ose poseduesin e pasurive kulturore që preken prej saj. Nëse, për shkak të numrit të madh të pronarëve ose poseduesve, njoftimi individual është i pamundur ose tejet i vështirë, DRTK-ja ose institucioni i specializuar bën njoftimin e parë për fillimin e procedurës, nëpërmjet njëres prej formave të përshtatshme të njoftimit, në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.

2. Njoftimi i fillimit të procedurës, përveç elementeve të njoftimit në bazë të Kodit të Procedurës

Administrative, përmban pasurinë ose pasuritë e paluajtshme, mbi të cilin ose të cilat do të merren masat e mbrojtjes indirekte, llojin e masave të mbrojtjes indirekte, si dhe shpjegon, në mënyrë të përmbledhur, këto masa.

3. Titullari i DRTK-së ose i institucionit të specializuar, kur gjykon se po kryhen ndërhyrje në pasuritë e paluajtshme të përfshira në zonën mbrojtëse, të cilat mund të shkaktojnë një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi pasurinë kulturore, shprehet me vendim të ndërmjetëm për ndalimin e ndërhyrjes në pasuritë e paluajtshme, për sa u përket elementeve, të cilave iu referohen masat e përmendura në njoftim.

4. Vendimi i ndërmjetëm, i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, përfundon nëse IKTK-ja nuk shprehet me vendim përfundimtar për masën e mbrojtjes së përkohshme brenda afatit ligjor të parashikuar në këtë nen ose kur bie shkaku, për të cilin është vendosur kjo masë.

5. Pronarët ose poseduesit e pasurive kulturore kanë të drejtë të paraqesin mendimin e tyre me shkrim brenda 10 ditëve, nga marrja e njoftimit. IKTK-ja vlerëson me shkrim mendimet dhe shpjegimet e pronarëve ose poseduesve brenda 10 ditëve.

6. IKTK-ja shprehet me vendim për masën indirekte brenda 30 ditëve, nga marrja e përgjigjes nga pronarët, sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 98

Njoftimi i masave për mbrojtjen indirekte dhe ankimi

1. Vendimi për masat për mbrojtjen indirekte, i marrë nga IKTK-ja, sipas procedurës së parashikuar në nenin 97, të këtij ligji, i njoftohet pronarit dhe poseduesit të pasurisë ose pasurive të paluajtshme përkatëse, si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet njoftimit të aktit, sipas mënyrave të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative.

2. Kundër aktit, me të cilin është vendosur masa e mbrojtjes indirekte, bëhet ankim sipas përcaktimeve të nenit 66 të këtij ligji. Paraqitja e ankimit nuk sjell pezullimin e efekteve të aktit me të cilin është vendosur masa e mbrojtjes indirekte.

3. Masat pasqyrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe në IKRTK dhe sjellin pasoja për çdo pronar e posedues apo mbajtës të mëvonshëm të pasurisë së paluajtshme, mbi të cilën është vendosur masa.

Neni 99

Kushtet e ruajtjes për shfaqjen e pasurive kulturore në ekspozita dhe panaire

1. Huapërdorja e pasurive kulturore, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, me qëllim shfaqjen në ekspozita, panaire, ngjarje kulturore, lejohet vetëm mbi bazën e lejes së lëshuar për huapërdoruesin nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ekspozohen, me miratim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore:

a) Pasuritë e luajtshme, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 50 të këtij ligji;

b) Pasuritë e luajtshme, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji, të ndryshme nga ato të shkronjës “a”, të këtij neni;

c) Pasuritë e luajtshme të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “d”, të pikës 3, të nenit 50 të këtij ligji;

ç) Koleksione ose elemente të tyre të veçanta, të parashikuara në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 50; koleksione të librave, të parashikuar në nenin 50, pika 2, shkronja “c”, dhe pika 3, shkronja “c”;

d) Pasuri të tjera të parashikuara në lejen e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat për dhënien e miratimit, si dhe nevojat e ruajtjes së pasurive, masat e nevojshme për garantimin e integritetit të tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Miratimi sigurohet nëpërmjet garancisë së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, në vlerën prej

1 për qind të vlerës së pasurisë që ekspozohet.

5. Për ekspozitat dhe panairët që zhvillohen brenda vendit dhe që promovohen nga Ministria ose me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, garancia e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë mund të zëvendësohet me një deklaratë të marrjes përsipër të rrezikut nga institucioni shtetëror që zhvillon ekspozitën ose panairin. Procedurat, mënyrat dhe kushtet për lëshimin e deklaratës përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, parashikuar në pikën 3, të këtij neni.

6. Me qëllim zbatimin e lehtësirave fiskale, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore deklaron, me kërkesë të të interesuarit, interesin kulturor ose shkencor të ekspozitave apo panaireve dhe të çdo iniciative tjetër me karakter kulturor.

7. Shfaqja e pasurive kulturore pa miratim është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, huapërdoruesin. Nëse ka shkaktuar dëmtim të pasurisë kulturore, organi kompetent mund të vendosë edhe detyrimin për shpërblim dëmi.

Neni 100

Kushtet e ruajtjes gjatë veprimtarive kulturore

1. Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve artistike e kulturore në ambientet e pasurive kulturore apo zonat e mbrojtura si pasuri kulturore kryhet me miratim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore miraton, me kërkesë të të interesuarit, interesin kulturor ose shkencor të veprimtarive kulturore dhe të çdo iniciative tjetër me karakter kulturor.

3. Kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatja dhe tarifat përkatëse për dhënien e miratimit të interesit kulturor, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Organizimi i veprimtarive kulturore pa miratim, sipas këtij neni, është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, organizatorin e aktivitetit. Organi kompetent mund të vendosë edhe detyrimin për shpërblim dëmi, nëse është shkaktuar dëmtim i pasurisë kulturore.

Neni 101

Kushtet për vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në pasuritë kulturore dhe fotografimi, filmimi i pasurive kulturore

1. Vendosja ose fiksimi i flamujve, tabelave apo mjeteve të tjera reklamuese në pasuri kulturore të paluajtshme, projektme të ndryshme në to, filmimet dhe fotografimet në ambiente të brendshme apo të jashtme të tyre, si dhe fotografimi, filmimi i pasurive kulturore të luajtshme për qëllime fitimprurëse lejohen me miratim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i cili lejon kryerjen e këtyre veprimeve vetëm nëse vërtetohet se ndërhyrjet nuk dëmtojnë pamjen, dekorin, peizazhin, integritetin ose përdorimin publik të këtyre pasurive, si dhe për një afat kohor të arsyeshëm.

2. Vendosja e flamujve, tabelave, reklamave dhe mjeteve të tjera reklamuese, që mund të përdoren nga subjekti që kryen ndërhyrjet për mbulimin e skelave dhe të strukturave mbajtëse për punimet restauruese apo çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore kryhet vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Kohëzgjatja e miratimit nuk mund të jetë më e madhe se kohëzgjatja e punimeve restauruese apo ndërhyrjeve të tjera ruajtëse. Kërkesës për miratim i bashkëlidhet edhe leja e ndërhyrjeve ruajtëse në pasurinë kulturore.

3. Kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat dhe kohëzgjatja dhe tarifat për dhënien e miratimit, sipas këtij neni, vendosen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që publikohet në Fletoren Zyrtare.

4. Vendosja dhe fiksimi i flamujve, tabelave, reklamave dhe mjeteve të tjera reklamuese, filmimet e fotografimet në ambiente të brendshme apo të jashtme të tyre, si dhe fotografimi, filmimi i pasurive

kulturore të luajtshme në kundërshtim me këtë nen është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, personin përgjegjës.

Neni 102

Kushtet për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore

1. Ushtrimi i aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe peizazhi kryhet në përputhje me kushtet dhe kriteret që përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Udhëzimi i ministrit, sipas pikës 1, të këtij neni, miratohet në konsultim me organet e vetëqeverisjes vendore dhe Këshillin Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kërkesat e subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare miratohen nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në konsultim me KKMPK-në dhe KKTKM-në.

4. Procedura për përzgjedhjen e subjektit për kryerjen e veprimtarive tregtare në zona me pasuri kulturore kryhet sipas udhëzimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni IV

Masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore jomateriale

Neni 103

Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive jomateriale

Dispozitat për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore materiale zbatohen edhe për ruajtjen ose mbrojtjen e pasurive kulturore jomateriale, për aq sa këto masa përputhen me natyrën e tyre.

Neni 104

Masat për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale

1. Për të siguruar ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale krijohet fondi financiar publik, si pjesë përbërëse e buxhetit vjetor të ministrisë. Pjesë e këtij fondi financiar mund të jenë edhe financime brenda vendit apo të huaja, për këtë qëllim, të cilat burojnë nga organizata publike ose private apo persona fizikë.

2. Ky fond administrohet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore pas marrjes së mendimit të KKTKJM-së. Masat dhe kriteret e shpërblimit për veprimtari e aktivitete të fushës së vlerave jomateriale përcaktohen në këtë udhëzim.

3. Financimi i veprimtarive kulturore të kësaj fushe të trashëgimisë kulturore nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik, por dispozitave të këtij ligji.

4. Me qëllim që të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, të pranishme në territorin shqiptar, merren këto masa:

a) Hartimi i politikave të përgjithshme, që synojnë vënien në pah të funksionit të trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri dhe integrojnë ruajtjen e këtyre vlerave në programe planifikimi;

b) Krijimi apo caktimi i organizmave kompetentë për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë jomateriale të pranishme në të gjithë territorin e vendit;

c) Nxjtja e studimeve shkencore, teknike dhe artistike, si dhe krijimi i metodologjisë kërkimore për një ruajtje e mbrojtje të efektshme të trashëgimisë jomateriale, në veçanti të asaj në rrezik;

ç) Miratimi i masave juridike, teknike, administrative dhe financiare përkatëse, me synim:

i. forcimin e institucioneve që kanë në administrim vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe mbështetjen e tyre financiare për programet për ruajtjen, mbrojtjen e menaxhimin e vlerave kulturore jomateriale;

ii. mbështetjen e propozimeve të institucioneve qendrore e vendore, institucioneve të specializuara,

organizmave dhe shoqatave të ndryshme, subjekteve juridike publike apo private, personave fizikë e juridikë, për të promovuar festivale, konkurse, programe, projekte dhe veprimtari me karakter kombëtar e vendor në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke favorizuar përcjelljen e kësaj trashëgimie në hapësirat e destinuara për paraqitjen dhe shprehjen e saj;

iii. marrjen e sanksioneve, sipas parashikimeve të këtij ligji, për individë, shoqata apo institucione të ndryshme, të cilët denigrojnë apo prishin imazhin e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale kombëtare në veprimtari kombëtare apo vendore, nisur nga monitorimi i çdo veprimtarie të trashëgimisë kulturore jomateriale që realizon ministria përgjegjëse për trashëgiminë jomateriale.

Neni 105

Edukimi nëpërmjet trashëgimisë kulturore jomateriale

1. Për të siguruar edukimin dhe njohjen e brezave të rinj me vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale në përgjithësi, si edhe për të respektuar diversitetin kulturor të pakicave kombëtare, ministria përgjegjëse e trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, merr masa të veçanta nëpërmjet mbështetjes së:

a) Realizimit të botimeve edukative dhe sensibilizuese shkollore e jashtëshkollore;

b) Programeve të posaçme edukative;

c) Sigurimit për njohjen, respektimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri, veçanërisht nëpërmjet:

i. programeve edukative, sensibilizuese dhe përhapëse të informacionit për publikun, sidomos të rinjtë;

ii. programeve të posaçme për edukim dhe formim, brenda bashkësive dhe grupeve të interesuara.

2. Masat për njohjen, respektimin, përhapjen dhe vlerësimin e kësaj fushe të trashëgimisë kulturore miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

TITULLI III

QARKULLIMI CIVIL DHE FIZIK I PASURIVE KULTURORE

Kreu I

Regjimi juridik i pasurive kulturore

Seksioni I

Tjetërsimi dhe mënyra të tjera transferimi të pronësisë së pasurive kulturore

Neni 106

Pasuritë kulturore publike

1. Pasuritë kulturore në pronësi të shtetit, organeve të vetëqeverisjes vendore dhe personave juridikë të tjerë publikë, që përfshihen në tipologjitë e pronave të paluajtshme publike, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit, dhe çdo pasuri e ngjashme, që mund të zbulohet në të ardhmen, janë pasuri kulturore publike, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, që rregullojnë përkatësinë e sendeve.

2. Janë, po ashtu, pasuri kulturore publike edhe pronat e luajtshme, që kanë karakter publik të ngjashëm me atë të pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për aq sa ato tipologji mund t'u përshtaten sendeve të luajtshme.

3. Pasuritë publike kulturore nuk mund të tjetërsohen dhe as të formojnë objekt të drejtash në favor të të tretëve, apo të rëndohen me barrë, me përjashtim të rasteve dhe mënyrave të parashikuara nga ky ligj.

Neni 107

Pasuritë kulturore publike të patjetërsueshme

1. Ndalohet tjetërsimi i pasurive kulturore publike, për:
 - a) Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në zonat arkeologjike;
 - b) Pasuritë e paluajtshme të shpallura “Monumente të Kulturës Kombëtare”, sipas akteve të kohës kur janë shpallur të tilla, pavarësisht ndryshimeve të parashikuara nga ky ligj;
 - c) Pasuritë e paluajtshme të deklaruara me interes të veçantë, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 50, të këtij ligji;
 - ç) Fondet e pasurive kulturore, koleksionet muzeore, të pinakotekave, galerive e të bibliotekave;
 - d) Arkivat;
 - dh) Pasuritë e luajtshme, që janë vepra të autorëve të gjallë, ose krijimi i të cilave nuk është bërë më shumë se 50 vjet më parë, nëse janë të përfshira në koleksione objektesh, të cilat u përkasin subjekteve të parashikuara në nenin 106 të këtij ligji.
2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të transferohen ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore ose të institucioneve të tjera publike vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në rastin e pasurive, të cilat nuk janë në përdorim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ky transferim i njoftohet asaj, si dhe IKRTK-së, për efekt regjistrimi.
3. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të përdoren ekskluzivisht sipas mënyrave dhe në përputhje me titullin V, kreun II, të kësaj pjese të ligjit.

Neni 108

Pasuri të tjera të patjetërsueshme

1. Nuk mund të tjetërsohen përkohësisht pasuritë që u përkasin subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji, nëse janë vepra të autorëve që nuk janë gjallë ose nga krijimi i të cilave kanë kaluar më shumë se 50 vjet, nëse janë të luajtshme, ose më shumë se 70 vjet, nëse janë të paluajtshme, deri në përfundimin e procedurës së verifikimit, të parashikuar nga neni 57 i këtij ligji.
2. Nëse procedura sipas pikës 1, të këtij neni, mbyllet me vlerësim negativ, këto pasuri mund të tjetërsohen lirisht, mbështetur në dispozitat e këtij ligji, sipas përcaktimeve të nenit 57 të këtij ligji. Nëse kjo procedurë mbyllet me vlerësim pozitiv, pasuria kulturore i nënshtrohet regjimit të qarkullimit të pasurive kulturore në pronësi private, në përputhje me këtë ligj.
3. Nuk mund të tjetërsohen, gjithashtu, dokumentet individuale, si dhe arkivat e dokumentet individuale të institucioneve publike.
4. Tjetërsimi i pasurive kulturore në kundërshtim me ndalimet e këtij neni dhe të neneve 106 e 107, të këtij ligji, përbëjnë shkelje dhe subjektet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi, sipas këtij ligji.
5. Pasuritë e luajtshme, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 107, dhe në pikën 2, të këtij neni, mund të eksportohen në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 109

Tjetërsimi i pasurive kulturore jopublike në pronësi të shtetit

1. Pasuritë kulturore shtetërore të luajtshme, të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 106, pika 1, dhe 107, pika 1, të këtij ligji, tjetërsohen vetëm pas marrjes së miratimit për tjetërsim me vendim të Këshillit të Ministrave dhe regjistrohen pranë IKRTK-së.
2. Kërkesës për tjetërsim i bashkëlidhen:
 - a) të dhënat mbi destinacionin e përdorimit të pasurisë kulturore;
 - b) programi për marrjen e masave të nevojshme për ruajtjen e pasurisë kulturore;

c) të dhënat mbi qëllimin dhe vlerën që synohen të arrihen me tjetërsimin e pasurisë, si dhe mënyrat dhe koha e parashikuar për realizimin e tyre;

ç) mënyrat e shfrytëzimit nga publiku të pasurisë kulturore.

3. Pas marrjes së çdo kërkesë, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore hap një konkurrim publik për përzgjedhjen e subjektit, të cilit do t'i transferohet pasuria kulturore. Procedurat dhe kriteret e këtij konkurrimi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Shpallja e fituesit të konkurrencës publik kryhet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas konsultimit me institucionet e specializuara të fushës. Njëkohësisht, me shpalljen e fituesit, ministri jep miratimin për transferim, i cili, ndër të tjera, duhet të përcaktojë:

a) Kushtet që garantojnë masat e ruajtjes;

b) Kushtet e gëzimit publik të pasurisë, duke vlerësuar situatën që do të krijohet pas ndryshimit të destinacionit;

c) Mënyrat dhe afatet për realizimin e qëllimit dhe të vlerësimit që synohet nga transferimi.

5. Miratimi për transferim nuk jepet kur destinacioni i propozuar i përdorimit mund të krijojë vështirësi për ruajtjen dhe gëzimin nga publiku të pasurisë ose, gjithsesi, nuk përputhet me karakterin historik e artistik të pasurisë në fjalë. Këshilli i Ministrave ka kompetencë të përcaktojë, në aktin i cili refuzon dhënien e miratimit, destinacionet e përdorimit që vlerësohen të përshtatshme me karakterin e pasurisë dhe nevojat për ruajtjen e saj.

6. Miratimi për tjetërsim sjell heqjen e objektit nga fondi i pasurive kulturore shtetërore. Kjo pasuri, në çdo rast, u nënshtrohet të gjitha dispozitave të mbrojtjes dhe ruajtjes të parashikuara në këtë ligj.

7. Subjekti i shpallur fitues lidh kontratën për blerjen e pasurisë kulturore, të rregulluar sipas dispozitave të Kodit Civil dhe këtij ligji.

8. Kryerja e ndërhyrjeve të çdo lloji në pasuritë e tjetërsuara i nënshtrohet lejes së parashikuar në pikat 2 e 3, të nenit 77, të këtij ligji.

Neni 110

Shkelja e kushteve të tjetërsimit

1. Kushtet e tjetërsimit që garantojnë masat e ruajtjes, gëzimin publik të pasurisë, mënyrat për realizimin e qëllimit dhe të vlerësimit që synohet nga transferimi, si dhe përdorimin në përputhje me karakterin historik e artistik të pasurisë në fjalë janë kushte kontraktuese që duhet të përfshihen në aktin e tjetërsimit.

2. Shkelja e kushteve të miratimit, sipas pikës 1, të këtij neni, përbën shkak për zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Penalitetet që mund të jenë vendosur për shkelje të dispozitave të këtij ligji zbriten nga çmimi që i kthehet subjektit.

3. DRTK-ja dhe institucionet e specializuara, kur konstatojnë shkeljen e kushteve të parashikuara në aktin e tjetërsimit, njoftojnë subjektin, të cilit i ka kaluar pasuria, mbi shkeljen e kushtit dhe paralajmërojnë zgjidhjen e kontratës.

4. DRTK-ja ose institucionet e specializuara njoftojnë për shkeljen e konstatuar ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Inspektoratin Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Me urdhër të ministrit vendoset për zgjidhjen e kontratës, në përputhje me këtë ligj.

Neni 111

Tjetërsimi i pasurive kulturore në favor të shtetit

Aktet e tjetërsimit në favor të shtetit të pasurive kulturore nuk janë objekt miratimi për tjetërsim në kushtet e pikës 1, të nenit 109, të këtij ligji.

Neni 112

Pasuritë kulturore në pronësi private

1. Pasuritë kulturore, të cilat janë në pronësi të subjekteve private, janë objekt qarkullimi civil, në përputhje me këtë ligj.

2. Aktet që tjetërsojnë tërësisht ose pjesërisht, me çdo lloj titulli, pronësinë ose posedimin e pasurive kulturore i njoftohen IKRTK-së dhe zyrave të saj rajonale brenda 30 ditëve.

3. Njoftimi i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, ushtrohet:

a) Nga shitësi ose poseduesi, në rastin e tjetërsimit ose ndryshimit të posedimit;

b) Nga blerësi, në rastin e kalimit të pronësisë në kushtet e një procedure ekzekutimi të detyrueshëm ose falimentimi;

c) Nga trashëgimtari ose legatari, në rast të ndërrimit të pronësisë për shkak të vdekjes.

4. Njoftimi i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të përmbajë:

a) Të dhënat personale të palëve në kontratë dhe nënshkrimin e tyre ose të përfaqësuesve të tyre ligjorë;

b) Të dhënat identifikuese të pasurisë së transferuar;

c) Të dhënat për identifikimin e vendndodhjes së pasurisë;

ç) Të dhëna për llojin dhe kushtet e aktit të transferimit;

d) Të dhënat e vendbanimit në Shqipëri të palëve, me qëllim njoftimin/komunikimin ndërmjet tyre, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Moszbatimi i këtij detyrimi sjell pavlefshmërinë absolute të aktit të tjetërsimit dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, personin përgjegjës për njoftimin e transferimit.

Seksioni II

E drejta e parablerjes

Neni 113

E drejta e parablerjes

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucionet e tjera publike mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për pasuritë kulturore në pronësi të subjekteve private, në rastin e tjetërsimit me kundërshtëpërblim, sipas vlerës së caktuar në aktin e tjetërsimit ose të posedimit.

2. E drejta e parablerjes mund të ushtrohet edhe kur pasuria është dhënë në shlyerje të një detyrimi.

3. E drejta e parablerjes ushtrohet duke respektuar parashikimet e Kodit Civil për parablerjen.

Neni 114

Kushte për ushtrimin e së drejtës së parablerjes

1. E drejta e parablerjes mund të ushtrohet brenda 50 ditëve nga paraqitja e njoftimit, sipas nenit 112 të këtij ligji.

2. Në rastin kur njoftimi i ushtruar brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, është i paplotë, IKRTK-ja njofton pronarin për të metat e njoftimit dhe i kërkon t'i plotësojë ato brenda 5 ditëve. Afatet për ushtrimin e së drejtës së parablerjes pezullohen deri në ditën e plotësimit të njoftimit me të gjitha elementet e nevojshme të parashikuar në pikën 4, të nenit 112, të këtij ligji. Në rastin kur njoftimi i ushtruar është paraqitur me vonesë, afati i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, fillon nga moment i njoftimit të vonuar.

3. Vendimi për parablerjen e pasurisë kulturore i njoftohet tjetërsuesit dhe përfituesit brenda afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Gjatë afatit të përcaktuar në këtë nen, tjetërsuesit i ndalohet të dorëzojë pasurinë kulturore.

5. Me përjashtim të çmimit, asnjë nga detyrimet e tjera kontraktuese, me të cilat kanë rënë dakord palët, nuk mund t'i kërkohej shtetit.

Neni 115

Procedura për ushtrimin e së drejtës së parablerjes

1. IKRTK-ja, pas marrjes së njoftimit, sipas nenit 112, të këtij ligji, publikon menjëherë në Buletinin e Publikimeve Zyrtare, për 10 ditë, një njoftim për shitjen e pasurisë, së bashku me një përshkrim të pasurisë, si dhe çmimin e shitjes.

2. IKRTK-ja, pas 10 ditëve nga njoftimi, i paraqet ministrisë propozimin për parablerje. Propozimi shoqërohet me relacion, me arsyet e parablerjes së pasurisë, koston financiare për përvetësimin e pasurisë, si dhe hapat që do të ndërmerren për vlerësimin e saj. Relacionit i bashkëlidhet dhe vendimi i organit kompetent për mbulimin e shpenzimeve.

3. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore shprehet mbi propozimin brenda 30 ditëve nga marrja e tij.

4. Ministria mund të refuzojë ushtrimin e së drejtës së parablerjes dhe ia transferon këtë të drejtë një subjekti ose personi juridik publik të interesuar. Subjekti ose personi juridik publik i interesuar merr përsipër të mbulojë kostot, fillon procedurën e parablerjes dhe ia njofton tjetërsuesit, jo më shumë se 10 ditë nga marrja e njoftimit nga ministria. Pronësia e pasurisë i kalon institucionit që ka ushtruar të drejtën e parablerjes.

5. Nëse subjektet e parashikuara në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, nuk shprehen me vendim brenda afatit, do të konsiderohet se kanë refuzuar kërkesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

6. Afatet, sipas këtij neni, fillojnë të llogariten nga e nesërmja e ditës kur organet kompetente kanë marrë njoftimin ose kur janë informuar lidhur me të gjitha elementet e nevojshme të parashikuar në pikën 4, të nenit 112, të këtij ligji.

Neni 116

Tregtia e pasurive kulturore

1. Veprimtaria tregtare e pasurive kulturore ushtrohet nga subjektet tregtare të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Licencimi i subjekteve tregtare që kryejnë veprimtari tregtare të pasurisë kulturore rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Licencimi i subjekteve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, bëhet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ushtrimi i kësaj veprimtarie është objekt kontrolli dhe inspektimi, në përputhje me këtë ligj.

3. Kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe tarifa e kuotizacionit vjetor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Subjektet tregtare, që ushtrojnë tregtinë e pasurive të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, mbajnë një regjistër ku shënojnë origjinën e secilit artikull të pasurisë kulturore, emrat dhe adresat e firmës furnizuese, përshkrimin dhe çmimin e secilit artikull të shitur.

5. Informacioni në lidhje me shitjet e pasurive kulturore do të përfshihet në një regjistër të tregtimit të pasurive kulturore, i cili mbahet nga zyra/drejtoria kompetente e IKRTK-së në territorin ku ushtrohet aktiviteti tregtar.

6. Subjektet tregtare, që ushtrojnë tregtinë e pasurive të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kanë detyrimin të përditësojnë regjistrin e parashikuar në pikën 5, të këtij neni, nëpërmjet raportimeve gjashtëmujore. Raportimet, sipas kësaj pike, përfshijnë informacionin e nevojshëm për identifikimin e

pasurisë dhe një përshkrim të shkurtër të pasurive të shitura.

7. Krijimi dhe funksionimi i “Regjistrit të Tregtimit të Pasurive Kulturore”, që mbahet nga IKRTK-ja, rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

8. Vlerat, mbi të cilat është i detyrueshëm një përshkrim më i detajuar i pasurive kulturore, objekt të veprimeve tregtare, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

9. Tregtimi i pasurisë kulturore, në kundërshtim me detyrimet e këtij neni, është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, subjektin përkatës.

Neni 117

Kriteret e licencimit

Licenca për veprimtarinë tregtare të pasurive kulturore u jepet individëve ose personave juridikë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 118

Revokimi i licencës

1. Licenca e veprimtarive tregtare të pasurisë kulturore mund të revokohet me vendim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas marrjes së mendimit nga KKMPK-ja, në rastet e mëposhtme:

- a) Kur kryen veprimtari tregtimi në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- b) Kur tregton pasuri kulturore në mashtrim të ligjit;
- c) Kur nuk zbaton kushtet e licencës;
- ç) Kur dënohet penalisht;
- d) Në rast falimentimi ose likuidimi.

2. Ndaj vendimit për revokimin e licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Neni 119

Detyrimet e tregtarit të pasurive kulturore

1. Kushdo, që ushtron veprimtari tregtare për shitjen e veprave të pikturës, skulpturës, grafikës, si dhe objekteve antike, ose që paraqesin interes historik, ka detyrimin t’i dorëzojë blerësit dokumentacionin që vërteton origjinalitetin dhe prejardhjen e këtyre veprave. Në pamundësi për të lëshuar një dokument të tillë, sipas kërkesave të këtij ligji, shitësi duhet të lëshojë një deklaratë që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që vërteton origjinalitetin.

2. Në çdo rast, subjekti tregtar ka detyrimin të informojnë blerësin e pasurisë kulturore se nxjerrja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të kësaj pasurie rregullohet me këtë ligj.

Seksioni III

Shpronësimi

Neni 120

Shpronësimi i pasurive kulturore

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore shpronëson ose merr në përdorim të përkohshëm pasuri kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

2. Përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për shpronësimet, shpronësimi për interes publik mund të kryhet edhe për shkaqet e mëposhtme:

- a) për përmirësimin e kushteve të mbrojtjes, ruajtjes dhe gëzimit publik të këtyre pasurive;

b) për ndërtesa dhe troje kur shpronësimi është i nevojshëm për të evidentuar apo restauruar pasuritë kulturore të paluajtshme, për t'iu siguruar dritë ose perspektivë, garantuar ose rritur dekorin, gëzimin dhe hapjen për publikun;

c) për pasuritë e paluajtshme, me qëllim ndërhyrjet me karakter arkeologjik ose kërkime për gjetjen e pasurive të përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji.

Kreu II

Qarkullimi ndërkombëtar i pasurive kulturore

Seksioni I

Parimet e qarkullimit ndërkombëtar

Neni 121

Kontrolli mbi qarkullimin

1. Kontrolli mbi qarkullimin ndërkombëtar ka për qëllim të sigurojë ruajtjen dhe tërësinë e trashëgimisë kulturore të përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Kontrolli i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kryhet sipas dispozitave të këtij kreu, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

3. Ndalohet importi, eksporti ose kalimi i pronësisë së pasurive kulturore në kundërshtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

4. Kthimi në territor dhe dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të pasurive kulturore të importuara ose eksportuara në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, rregullohet me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera ose organizatave ndërkombëtare.

Neni 122

Parimet në lidhje me nxjerrjen e paligjshme të pasurive kulturore të luajtshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Pasuritë kulturore të luajtshme, të cilat janë nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të këtij neni, kthehen në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

2. Konsiderohet e paligjshme dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë e vlerave kulturore të parashikuara në këtë ligj, në këto raste:

a) Kur nxirret nga territori i Republikës së Shqipërisë në shkelje të rregullave për mbrojtjen e pasurive kulturore të luajtshme të përcaktuara në këtë ligj;

b) Kur nuk kthehet në fund të një periudhe të caktuar nga koha e largimit të ligjshëm, të përkohshëm, ose të ndonjë shkeljeje tjetër.

3. Konsiderohen të dala në mënyrë të paligjshme edhe ato pasuri kulturore, për të cilat është autorizuar dalja e përkohshme, por që nuk janë zbatuar kushtet dhe masat e pasqyruara në licencën e daljes.

Seksioni II

Dalja e pasurive kulturore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Neni 123

Dalja pa kthim

1. Ndalohet dalja pa kthim nga territori i Republikës së Shqipërisë i pasurive kulturore të luajtshme,

të përcaktuara në pikat 1, 2, 3, të nenit 50, të këtij ligji.

2. Gjithashtu, ndalohet dalja pa kthim e pasurive:

a) Të luajtshme, që iu përkasin subjekteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji, që janë vepra të autorëve që nuk jetojnë dhe që janë krijuar më shumë se 50 vjet më parë, për aq kohë sa nuk është kryer verifikimi i parashikuar në nenin 57 të këtij ligji;

b) Pavarësisht përkatësisë, të cilat hyjnë në kategoritë e përcaktuara në pikën 3, të nenit 50, të këtij ligji, dhe që në kartelën e të cilave institucioni i specializuar ka vendosur që për një periudhë të caktuar kohe të ndalojë daljen e objektit, pasi është e dëmshme për trashëgiminë kulturore, për shkaqe objektive të prejardhjes apo pronësisë së këtyre pasurive.

3. Lejohet dalja pa kthim nga territori i Republikës së Shqipërisë, pas lëshimit të licencës së qarkullimit të lirë të pasurive, sipas përcaktimeve të këtij kreu, për:

a) Pasuritë kulturore të deklaruara, sipas parashikimeve të këtij ligji, të cilat, pavarësisht përkatësisë, janë vepër e autorëve që nuk jetojnë dhe që janë krijuar më shumë se 50 vite më parë;

b) Arkivat dhe dokumentet e veçanta, në pronësi private, që janë deklaruar pasuri kulturore;

c) Pasuritë kulturore të deklaruara, të cilat hyjnë në kategoritë e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, të pikës 1, të nenit 51, të këtij ligji, pavarësisht përkatësisë.

4. Lejohet dalja pa kthim, pa nevojën e lëshimit të licencës së qarkullimit të lirë, për pasuritë kulturore të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 51, të këtij ligji. Në çdo rast, të interesuarit kanë detyrimin të provojnë përpara autoriteteve doganore kompetente që pasuritë, të cilat transferohen jashtë vendit, janë vepra të autorëve të gjallë ose që nuk janë krijuar më shumë se 50 vite më parë, sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Subjektet që nxjerrin pa kthim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pasuritë e përcaktuara në kundërshtim me parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mbajnë përgjegjësi sipas këtij ligji.

Neni 124

Dalja e përkohshme

1. Ndalohet dalja e përkohshme e pasurive kulturore që janë objekte:

a) Që dëmtohen lehtësisht gjatë transportit dhe nga qëndrimi në kushte ambientale të papërshtatshme;

b) Që përbëjnë fondin thelbësor të një seksioni të rëndësishëm dhe organik të një muzeu, pinakoteke, galerie, arkivi ose biblioteke, apo një koleksioni artistik ose bibliografik.

2. Lejohet dalja e përkohshme nga territori i Republikës së Shqipërisë e pasurive kulturore të përcaktuara në pikën 1 dhe shkronjën “a”, të pikave 2 e 3, të nenit 123, të këtij ligji, në kushtet e nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, për përdorimin e tyre në aktivitete të ndryshme, ekspozita, panairë me interes kulturor, duke garantuar ruajtjen, tërësinë dhe sigurinë e tyre.

3. Lejohet edhe dalja e përkohshme për pasuritë kulturore të përcaktuara në pikën 1, shkronja “a”, të pikave 2 e 3, të nenit 123, të këtij ligji, në rastet kur urdhri i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore parashikon se:

a) Këto pasuri janë orendi private të shtetasve shqiptarë, të cilët kryejnë shërbim diplomatik ose konsullor pranë përfaqësive shqiptare të akredituara jashtë vendit, si dhe pranë organizatave ndërkombëtare, detyra që kërkojnë transferimin e tyre jashtë shtetit për një periudhë jo më të gjatë se mandati i tyre;

b) Këto pasuri janë objekte mobilimi të selive diplomatike ose konsullore jashtë vendit;

c) Këto pasuri duhet t'u nënshtrohen analizave, kërkimeve apo ndërhyrjeve për ruajtjen, të cilat duhet të kryhen detyrimisht jashtë vendit;

ç) Dalja e tyre parashikohet në zbatim të marrëveshjeve kulturore të nënshkruara me institucione muzeore të huaja, me regjim reciprociteti dhe me kohëzgjatje të përcaktuar në marrëveshjet në fjalë. Afati

i marrëveshjes, në këtë rast, nuk mund të jetë më i madh se katër vjet, i rinovueshëm vetëm një herë.

4. Lejimi i daljes së përkohshme nga territori i Republikës së Shqipërisë sigurohet nëpërmjet lëshimit të licencës së qarkullimit të përkohshëm.

Neni 125

Licenca e qarkullimit të lirë

1. Eksporti i pasurive të luajtshme kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera kryhet pas pajisjes me licencë të qarkullimit të lirë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me parashikimet ndërkombëtare të fushës.

2. Subjekti, i cili kërkon të nxjerrë pa kthim nga territori i Republikës së Shqipërisë pasuritë e përcaktuara në pikën 3, të nenit 123, të këtij ligji, pajiset me licencën e qarkullimit të lirë, duke deklaruar në zyrën për çështjet e eksportit pranë IKRTK-së:

a) Qëllimin për nxjerrjen pa kthim të pasurisë;

b) Vlerën për secilën pasuri, duke përcaktuar në të njëjtën kohë për secilën prej tyre vlerën në para.

3. Zyra për çështjet e eksportit, pasi konstaton përputhshmërinë e vlerës së deklaruar me vlerën e referencës të certifikuar nga një vlerësues i pasurive kulturore të luajtshme, të licencuar në bazë të parashikimeve të këtij ligji, verifikon nëse pasuritë e prezantuara janë të regjistruara në regjistrat përkatës. Për kryerjen e këtij vlerësimi, zyrat e eksportit mbështeten në përcaktimet e përgjithshme të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në listën e çmimeve të referencës, të miratuar çdo vit me vendim të komisionit të vlerësimit pranë IKRTK-së.

4. Pas kryerjes së verifikimeve, sipas pikës 3, të këtij neni, zyra për çështjet e eksportit shprehet me vendim të arsyetuar mbi kërkesën për lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë, duke njoftuar të interesuarin jo më vonë se 40 ditë nga marrja e kërkesës.

5. Licenca e qarkullimit të lirë lëshohet nga titullari i IKRTK-së, në bazë të vendimit të zyrës për çështjet e eksportit për një afat trevjeçar. Licenca lëshohet në tri kopje origjinale, prej të cilave njëra mbetet me praktikën e zyrës së eksportit pranë IKRTK-së për ta vendosur në Regjistrin Zyrtar të Licencave të Qarkullimit të Lirë; një e dytë i jepet të interesuarit dhe duhet të shoqërojë qarkullimin e objektit/pasurive dhe e treta i dërgohet autoritetit doganor.

6. Licenca e qarkullimit të lirë paraqitet në mbështetje të deklaratës së eksportit, formalitet doganor i eksportimit të pasurive kulturore që kryhet pranë zyrës doganore kompetente.

Neni 126

Ankimi kundër vendimit për refuzimin e lëshimit të licencës së qarkullimit të lirë

1. Vendimi për refuzimin e lëshimit të licencës së qarkullimit të lirë mund të ankimohet te titullari i IKRTK-së brenda 30 ditëve, nga njoftimi i vendimit. Në rastin kur zyra kompetente për eksportin nuk shprehet me vendim brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, subjektit i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e ditës kur duhet të përfundojë afati i njoftimit të vendimit.

2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ kryhet në përputhje me parashikimet e Kodit për Procedurën Administrative për shqyrtimin e ankimit administrativ.

3. Vendimi i titullarit të IKRTK-së, që refuzon lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë, mund të ankimohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe shqyrtimin gjyqësor të mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 127

Blerja e detyrueshme

1. Ministria ka kompetencë të blejë pasuritë me vlerën e deklaruar në pikën 2, të nenit 125, të këtij ligji. Në këtë rast, afati për lëshimin e licencës zgjatet me 60 ditë.

2. Zyra për çështjet e eksportit, për shkak të vlerave të veçanta dhe/ose unike të pasurive për të cilat kërkohet licenca e qarkullimit të lirë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 125, të këtij ligji, për sa kohë nuk ka marrë vendim për lëshimin ose refuzimin e licencës, mund t'i propozojë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore blerjen e detyrueshme të pasurive për të cilat kërkohet licenca e qarkullimit të lirë.

3. Të interesuarit i njoftohet vendimi për blerjen e detyrueshme brenda afatit 90-ditor, nga data e depozitimit të kërkesës për lëshimin e licencës.

4. Deri në momentin e njoftimit të vendimit për blerjen e detyrueshme, i interesuari ka të drejtë të kërkojë pezullimin e procedurës për dhënien e licencës dhe të kërkojë tërheqjen e pasurisë kulturore.

Neni 128

Licenca e qarkullimit të përkohshëm

1. Eksporti i përkohshëm i pasurive të luajtshme kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera kryhet pas pajisjes me licencë të qarkullimit të përkohshëm, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me parashikimet ndërkombëtare të fushës.

2. Subjekti, i cili kërkon të nxjerrë përkohësisht nga territori i Republikës së Shqipërisë pasuritë e përcaktuara në nenin 124, të këtij ligji, paraqet pranë zyrës kompetente për eksportin pranë IKRTK-së kërkesën për pajisje me licencën e qarkullimit të përkohshëm, duke deklaruar:

a) Qëllimin për nxjerrjen e përkohshme të pasurisë;

b) Urdhrin e ministrit përgjegjës, sipas parashikimit të pikave 2 e 3, të nenit 121, të këtij ligji, nëse janë të zbatueshme;

c) Vlerën për secilën pasuri, duke përcaktuar, në të njëjtën kohë, për secilën prej tyre vlerën në para.

ç) Entitetin që do të kujdeset për pasuritë kulturore jashtë Republikës së Shqipërisë.

3. Zyra për çështjet e eksportit, pasi konstaton përputhshmërinë e vlerës së deklaruar me vlerën e referencës, të certifikuar nga një vlerësues i pasurive kulturore të luajtshme, të licencuar në bazë të parashikimeve të këtij ligji, verifikon nëse pasuritë e prezantuara janë të regjistruara në regjistrat përkatës. Për kryerjen e këtij vlerësimi zyrat e eksportit mbështeten në përcaktimet e përgjithshme të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në listën e çmimeve të referencës, të miratuar çdo vit me vendim të komisionit të vlerësimit pranë IKRTK-së.

4. Pas kryerjes së verifikimeve sipas pikës 3, të këtij neni, zyra për çështjet e eksportit shprehë vendim të arsyetuar mbi kërkesën për lëshimin e licencës së qarkullimit të përkohshëm, duke njoftuar të interesuarin jo më vonë se 40 ditë nga marrja e kërkesës. Në vendim përcaktohen rregullat dhe kushtet e nevojshme për qarkullimin e përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të pasurive kulturore, objekt shqyrtimi.

5. Kundër vendimit të refuzimit lejohet ankimi pranë titullarit të IKRTK-së.

6. Licenca e qarkullimit të përkohshëm lëshohet nga titullari i IKRTK-së, në bazë të vendimit të zyrës për çështjet e eksportit. Licenca përmban afatin e qëndrimit jashtë vendit të pasurive të pajisura me licencën e qarkullimit të përkohshëm. Afati i qëndrimit të pasurive jashtë vendit nuk mund të jetë më shumë se 18 muaj nga dalja jashtë territorit.

7. Licenca lëshohet në tri kopje origjinale, prej të cilave njëra mbetet me praktikën e zyrës së eksportit pranë IKRTK-së, për ta vendosur në Regjistrin Zyrtar të Licencave të Qarkullimit të Lirë; një e dytë i jepet të interesuarit dhe duhet të shoqërojë qarkullimin e objektit/pasurive dhe e treta i dërgohet autoritetit doganor.

8. Licenca e qarkullimit të lirë paraqitet në mbështetje të deklaratës së eksportit, formalitet doganor i eksportimit të pasurive kulturore që kryhet pranë zyrës doganore kompetente.

9. Licenca për qarkullimin e përkohshëm lëshohet me kushtin që pasuria kulturore të jetë e pajisur me policën e sigurimit ose garancinë bankare. I interesuari paraqet policën e sigurimit në vlerën e përcaktuar

në kërkesën për autorizim. Në rastin e panairove dhe ekspozitave të organizuara jashtë vendit nga institucionet publike, polica e sigurimit/garancia bankare mund të zëvendësohet me autorizimin e institucionit publik, sipas parashikimeve të këtij ligji.

10. Në rast se pasuritë e pajisura me licencë të qarkullimit të përkohshëm nuk rikthehen në territorin e Republikës së Shqipërisë brenda afatit të përcaktuar, vlera e garancisë kalon në favor të autoritetit kompetent publik.

11. Garancia e përcaktuar në këtë nen nuk kërkohet për pasuritë kulturore në pronësi shtetërore. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mund të përjashtojë nga detyrimi për pagesën e garancisë institucionet kulturore të rëndësisë së veçantë.

12. Ndaj vendimit të zyrës kompetente të eksportit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative.

Seksioni III

Hyrja e pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 129

Hyrja e pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Hyrja e pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë, të parashikuara në pikën 3, të nenit 123, të këtij ligji, lejohet kundrejt lëshimit, paraprakisht, të licencës së importit nga zyra kompetente për çështjet e eksportit, me kërkesë të subjektit të interesuar.

2. Kërkesës për lëshimin e licencës së importit i bashkëlidhet dokumentacioni i nevojshëm për identifikimin e pasurisë dhe të vendit nga i cili vjen. Për këtë qëllim, subjekti i interesuar duhet të depozitojë:

a) Dokumentacionin identifikues të pasurisë kulturore, të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës;

b) Dokumentacionin provues dhe identifikues të prejardhjes së saj nga vendi që vjen;

c) Dokumentacionin që ka lejuar daljen e pasurisë kulturore nga vendi i origjinës.

3. Zyra kompetente për çështjet e eksportit duhet të shqyrtojë kërkesën dhe të shprehet me vendim sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, brenda 40 ditëve nga depozitimi i kërkesës për marrjen e licencës.

4. Licencat e lëshuara në bazë të pikës 1, të këtij neni, jepen për aq kohë sa është lëshuar dokumenti që ka lejuar daljen e pasurisë kulturore nga vendi nga vjen pasuria.

5. Ndaj vendimit të zyrës kompetente për çështjet e eksportit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës së importit mund të ushtrohet ankim, sipas nenit 126 të këtij ligji.

6. Kushtet, mënyra, procedura dhe forma për lëshimin ose rinovimin e licencës së importit caktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 130

Baza e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura dhe përditësimi i saj

1. IKRTK-ja, në bashkëpunim me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, krijon bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë. Baza e të dhënave administrohet sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Rregullimi i procedurave të rikthimit për objektet e deklaruara të humbura, apo të dala ilegalisht, si të trafikuar nga shteti shqiptar, bëhet sipas pikës 5, të nenit 121, të këtij ligji, dhe sipas dispozitave të Konventës së UNESCO-s 1970, “Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e Pronësisë së Pasurisë Kulturore”, ratifikuar me ligjin nr. 8523, datë 9.9.1999, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore”.

3. Përditësimi i bazës së të dhënave kryhet nga IKRTK-ja, në vijim të kërkesave të paraqitura nga institucionet publike kombëtare ose ndërkombëtare për përfshirjen e pasurive kulturore në këtë bazë të dhënash.

4. Heqja e një pasurie kulturore nga baza e të dhënave kryhet me kërkesë të institucioneve publike ose në vijim të dorëzimit vullnetar, nga ana e subjekteve që posedojnë pasuri të përfshira në bazën e të dhënave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Brenda një periudhe 3-vjeçare, nga publikimi i bazës së të dhënave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dorëzimi kryhet pa deklaruar të dhënat personale të subjektit dorëzues pranë institucioneve të specializuara sipas këtij ligji. Pas afatit 3-vjeçar nga publikimi i bazës së të dhënave, subjekti dorëzues deklaron të dhënat personale.

5. Pasuritë kulturore, të dorëzuara sipas pikës 4, të këtij neni, administrohen sipas parashikimeve të këtij ligji dhe dispozitave të tjera të zbatueshme të legjislacionit në fuqi.

6. Procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimi i këtyre pasurive kulturore parashikohet në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 131

Procedura e ndjekur kundrejt shtetit ku pretendohet se është trafikuar pasuria kulturore

1. Republika e Shqipërisë, nëpërmjet organeve kompetente, i drejtohet me kërkesë shtetit tjetër, ku pretendohet se një pasuri e caktuar kulturore ka dalë në mënyrë të paligjshme nga territori i vendit, duke identifikuar poseduesin dhe/ose mbajtësin e saj. Në këtë kërkesë duhet të përfshihen, ndër të tjera, të gjitha informacionet e nevojshme, për të lehtësuar kërkimin, me elemente referuese të veçanta për vendndodhjen reale apo të supozuar të pasurisë kulturore.

2. Republika e Shqipërisë njofton shtetin tjetër, në rastet kur një objekt, pasuri kulturore, është gjetur në territorin e saj dhe ka dyshime të arsyeshme për të besuar se është trafikuar dhe futur në mënyrë të paligjshme nga territori i këtij shteti.

TITULLI IV

TRASHËGIMIA KULTURORE ARKEOLOGJIKE

Kreu I

Pasuritë arkeologjike tokësore

Seksioni I

Pasuritë kulturore arkeologjike

Neni 132

Pasuria kulturore arkeologjike

1. Objekte arkeologjike janë të gjitha objektet e luajtshme e të paluajtshme të veprimtarisë njerëzore të epokave të kaluara, mbi 100 vjet, të vendosura mbi dhe nën shtresat e tokës dhe nën ujëra, për të cilat burim informacioni janë hulumtimet dhe kërkimet arkeologjike.

2. Objektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, janë pasuri publike, pronë e shtetit shqiptar.

3. Objektet e gjetura nga kërkimet arkeologjike i nënshtrohen procesit të kategorizimit dhe regjistrimit, në përputhje me këtë ligj.

Neni 133

Veprimtaria arkeologjike

1. Të dhënat arkeologjike evidentohen dhe përcaktohen si pasuri arkeologjike nëpërmjet

hulumtimeve në terren.

2. Në aspektin metodologjik, hulumtimet në terren të pasurive arkeologjike përfshijnë vlerësimin e potencialit arkeologjik, identifikimin e objekteve dhe siteve arkeologjike dhe gërmimet arkeologjike.

3. Hulumtimet arkeologjike në tokë dhe nën ujë, nga pikëpamja organizative, përfshijnë:

a) Hulumtimet sistematike, me karakter kërkimor-shkencor, të planifikuara për një detyrë të caktuar shkencore;

b) Hulumtimet parandaluese apo të shpëtimit, si rezultat i punimeve ndërtuese të çdo natyre, planeve për rregullimin e territorit apo gjetjet rastësore.

4. Hulumtimi dhe evidentimi i pasurisë arkeologjike kryhet në shtresat e tokës, në sipërfaqe të saj dhe nën ujë.

5. Evidentimi i pasurisë arkeologjike nëpërmjet hulumtimeve në tokë dhe nën ujë kryhet me teknika shkencore joshkatërruese.

6. Hulumtimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë ekskluzivitet i institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore ose subjekteve të licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat që hartohen nga institucionet e specializuara shtetërore. Procedura për hulumtimet arkeologjike rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të IKTK-së.

7. Institucionet e huaja ose subjektet e licencuara, sipas këtij ligji, mund të kryejnë veprimtari hulumtuese nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet vendase, në bazë të marrëveshjeve dy-a shumëpalëshe. Në çdo rast, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale shprehet në lidhje me këto bashkëpunime.

8. Ndalohet gërmimi me karakter arkeologjik dhe përdorimi i aparaturave metalkërkuese nga subjekte të paautorizuara. Autorizimi i institucioneve të specializuara dhe subjekteve të licencuara për përdorimin e këtyre aparaturave bëhet nga KKTKM-ja.

9. Kryerja e veprimtarisë në kundërshtim me pikën 5, të këtij neni, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, subjektin që kryen këtë veprimtari.

Neni 134

Zhvillimet transformuese në territor

1. Në rastet e zhvillimeve të mëdha, si: rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private, përpara marrjes së lejes përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, investitori duhet të marrë miratimin për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Institucionet e specializuara ose subjektet e licencuara, sipas këtij ligji, kryejnë kontrollin e zonës dhe përgatisin dokumentacionin përkatës. Kur zona përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, etnografike ose gjurmë të arkitekturës antike ose tradicionale, investitori duhet të ndryshojë projektin.

3. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe ndryshimet e mundshme të projektit kryhen nga investitori.

Neni 135

Baza e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë

1. Informacioni i përftuar nëpërmjet hulumtimeve arkeologjike do të përfshihet në “Bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Krijimi dhe funksionimi i këtij sistemi përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 136

Licencat për veprimtarinë arkeologjike

1. Veprimtaria arkeologjike kryhet nga institucionet e specializuara, për shkak të funksionit të tyre të parashikuar në këtë ligj, nga persona fizikë ose juridikë të licencuar për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Licencohen, për kryerjen e veprimtarive arkeologjike, personat fizikë ose juridikë që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për të siguruar:

- a) Vëzhgim arkeologjik;
- b) Sondazhe arkeologjike;
- c) Gërmim arkeologjik.

3. Kategoritë e licencave të përmendura në pikën 2, të këtij neni, përfshihen në kategorinë VI.1, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

4. Kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjekte të palicencuara përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji, subjektet përkatëse.

Neni 137

Kriteret e licencimit

1. Licencat e përmendura në pikën 2, të neni 136, të këtij ligji, u lëshohen subjekteve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

2. Formimi vazhdues i personave që janë të pajisur me licencat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, kryhet nga IKTK-ja ose nga subjektet publike ose private, në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi. Kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Brenda 3 viteve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, subjektet e licencuara përpara miratimit të tij kanë detyrimin të marrin kreditet, sipas një programi formimi intensiv e vazhdues, të miratuar me urdhër të titullarit të IKTK-së. Mospërbushja e këtij detyrimi sjell revokimin e licencës.

Neni 138

Revokimi i licencës

1. Licenca e veprimtarive arkeologjike mund të revokohet me vendim të KKTKM-së në rastet e mëposhtme:

- a) Ka deklarime të rreme në dokumentet që shoqërojnë kërkesën;
- b) Dokumentet e paraqitura janë të falsifikuara;
- c) Shoqëria kryen veprimtari arkeologjike në kundërshtim me ato të parashikuara nga drejtuesit teknikë të projektit;
- ç) Në rastin e moszbatimit të kërkesave ose kryerjes së veprimtarisë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore për kërkimet arkeologjike, të konstatuara nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore;
- d) Drejtuesi teknik është i dypunësuar si i tillë;
- dh) Subjekti nuk ka ndjekur formimin vazhdues të detyruar periodik, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ndaj vendimit për revokimin e licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Neni 139

Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike

1. Institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara mund të kryejnë hulumtime arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike vetëm pas marrjes së lejes nga KKTKM-ja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Kategoritë e lejeve për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike përfshihen në kategorinë VI.2, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

3. Kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjektet e licencuara ose çdo subjekt tjetër në kundërshtim me këtë nen është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi këto subjekte, sipas këtij ligji.

Neni 140

Kriteret e lejes

Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike u jepet subjekteve që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të jenë persona fizikë ose juridikë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Të jenë të licencuar ose të kenë të punësuar në stafin e tyre apo të sigurojnë bashkëpunimin me subjekte të licencuara për veprimtarinë arkeologjike;
- c) Të kenë në pronësi ose me qira pajisjet dhe aparaturat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike, për të cilën bëhet kërkesa për leje.

Rregulla të hollësishme mbi lejet për hulumtime arkeologjike përcaktohen me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 141

Revokimi i lejes

1. Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike mund të revokohet me vendim të KKTKM-së në rastet e mëposhtme:

- a) Ka deklarime të rreme në dokumentet që shoqërojnë kërkesën;
- b) Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për leje janë të falsifikuara;
- c) Përdorimi i aparaturave dhe kryerja e veprimeve arkeologjike në kundërshtim me kushtet e lejes dhe nga persona që nuk kanë kualifikimet e nevojshme profesionale;
- ç) Çregjistrimin, falimentimin ose prishjen e subjektit sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Kryerjes së veprimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore për hulumtimet arkeologjike, të konstatuara nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore.

2. Ndaj vendimit për revokimin e lejes mund të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Neni 142

Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike

1. Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike (NJAKPA) janë institucione tekniko-administrative në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të tyre gjeografik, kufijtë e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. NJAKPA-të, brenda territorit të tyre gjeografik, administrojnë, koordinojnë dhe hartojnë plane zhvillimi, projekte, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve arkeologjike, të përcaktuara nga plani i menaxhimit.

3. Planet e zhvillimit, projektet restauruese dhe konservuese, projektet kërkimore-shkencore, të NJAKPA-ve, koordinohen nga IKTK-ja dhe shqyrtohen e miratohen nga KKTKM-ja, në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve.

4. NJAKPA-të, në përputhje me planin e zhvillimit dhe të zgjerimit të veprimtarisë turistike, mund të propozojnë projekte për zbulimin e vlerave arkeologjike në territorin e tyre, të cilat do të shqyrtohen e miratohen nga KKTKM-ja.

5. NJAKPA-të kryejnë punime mirëmbajtjeje dhe mund të kryejnë punime me karakter restaurues e konservues, në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse për pasuritë kulturore që kanë në administrim.

6. NJAKPA-të, në varësi të veçorive natyrore, ambientale, të florës dhe faunës, të trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe asaj arkeologjike në veçanti, në tokë dhe në ujëra, bashkëpunojnë dhe koordinojnë me institucionet e fushave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në territorin që administrojnë.

7. NJAKPA-të mbikëqyrin dhe koordinojnë efektet mjedisore të çdo ndërhyrjeje apo zhvillimi të propozuar brenda territorit të tyre gjeografik, mbështetur në legjislacionin në fuqi mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis, këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. NJAKPA-të mbajnë lidhje të vazhdueshme dhe informojnë strukturat e pushtetit qendror e vendor për zhvillime të karaktereve të ndryshme, që kryhen jashtë territorit të tyre, por që mund të kenë impakt në to.

9. Struktura dhe organika e NJAKPA-ve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 143

Financimi i veprimtarisë së kërkimeve arkeologjike

1. Huluntimet arkeologjike sistematike, me karakter kërkimor-shkencor, miratohen nga KKTKM-ja dhe financimet për to sigurohen nga buxheti i shtetit, donacionet ose marrëveshjet e bashkëpunimit, brenda dhe jashtë vendit.

2. Huluntimet arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit miratohen nga KKTKM -ja dhe financimet për to sigurohen drejtpërdrejt nga investitori.

Seksioni II

Gjetjet rastësore në tokë

Neni 144

Tipologjitë e gjetjeve rastësore

1. Janë gjetje rastësore, si pasojë e punimeve apo të një fakti çfarëdo, dalja në dritë e monumenteve, rrënojave, strukturave, mozaikëve, thesareve, elementeve të kanalizimeve antike, mesjetare, gjurmëve të banimit apo varrezave antike, mbishkrimeve, apo, në mënyrë më të përgjithshme, të gjitha objektet që përbëjnë interes për parahistorinë, historinë, artin, arkeologjinë dhe etnografinë.

2. Gjetjet rastësore janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Neni 145

Gjetje rastësore gjatë zbatimit të projekteve

1. Ecuria e zbatimit të projektit zhvillimor, e miratuar nga KKTKM-ja, mbikëqyret nga

institucionet e specializuara dhe monitorohet nga subjektet e licencuara ose nga specialistët e fushës, sipas listës së krijuar e të përditësuar nga IKTK-ja.

2. Nëse, gjatë punimeve, ndeshen gjetje rastësore, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji, punimet ndërpriten menjëherë.

3. Drejtuesi teknik ose investitori deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore për gjetjen rastësore.

4. DRTK-ja, menjëherë, bën verifikimet e nevojshme në terren dhe ia përcjell ato zyrtarisht IKTK-së.

5. IKTK-ja, nëpërmjet strukturave të veta dhe në bashkëpunim me DRTK-në dhe me persona juridikë e fizikë, të licencuar në këtë fushë, ose persona të listuar në listën e monitoruesve të arkeologjisë, bën ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave.

6. Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga IKTK-ja ose subjekti i licencuar apo monitoruesi, urdhëron pezullimin e punimeve që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga KKTKM-ja. Punonjësi i autorizuar, brenda 5 ditëve nga pezullimi i punimeve, dërgon pranë KKTKM-së relacion mbi gjetjen dhe rëndësinë arkeologjike të tyre. KKTKM -ja shprehet me vendim brenda 10 ditëve.

7. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet, KKTKM-ja mund të vendosë:

a) Vazhdimin e punimeve, kur vlerëson se nuk ka gjetje sipas pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji;

b) Ndryshimin ose ndërprerjen përfundimisht të punimeve, kur vlerëson se ka gjetje sipas pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji.

8. Në rastin e vendimit në lidhje me zbatimin e projekteve zhvillimore, KKTKM -ja duhet të shprehet edhe për veprimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e gjetjeve.

9. Personi dhe drejtuesi teknik, që kanë konstatuar gjetjen rastësore, janë përgjegjës për ruajtjen e tyre deri në marrjen e një vendimi nga KKTKM-ja.

10. Personat që nuk bëjnë deklaratimet ose nuk ruajnë gjetjet në përputhje me këtë nen mbajnë përgjegjësi, sipas këtij ligji.

Neni 146

Gjetjet rastësore në territor

1. Personat, të cilët gjatë punimeve bujqësore apo ndonjë fakti çfarëdo ndeshin gjetje rastësore, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji, kanë detyrimin të deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore.

2. DRTK-ja, menjëherë, bën verifikimet e nevojshme në terren, njofton organet e Policisë së Shtetit dhe informacionin e terrenit ia përcjell zyrtarisht IKTK-së.

3. IKTK-ja, nëpërmjet strukturave të veta dhe në bashkëpunim me DRTK-në, bën ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike, harton relacionin në lidhje me to dhe e paraqet për shqyrtim e vendimmarrje në mbledhjen më të afërt të KKTKM-së. KKTKM-ja shprehet me vendim brenda 20 ditëve.

4. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe veprimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e gjetjeve.

5. Personi, i cili ka ndeshur gjetjet rastësore, si dhe pronari i vendit ku ato janë zbuluar janë përgjegjës për ruajtjen e tyre deri në marrjen e një vendimi nga KKTKM-ja. Ata mund t'i lëvizin nga vendi i gjetjes, në rastet kur nuk mund t'u sigurohet ruajtja dhe mbrojtja në vend, deri në mbërritjen e autoriteteve kompetente dhe, nëse vlerësohet e nevojshme, të kërkojnë edhe ndihmën e organeve të Policisë së Shtetit. Shpenzimet për ruajtjen dhe lëvizjen e objektit mbulohen nga ministria.

6. Mosraportimi në organet kompetente, në kundërshtim me këtë nen, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës.

Neni 147

Deklarimi për gjetjen rastësore

1. Deklarimi për gjetjen rastësore duhet të bëhet me shkrim, nga personi fizik, juridik apo cildo tjetër, dhe duhet të përmbajë elementet informues të mëposhtëm:

- a) Datën dhe vendin e zbulimit;
- b) Natyrën dhe rrethanat e zbulimit;
- c) Emrin dhe të dhënat e pronarit të truallit;
- ç) Emrin dhe të dhënat e personit që ka ndeshur gjetjen rastësore;
- d) Vendin e ruajtjes së përkohshme për gjetjen rastësore.

2. Në rastin e punimeve të miratuara nga KKTKM-ja, deklarimi duhet të shoqërohet edhe me relacionin shpjegues nga specialisti monitorues.

3. Në rastin e gjetjeve rastësore, deklarata duhet të jetë e firmosur nga pronari i truallit dhe personi që ka konstatuar gjetjen.

Neni 148

Pronësia dhe kualifikimi i pasurive të gjetura

Shteti është pronar i pasurive të përcaktuara në nenin 144, të këtij ligji, pavarësisht nëse janë nën tokë apo nën ujëra, nga mënyra e gjetjes së tyre apo personit që i ka gjetur.

Neni 149

Shpërblimi për gjetjen

1. Ka të drejtë të marrë një shpërblim, jo më të madh se 1/4 e vlerës së pasurive të gjetura:

- a) Pronari i pasurisë së paluajtshme ku është gjetur objekti;
- b) Personi, i cili ka bërë një zbulim rastësor dhe ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenet 145 e 146 të këtij ligji.

2. Personi, i cili futet dhe kryen kërkime në pronën e të tretëve pa miratimin paraprak të pronarit dhe/ose poseduesit dhe/ose gëzuesit, nuk përfiton asnjë shpërblim në rast zbulimi.

Neni 150

Masa e shpërblimit

1. Masa e shpërblimit për gjetjet rastësore përcaktohet nga komisioni i vlerësimit. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe funksionon në përputhje me aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

2. Masa e shpërblimit përcaktohet në bazë të vlerës së gjetjes, por, në asnjë rast, nuk mund të jetë më e madhe se 1/4 e vlerës, e vlerësuar paraprakisht për çdo objekt të gjetur. Mënyra e vlerësimit të gjetjeve përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Pranimi i shumës së përcaktuar nuk sjell heqjen dorë nga pretendimet lidhur me vlerën përfundimtare të objekteve të gjetura.

4. Personi i interesuar mund të ankimojë vendimin e komisionit të vlerësimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Vendimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të ankimohet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shpërblimi i parashikuar në këtë nen përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit.

Kreu II

Pasuritë arkeologjike nënujore

Neni 151

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore

Pasuritë arkeologjike dhe historike të gjetura në zonën detare, që shtrihet 12 milje detare, duke filluar nga kufiri i jashtëm i ujërave territoriale, mbrohen sipas dispozitave që rregullojnë ndërhyrjen në pasurinë kulturore nënujore, bazuar në konventën e UNESCO-s “Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore”.

Neni 152

Pasuritë kulturore detare

1. Përbëjnë pasuri kulturore detare shtresat, anijet e mbytura, rrënojat ose, në përgjithësi, çdo objekt që, duke paraqitur një interes, etnografik, arkeologjik apo historik, gjendet nën ujë, në fund të detit ose në të gjitha shtresat nënujore.

2. Objektet arkeologjike dhe historike të gjetura në brendësi të kufijve detarë, në ujërat territoriale e të brendshme të Republikës së Shqipërisë, mbrohen sipas këtij ligji dhe konventave të ratifikuara.

3. Dispozitat e këtij ligji për ruajtjen, mbrojtjen, qarkullimin civil e fizik të pasurive kulturore zbatohen edhe në lidhje me pasuritë arkeologjike nënujore, për aq sa përputhen me natyrën e tyre.

Neni 153

Zonat arkeologjike nënujore

Zonat arkeologjike nënujore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zonat arkeologjike nënujore, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në “Zona A” dhe “Zona B”.

Neni 154

Pronësia e pasurive kulturore detare

1. Pasuritë kulturore detare që ndodhen në det konsiderohen pronë shtetërore, nëse pronari i tyre nuk gjendet brenda afatit prej 1 viti, nga data në të cilën zbulimi i tyre është bërë publik.

2. Procedura e shpalljes publike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 155

Veprimtaritë arkeologjike nënujore

1. Veprimtaria arkeologjike nënujore, në zonat arkeologjike nënujore ose jashtë tyre, kryhet nga institucione shtetërore të specializuara ose nga subjekte të licencuara, që kanë marrë lejen e përmendur në nenin 158 të këtij ligji.

2. Kryerja e veprimtarive arkeologjike nënujore nga persona ose subjekte të palicencuar apo pa lejen përkatëse përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji.

Neni 156

Zhvillimi i projekteve arkeologjike nënujore

Kushtet dhe kriteret për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore, si dhe të aktiviteteve të tjera që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike dhe historike nënujore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Licenca për veprimtarinë arkeologjike nënujore

1. Veprimtaritë arkeologjike nënujore mund të kryhen vetëm nga institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara sipas këtij ligji.
2. Licencimi i personave fizikë ose juridikë bëhet nga KKTKM-ja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Licencohen për kryerjen e veprimtarive arkeologjike nënujore personat fizikë ose juridikë që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme.
4. Kategoritë e licencave për veprimtaritë arkeologjike nënujore përfshihen në kategorinë VI.1, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.
5. Kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës rregullohen me anë të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.
6. Licencat për kryerjen e veprimtarive arkeologjike nënujore dhe për monitorimin e tyre u jepen subjekteve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.
7. Licencat e veprimtarive arkeologjike nënujore mund të revokohen me vendim të KKTKM-së, në rastet e mëposhtme:
 - a) Ka deklarime të rreme në dokumentet që shoqërojnë kërkesën;
 - b) Dokumentet e paraqitura janë të falsifikuara;
 - c) Subjekti kryen veprimtari arkeologjike në kundërshtim me ato të parashikuara nga drejtuesit teknikë të projektit;
 - ç) Në rastin e moszbatimit të kërkesave të licencës ose kryerjes së veprimtarisë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore për kërkimet arkeologjike, të konstatuara nga IKMTK-ja;
 - d) Subjekti nuk ka ndjekur formimin vazhdues të detyruar periodik, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
8. Kundër vendimit për revokimin e licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Leja e veprimtarisë arkeologjike nënujore

1. Veprimtaritë në zonat arkeologjike nënujore dhe në zona të tjera ushtrohen nga subjektet e licencuara dhe institucionet e specializuara, sipas lejeve të lëshuara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
2. Kategoritë e lejeve për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike përfshihen në kategorinë VI.2, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.
3. Kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes rregullohen me anë të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.
4. Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore u jepet subjekteve që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë person juridik publik ose privat;
 - b) Të ketë punësuar në stafin e tij arkeologë, në një numër të përcaktuar nga institucionet e specializuara;
 - c) Të ketë në pronësi ose me qira pajisjet dhe aparaturat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike, për të cilën bëhet kërkesa për leje.
5. Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore mund të revokohet me vendim të KKTKM-së, në rastet e mëposhtme:
 - a) Ka deklarime të rreme në dokumentet që shoqërojnë kërkesën;

- b) Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për leje janë të falsifikuara;
- c) Përdorimi i aparaturave dhe kryerja e veprimeve arkeologjike në kundërshtim me kushtet e lejes dhe nga persona që nuk kanë kualifikimet e nevojshme profesionale;
- ç) Çregjistrimin, falimentimin ose prishjen e subjektit, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Kryerja e veprimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore për hulumtimet arkeologjike, të konstatuara nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.

6. Ndaj vendimit për revokimin e lejes mund të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Neni 159

Gjetjet rastësore detare

1. Çdo person që zbulon një pasuri kulturore detare duhet të deklarojë gjetjen e saj pranë autoritetit portual më të afërt brenda 48 orëve nga zbulimi apo mbërritja në portin e parë.

2. Autoriteti portual, sipas pikës 1, të këtij neni, njofton menjëherë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe IKTK-së.

3. Personi që zbulon një pasuri kulturore është i detyruar të mos e lëvizë atë nga vendi i zbulimit, ta ruajë dhe të mos e dëmtojë. Lëvizja e gjetjeve nënujore mund të bëhet vetëm në rastet kur nuk mund t'u sigurohet ruajtja dhe mbrojtja në vend, deri në mbërritjen e autoriteteve kompetente.

4. Mosraportimi në organet kompetente, sipas këtij neni, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës. Personi përgjegjës për ruajtjen e përkohshme të gjetjes mban përgjegjësi, sipas këtij ligji, nëse nuk përmbush detyrimin për ruajtjen e gjetjeve.

Neni 160

Gjetjet rastësore detare gjatë zbatimit të punimeve

1. Personat, të cilët në vijim të punimeve ose të çdo veprimtarie tjetër publike apo private zbulojnë gjetje nënujore, duhet të deklarojnë gjetjen brenda afatit të parashikuar në nenin 159 të këtij ligji.

2. Personi që zbulon një pasuri kulturore është i detyruar ta ruajë, të mos e lëvizë nga vendi i zbulimit dhe të mos e dëmtojë. Lëvizja e gjetjeve nënujore mund të bëhet vetëm në rastet kur nuk mund t'u sigurohet ruajtja dhe mbrojtja në vend, deri në mbërritjen e autoriteteve kompetente.

3. Mosraportimi në organet kompetente, sipas këtij neni, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës. Personi përgjegjës për ruajtjen e përkohshme të gjetjes mban përgjegjësi, sipas këtij ligji, nëse nuk përmbush detyrimin për ruajtjen e gjetjeve.

Neni 161

Prioriteti i gjetjes

Në rastin e disa deklarimeve nga persona të ndryshëm, për të njëjtën pasuri, përfitimi i zbulimit i njihet deklaruesit të parë ose atij që e dorëzon, me kusht që lëvizja e saj të jetë bërë vetëm për të siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen e saj.

Neni 162

Shpërblimi

1. Çdo person që ka zbuluar dhe deklaruar, sipas neneve 159 e 160, të këtij ligji, një gjetje rastësore detare në ujërat e brendshëm territoriale, ka të drejtë të përfitojë një shpërblim.

2. Kushtet, kriteret dhe masa për përcaktimin e shpërblimit përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, sipas neneve 149 e 150 të këtij ligji.

3. Shpërblimi i parashikuar në këtë nen përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit.

TTULLI V
VLERËSIMI, PËRDORIMI DHE ADMINISTRIMI I PASURIVE KULTURORE

Kreu I
Vlerësimi dhe administrimi
i pasurive kulturore

Seksioni I
Vlerësimi i pasurive kulturore

Neni 163
Veprimtaritë për vlerësimin
e pasurive kulturore

1. Veprimtaritë për vlerësimin e pasurive kulturore përfshijnë ngritjen dhe organizimin e qëndrueshëm të burimeve, strukturave apo rrjeteve, si dhe vënien në dispozicion të kompetencave/ aftësive teknike ose burimeve financiare apo instrumentale, me qëllim ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Në këto veprimtari mund të bashkëpunojnë e marrin pjesë edhe subjektet private.

2. Veprimtaritë e vlerësimit të pasurive kulturore kryhen me nismë publike ose private.

3. Veprimtaritë e vlerësimit të pasurive kulturore, që kryhen me nismë publike, mbështeten në parimet e lirisë së pjesëmarrjes, pluralitetit të subjekteve, vazhdueshmërisë së funksioneve, trajtimit të barabartë dhe administrimit efektiv të fondeve monetare.

4. Veprimtaritë e vlerësimit me nismë private janë aktivitete me dobishmëri shoqërore dhe nxisin solidaritetin shoqëror.

Neni 164

Veprimtaritë e vlerësimit të pasurive kulturore në pronësi publike

1. Institucionet publike dhe fondacionet e krijuara sipas nenit 172, të këtij ligji, kryejnë veprimtarinë e vlerësimit të pasurive kulturore që janë në administrim të tyre, në përputhje të plotë me parimet e përcaktuara në këtë ligj.

2. Veprimtaritë e vlerësimit të pasurive kulturore publike jashtë institucioneve dhe vendeve të kulturës bazohen në dispozitat e këtij ligji dhe në funksionet e këtyre pasurive.

Neni 165

Veprimtaritë e vlerësimit të
pasurive kulturore në pronësi private

1. Veprimtaritë dhe strukturat për vlerësimin e pasurive kulturore në pronësi private, të cilat kryhen me nismë të personave fizikë e juridikë privatë, mund të mbështeten nga institucionet publike dhe subjekte të tjera juridike publike.

2. Me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore përcaktohen format e mbështetjes nga ana e institucioneve publike dhe subjekteve të tjera juridike publike, të cilat zbatohen në përputhje me rëndësinë e vlerës kulturore të secilës pasuri kulturore.

3. Këto përcaktime merren parasysh në marrëveshjen që lidhet me pronarin ose poseduesin e pasurisë kulturore.

Neni 166

Nivelet e cilësisë së veprimtarisë së vlerësimit të pasurive kulturore

Nivelet minimale, të unifikuara, të cilësisë së veprimtarive të vlerësimit për pasuritë kulturore në pronësi publike përcaktohen nga KKMPK-ja, në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet dhe subjektet e tjera juridike publike dhe institucionet e specializuara të fushës. Nivelet e unifikuara, sipas kësaj pike, rishikohen periodikisht.

Neni 167

Shërbime për publikun

1. Në institucionet dhe vendet e kulturës ofrohen shërbime asistence kulturore dhe pritëse për publikun.

2. Përfshihen në shërbimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni:

a) Shërbimi i botimeve dhe shitjes së katalogëve, fletëpalosjeve, botimeve të tjera të ngjashme, incizimeve audiovizive dhe informatike, çdo material tjetër informativ, si dhe riprodhimi i pasurive kulturore;

b) Menaxhimi i përmbledhjeve diskografike, të diapotekave dhe bibliotekave muzeore;

c) Menaxhimi i pikave të shitjes dhe përdorimi komercial i riprodhimit të pasurive;

ç) Shërbime të pritjes, përfshirë ato të asistencës, argëtimit për fëmijët, shërbimet e informacionit, të guidave dhe asistencës didaktike, qendrat e takimit;

d) Shërbime të kafeterisë, të ushqimit, të garderobës;

dh) Organizimi i panairëve dhe manifestimeve kulturore si edhe i nismave promovuese.

3. Shërbimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, mund të administrohen në formë të integruar me shërbimin sanitar, të ruajtjes së sigurisë së objektit dhe të biletarisë.

4. Për format e administrimit indirekt, të përcaktuara nga nenet 171 e 172, të këtij ligji, administrimi i këtyre shërbimeve kryhet në përputhje me marrëveshjen ose kontratën e lidhur me këto subjekte.

5. Tarifat e kryerjes së këtyre shërbimeve mbledhen dhe përdoren sipas përcaktimeve të nenit 188 të këtij ligji.

Neni 168

Promovimi i aktiviteteve studimore dhe kërkimore

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet shtetërore, edhe me pjesëmarrjen e universiteteve e të subjekteve të tjera publike dhe private, realizojnë, promovojnë e mbështesin, edhe bashkërisht, kërkime, studime dhe aktivitete të tjera njohëse, që kanë për objekt trashëgiminë kulturore.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e tjera publike bashkëpunojnë për të ngritur qendra të përhershme të studimit dhe dokumentimit të trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim dhe me universitetet dhe subjektet e tjera private e publike, të cilat synojnë garantimin e mbledhjes dhe të shpërndarjes sistematike të rezultatit të studimeve, kërkimeve dhe aktiviteteve të tjera të pikës 1, të këtij neni, përfshirë katalogimin.

Neni 169

Njohja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë mund të hyjë në marrëveshje me institucionet publike përgjegjëse për arsimin dhe shkencën dhe institucionet e tjera publike të interesuara, me qëllim shpërndarjen e njohurive mbi trashëgiminë kulturore dhe shfrytëzimin më të mirë të tyre.

2. Bazuar në marrëveshjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, titullarët e institucioneve dhe të

vendeve të kulturës mund të hyjnë në marrëveshje të veçanta me universitetet, shkollat e çdo lloji niveli dhe kategorie, pjesë e sistemit arsimor, si dhe me çdo institut tjetër të formimit, për përpunimin dhe aktualizimin e projekteve formuese dhe përditësuese. Këto marrëveshje lidhen në kuadër të formimit didaktik dhe për vënien në dispozicion të materialeve të ndryshme, suporte audiovizive, të destinuara për mësuesit dhe operatorët didaktikë. Kurset, materialet dhe suportet përgatiten në përputhje me specifikat e institucionit dhe me nevojat e ndryshme e të veçanta që mund të dalin nga prania e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 170

Sponsorizimi i veprimtarive në lidhje me pasuritë kulturore

1. Sponsorizimi i veprimtarive të vlerësimit dhe veprimtarive të tjera në lidhje me pasuritë kulturore është çdo kontribut, edhe në mallra apo shërbime, i lëvruar për projektimin dhe aktualizimin e iniciativave për mbrojtjen, ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Sponsorizimi kryhet me qëllim promovimin e emrit, të markës, imazhit, produktit apo aktivitetit të subjektit lëvruar, në përputhje me karakterin artistik, historik dhe dekorin e pasurisë kulturore që duhet të ruhet ose mbrohet, sipas përcaktimeve të kontratës së sponsorizimit.

2. Mund të sponsorizohen nismat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore, subjekteve të tjera publike, si dhe të subjekteve të tjera publike e private jofitimprurëse ose nisma të subjekteve private për pasuritë kulturore në pronësi të tyre. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose personat e autorizuar prej saj verifikojnë përshtatshmërinë e nismave të sponsorizuara me nevojat e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Në kontratën e sponsorizimit, të lidhur ndërmjet subjektit sponsorizues dhe subjektit përfitues, pavarësisht iniciuesit të iniciativës, ministria përgjegjëse konfirmon përshtatshmërinë e nismës me parashikimet e këtij ligji. Në kontratën e sponsorizimit për veprimtaritë në lidhje me pasuritë kulturore zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi sponsorizimin.

Seksioni II

Administrimi i pasurive kulturore

Neni 171

Mënyrat e administrimit

1. Pasuritë kulturore në pronësi publike administrohen në formë direkte ose indirekte.
2. Administrimi direkt realizohet nëpërmjet strukturave organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar tekniko-shkencor. Institucionet publike mund të realizojnë administrimin direkt edhe në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike.
3. Administrimi indirekt kryhet nëpërmjet:
 - a) Fondacioneve të posaçme, të krijuara sipas nenit 172 të këtij ligji;
 - b) Fondacioneve të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, sipas këtij ligji;
 - c) Personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilëve pasuria kulturore u jepet në administrim nëpërmjet procedurave publike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe vendim të KKMPK-së, bazuar në vlerësimin krahasimor të projekteve të paraqitura.
4. Administrimi indirekt synon realizimin e një administrimi më efektiv të pasurive kulturore. Zgjedhja ndërmjet dy formave të administrimit, të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, bazohet në një vlerësim krahasues në terma ekonomiko-financiarë dhe efektiviteti, bazuar në objektiva të paracaktuara.
5. Marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe personave fizikë apo juridikë, publikë ose

privatë, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij neni, përcaktohen nëpërmjet kontratës së lidhur me këto subjekte. Në kontratë përcaktohet përmbajtja e projektit të administrimit, shërbimet thelbësore që duhen garantuar për shfrytëzimin publik të objektit, afatet e realizimit, nivelet cilësore të aktiviteteve dhe shërbimeve që do të ofrohen, si dhe kërkesat për nivelin profesional të punonjësve.

6. Subjekti, i cili ka lidhur një kontratë sipas pikës 5, të këtij neni, mund të përfitojë edhe të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të nevojshme për ushtrimin e këtyre aktiviteteve, nëpërmjet lidhjes së një kontrate të posaçme, e cila i bashkëlidhet kontratës fillestare. Anulimi i kontratës së parashikuar në pikën 5, të këtij neni, sjell, automatikisht, anulimin e kontratës për hapësirat, pa të drejtë dëmshpërblimi.

Neni 172

Fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore

1. Administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore mund të kryhet edhe nga persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, dhe personave fizikë ose juridikë privatë, vendas apo të huaj, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin civil në fuqi. Administrimi, sipas këtij neni, ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin, vlerësimin e pasurive kulturore dhe dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë, në mënyrë joshteruese, qoftë veç e veç.

2. Personi juridik krijohet në formën e fondacionit. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tij është administrimi i pasurive kulturore, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Organizimi dhe funksionimi i fondacioneve të krijuara sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, u nënshtrohet rregullave të legjislacionit civil në fuqi për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe parashikimeve të këtij ligji, për aq sa janë të zbatueshme, duke ruajtur pavarësinë e funksionimit dhe të respektimit të tyre nga ana e shtetit.

4. Rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të fondacioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore vendosen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në marrëveshjen e posaçme që lidhet ndërmjet palëve.

5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji. Marrëveshja përcakton, ndër të tjera, afatin, tarifatat dhe kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore. Në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, vlerësimit e administrimit të pasurisë, subjektet zbatojnë parimet dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.

6. Personat juridikë, të krijuar për këtë qëllim, e realizojnë veprimtarinë e tyre me fonde të themeluesve të tyre dhe çdo burimi tjetër financimi, në bazë të legjislacionit në fuqi.

7. Veprimtaria ekonomike e personave juridikë, fondacioneve që themelohen dhe operojnë për këtë qëllim, sipas këtij neni, nuk i nënshtrohet ligjit për tatimin mbi fitimin në Republikën e Shqipërisë dhe përjashtohet nga pagesa e TVSH-së. Gjithashtu, furnizimet e kryera në funksion të objektit të veprimtarisë së këtyre subjekteve përjashtohen nga detyrimet e importit dhe detyrimet e tjera doganore.

8. Të ardhurat e krijuara nga veprimtaria ekonomike e fondacioneve të veçanta adminis-trohen prej tyre, sipas parashikimeve të marrëveshjes së përmendur në pikën 5 të këtij neni.

9. Pasuria, që përbën vlerë të trashëgimisë kulturore, i kalon në administrim, në kuptim të këtij ligji, fondacionit të krijuar për këtë qëllim, sipas marrëveshjes ndërmjet këtij të fundit me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Në çdo rast, titulli i pronësisë i mbetet shtetit.

Neni 173

Mbrojtja e pasurive kulturore të dhëna në administrim

1. Pasuritë kulturore që janë dhënë në administrim, sipas përcaktimeve të neneve 171 e 172, të këtij ligji, i nënshtrohen, në çdo rast, regjimit të tyre juridik, të vendosur në bazë të këtij ligji.

2. Funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, kontrollit teknik, inspektimit dhe mbikëqyrjes ushtrohen në përputhje me këtë ligj.

Kreu II

Shfrytëzimi i pasurive kulturore

Neni 174

Institucione dhe vende të kulturës

1. Institucionet dhe vendet e kulturës, sipas kuptimit të këtij ligji, që i përkasin subjekteve publike, shfrytëzohen për interes publik dhe janë në shërbim të publikut.

2. Institucionet dhe vendet e kulturës në pronësi private, që janë të hapura për publikun, ofrojnë një shërbim privat me dobishmëri publike.

Neni 175

Shfrytëzimi i institucioneve dhe vendeve të kulturës në pronësi publike

1. Institucionet shtetërore ose subjektet e tjera publike sigurojnë shfrytëzimin e pasurive që gjenden në institucione dhe në vendet e kulturës, në zbatim të parimeve bazë të përcaktuara në këtë ligj.

2. Institucioni ose subjekti publik kompetent për administrimin e pasurive që gjenden në institucionet dhe vendet e kulturës, qofshin këto organe të qeverisjes qendrore ose vendore, nxjerr aktet që rregullojnë shfrytëzimin e tyre, sipas parimeve bazë. Mungesa e këtyre akteve nuk e shkarkon organin publik nga detyrimi për të garantuar shfrytëzimin e pasurive kulturore që ka në dispozicion.

3. Shfrytëzimi i pasurive kulturore publike jashtë institucioneve dhe vendeve të kulturës mundësohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe destinacionin për përdorim publik të këtyre pasurive.

4. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet që kanë në administrim pasuri kulturore, me qëllim koordinimin, harmonizimin për shfrytëzimin efektiv të institucioneve dhe vendeve të kulturës, lidhin marrëveshje, në fushën e vlerësimit, me subjektet e parashikuara në nenet 171 e 172, të këtij ligji. Mungesa e këtyre marrëveshjeve nuk e shkarkon organin publik nga detyrimi për të garantuar shfrytëzimin e pasurive kulturore që ka në dispozicion.

5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bazë të legjislacionit në fuqi për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore, mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave transferimin e pronave njësite të vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të garantojnë shfrytëzimin dhe vlerësimin e pasurive kulturore që ndodhen në to.

Neni 176

Hapja për publikun e institucioneve dhe vendeve të kulturës

1. Aksesit i publikut në institucionet dhe vendet publike të kulturës mund të jetë falas ose me pagesë. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pushteti vendor ose subjekte të tjera publike vendore mund të hyjnë në marrëveshje për të rregulluar të drejtën e aksesit.

2. Hyrja në biblioteka dhe arkivat e tjera publike, me qëllim leximin, studimin dhe kërkimin, është falas.

3. Në rastet e hyrjes me pagesë, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucionet

publike, që kanë në administrim pasuri kulturore, përcaktojnë:

a) Rastet e hyrjes me ose pa pagesë;

b) Kategoritë e biletave dhe kriteret e përcaktimit të çmimit. Në rastin e marrëveshjeve të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 3, të nenit 171, të këtij ligji, çmimi i biletës përfshihet në të drejtat dhe detyrimet që palët kanë rënë dakord në këto marrëveshje;

c) Mënyrën e emetimit, shpërndarjes, shitjes së biletave të hyrjes.

4. Në rastin e marrëveshjeve me subjekte private dhe publike, sipas nenit 171, të këtij ligji, mënyra e emetimit, shpërndarjes dhe shitjes së biletave mund të përcaktohen në marrëveshjet e lidhura për këtë qëllim. Për menaxhimin e biletave të hyrjes mund të përdoren edhe teknologjitë e reja informatike, me mundësinë e parablerjes dhe blerjes pranë të tretëve.

5. Në rastin kur administrimi i institucioneve dhe vendeve të kulturës kryhet nga fondacionet, të parashikuar në nenin 172, të këtij ligji, përcaktimet e pikës 3, të këtij neni, kryhen nga ky subjekt, në përputhje me marrëveshjen e parashikuar në pikën 5, të nenit 172, të këtij ligji.

6. Të ardhurat e përfituara nga biletat dhe çdo shërbim tjetër konsiderohen të ardhura dytësore të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Këto të ardhura përdoren në interes të edukimit nëpërmjet kulturës dhe zhvillimit të projekteve artistike e kulturore të institucionit dhe zhvillimit të tij. Tarifatat për këto të ardhura miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

7. Në rastin kur institucionet ose vendet e kulturës administrohen nga personat juridikë jofitimprurës, të krijuar sipas këtij ligji, të ardhurat transferohen tërësisht në favor të këtyre subjekteve.

Neni 177

Shfrytëzimi i pasurive kulturore në pronësi private

1. Aksesi i publikut në pasuritë kulturore të paluajshme private, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “d”, të pikës 3, të nenit 50, të këtij ligji, që kanë interes të veçantë, dhe në koleksionet e deklaruara pasuri kulturore, rregullohet me marrëveshje ndërmjet institucionit që i ka në administrim dhe pronarit.

2. Përrjashtohet nga zbatimi i këtij neni rasti i parashikuar në nenin 95 të këtij ligji.

3. Pronari, i cili nuk zbaton marrëveshjen e lidhur sipas pikës 1, të këtij neni, mban përgjegjësi, sipas këtij ligji.

Kreu III

Përdorimi i pasurive kulturore

Seksioni I

Përdorimi

Neni 178

Format e përdorimit të pasurive kulturore

1. Institucionet publike mund t’ia japin në përdorim pasuritë kulturore që kanë në administrim, me përjashtim të objekteve të kultit, një subjekti të interesuar, nëse garantohet përputhshmëria e qëllimit të përdorimit me destinacionin kulturor të pasurisë dhe dhënia në përdorim nuk cenon vlerat e saj si trashëgimi kulturore.

2. Pasuritë kulturore mund të jepen në përdorim, sipas pikës 1, të këtij neni, në format e mëposhtme:

a) Përdorim i drejtpërdrejtë;

b) Përdorim i tërthortë;

c) Përdorim me qëllim rijetëzimi.

3. Përzgjedhja e subjekteve, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me konkurrim publik. Procedurat dhe

kriteret e konkurrimit, si dhe parashikimet në lidhje me formën e kontratës, kohëzgjatjen e marrëdhënies dhe metodologjinë e caktimit të tarifave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Tarifat e të gjitha formave të përdorimit të pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe atij përgjegjës për financat dhe përdoren për fondin e trashëgimisë kulturore.

5. Tarifat e përdorimit të pasurive kulturore në administrim të fondacioneve, sipas nenit 172, të këtij ligji, caktohen nga ky subjekt dhe përdoren në përputhje me marrëveshjen e parashikuar në pikën 5, të nenit 172, të këtij ligji.

Neni 179

Përdorimi i drejtpërdrejtë

1. Institucionet publike mund t'ia japin në përdorim pasuritë kulturore që kanë në administrim, në kushtet e nenit 178, të këtij ligji, një subjekti të interesuar për realizimin e një veprimtarie kulturore, sociale, artistike, që përputhet me funksionin dhe vlerat e pasurisë kulturore.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore përcakton rregullat për dhënien në përdorim të pasurive kulturore, sipas këtij neni, pavarësisht nëse këto pasuri janë apo jo në administrim të saj.

3. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore miraton dhënien në përdorim të pasurive kulturore, si për pasuritë në administrim të saj, ashtu edhe për pasuritë kulturore që janë në administrim të institucioneve të tjera publike.

Neni 180

Përdorimi i tërthortë dhe riprodhimi i pasurive kulturore

1. Institucionet publike lejojnë riprodhimin, si dhe përdorimin e tërthortë të pasurive kulturore që ato vetë kanë në administrim, duke respektuar dispozitat e pikës 2, të këtij neni, dhe parashikimet e legjislacionit për të drejtën e autorit. Rregulla të hollësishme për riprodhimin dhe përdorimin e tërthortë të pasurive kulturore miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ndalohet riprodhimi i pasurive të trashëgimisë kulturore që kryhet nëpërmjet vendosjes së kallëpeve, nëpërmjet kontaktit, nga origjinalet e skulpturave dhe të veprave me relief në përgjithësi, si dhe të çdo lloj materiali që ato kanë në përbërjen e tyre. Ky riprodhim lejohet vetëm për raste përjashtimore e të jashtëzakonshme, të përcaktuara me udhëzim të posaçëm të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Riprodhimi i pasurive të trashëgimisë kulturore në kundërshtim me pikën 2, të këtij neni, përbën shkelje dhe subjektet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas këtij ligji.

Neni 181

Katalogu i imazheve fotografike dhe filmimeve të pasurive kulturore

Kur marrja në përdorim ka për objekt riprodhimin e pasurive kulturore me qëllim prodhimin e një përmbledhjeje dhe katalogu me imazhe fotografike, apo të dokumentimit në përgjithësi, vendimi i dhënies në përdorim përfshin:

- a) detyrimin e depozitimit të kopjes së çdo kuadri ose fotografie;
- b) kthimin pas përdorimit të fotokolorit original me kodin përkatës.

Seksioni II

Partneriteti publik privat në fushën e trashëgimisë kulturore. Rijetëzimi i pasurive kulturore të paluajtshme

Neni 182

Rijetëzimi i pasurive kulturore

1. Pasuritë e paluajtshme kulturore në administrim të institucioneve qendrore ose vendore mund

të jepen në përdorim, për qëllim rijetëzimi, për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.

2. Miratimi dhe zbatimi i projekteve të rijetëzimit të pasurive të paluajtshme kulturore duhet të respektojë regjimet për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerës së pasurisë kulturore, termat dhe kushtet për kryerjen e konservimit të integruar.

3. Pasuritë kulturore në pronësi private jepen në përdorim, me qëllim rijetëzimin pas marrjes së miratimit paraprak nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Objekt rijetëzimi mund të jetë një pasuri kulturore, një grup pasurish kulturore ose pjesë të veçanta të tyre që nuk përbëjnë, në tërësinë e tyre, një njësi territoriale të regjistruar si trashëgimi kulturore. Për pasuritë me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji, njësi territoriale e regjistruar si trashëgimi kulturore janë pasuritë sipas listës botërore të pasurive kulturore të UNESCO-s.

5. Projekti i rijetëzimit përfshin një plan të detajuar të zhvillimit të territorit, objekt rijetëzimi, duke respektuar regjimet për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerës së veçantë kulturore.

6. Territori për rijetëzim përfshin shtrirjen territoriale të objektit të projektit të rijetëzimit, sipas planimetrisë dhe kartelës së pasurisë të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në varësi të vendimit të komisionit të rijetëzimit, i cili funksionon sipas parashikimeve të nenit 184, të këtij ligji, ky territor mund të përfshijë edhe një zonë mbështetëse, e cila është një sipërfaqe e nevojshme për të kryer administrimin, mirëmbajtjen dhe operimin e objektit të rijetëzimit. Nevoja për zonën mbështetëse dhe përcaktimi i saj do të përfshihen në planin e detajuar të zhvillimit, sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 183

Kufizimet e rijetëzimit

Përfshihen nga dhënia në përdorim për qëllim rijetëzim pasuritë e paluajtshme kulturore të mëposhtme:

a) Tërësia e njësisë territoriale, e regjistruar si pasuri kulturore me rëndësi universale, sipas përcaktimit të saj në listën e pasurive botërore të UNESCO-s;

b) Tërësia e njësisë territoriale, e regjistruar si pasuri kulturore “me rëndësi kombëtare”, përveç atyre të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) Rezervat arkeologjike apo pjesët prej tyre, përveç atyre që përcaktohen me vendim të KKTKM-së;

ç) Pasuritë kulturore me rëndësi fetare.

Neni 184

Procedura e rijetëzimit

1. Pasuritë kulturore të paluajtshme jepen në përdorim për qëllim rijetëzimi me vendim të një komisioni *ad hoc*, të përbërë nga 7 anëtarë dhe të krijuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Komisioni i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përbëhet nga:

a) Një përfaqësues i strukturës përgjegjëse për çështjet e rijetëzimit pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) Një përfaqësues nga organi i pushtetit vendor, kur pasuria është pronë e pushtetit vendor;

c) Një përfaqësues të IKTK-së;

ç) Një përfaqësues të DRTK-së ku ndodhet pasuria e paluajtshme;

d) Një ekspert të licencuar, sipas këtij ligji, në varësi të tipologjisë së pasurisë kulturore;

dh) Edhe një përfaqësues të sektorit të arkeologjisë të IKTK-së, kur prona që do rijetëzohet përmban vlera arkeologjike.

3. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore vendos hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim pasi konsultohet me KKTKM-në, KKMPK-në dhe IKTK-në, dhe për vlerat arkeologjike kulturore të paluajtshme të IKTK-së, mbi bazën e kërkesës individuale të subjektit të interesuar.

4. Procedurat e konkurrimit zhvillohen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 3, të nenit 178, të këtij ligji.

5. Subjektet konkurruese, ndër të tjera, duhet të sigurojnë burime vjetore bazë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore mbi bazën e pronës nën rijetëzim dhe, në rastet kur janë të pranishme vlerat arkeologjike ose të dhëna rreth vendeve arkeologjike apo objekteve, edhe burime për studimet arkeologjike, deri në eksplorimin e plotë të zonës së pranuar.

6. Në çdo rast, kërkesa për rijetëzim duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Projektin e rijetëzimit dhe planin e zhvillimit të territorit;
- b) Analizën e detajuar të projektit;
- c) Dokumentacionin për pjesëmarrje në projekte të mëparshme.

7. Në vendimin për dhënien në rijetëzim të pasurisë kulturore komisioni përcakton autoritetin e procedurës për lidhjen dhe zbatimin e kontratës së rijetëzimit. Për pasuritë në pronësi të pushtetit qendror, autoritet i procedurës do të jetë ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Për pasuritë në pronësi të pushtetit vendor, autoritet i procedurës do të jetë bashkia ku ndodhet pasuria që rijetëzohet.

Neni 185

Projekti i rijetëzimit

Projekti i rijetëzimit duhet të përmbajë:

- a) Projektin e ndërhyrjeve për riaftësimin e pasurisë kulturore;
- b) Relacionin teknik shoqërues;
- c) Planin e menaxhimit të pasurisë kulturore dhe të territorit të saj;
- ç) Analizën e nevojave dhe kërkesat për mbështetje institucionale;
- d) Tipologjinë e shërbimeve që mendohet të ofrohen;
- dh) Garancinë për miradministrim të pronës, pasuri kulturore.

Neni 186

Kontrata e rijetëzimit

1. Kontrata e rijetëzimit nuk mund të ndryshojë regjimet për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerës kulturore të paluajtshme që është objekt i saj, siç është përcaktuar në përputhje me këtë ligj.

2. Kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së rijetëzimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rast se subjekti kërkuar do të ndërtojë infrastrukturën përkatëse, ndërtesa dhe instalime ndihmëse në zonat e lira të zbulimeve arkeologjike brenda zonës së mbështetur, kontrata duhet të përcaktojë kushtet teknike për ndërtimin e kësaj infrastrukture.

4. Përpara nënshkrimit të kontratës, subjekti fitues duhet të garantojë zbatimin e saj, nëpërmjet depozitimit, në favor të autoritetit të procedurës, të garancisë bankare të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, në vlerën prej 5 për qind të projektit.

5. Kontrata e rijetëzimit lidhet për një kohëzgjatje deri në 20 vjet, me të drejtë rinovimi vetëm një herë, nëse subjekti ka përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet kontraktuese, në bazë të raportit të Inspektoratit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

6. Funkcionet e ruajtjes, të mbrojtjes, kontrollit teknik, inspektimit dhe mbikëqyrjes së pasurive të dhëna në rijetëzim ushtrohen në përputhje me këtë ligj.

Seksioni III
Tarifat

Neni 187

**Tarifat e përdorimit, të riprodhimit
dhe garancia**

1. Detyrimet e tjera të lidhura me riprodhimin e pasurive kulturore, përveç tarifave, përcaktohen nga KKMPK-ja, bazuar në:

- a) Llojin e aktivitetit, për të cilin është dhënë në përdorim;
- b) Mjetet dhe mënyrat e ekzekutimit të riprodhimit;
- c) Llojin dhe kohën e përdorimit të hapësirave dhe të pasurive;
- ç) Përdorimin dhe destinacionin e riprodhimeve, si dhe përfitimin ekonomik që i sjell kërkuesit.

2. Si rregull, tarifat e përdorimit dhe detyrimet e tjera të lidhura me riprodhimin përcaktohen paraprakisht.

3. Përfshihen në detyrimin për pagesën e tarifës për riprodhimin e pasurive kulturore individët, kur riprodhimi kërkohet për përdorim personal ose qëllime studimi, ose subjektet publike apo private, kur riprodhimi kërkohet për veprimtarinë e vlerësimit, me kusht që të mos ketë qëllim fitimi. Në çdo rast, kërkuesit kanë detyrimin të shlyejnë shpenzimet administrative për riprodhimin.

4. Kur gjatë aktivitetit të përdorimit të pasurisë kulturore mund të ekzistojë mundësia e dëmtimit të saj, dhënia në përdorim sigurohet nëpërmjet një garancie të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose shoqëri sigurimi. Vlera e garancisë përcaktohet nga institucioni ose enti publik që e jep në përdorim. Garancia e parashikuar në këtë paragraf kërkohet edhe në rastet e aktiviteteve të përjashtuara nga pagesat e tarifave.

5. Garancia kthehet kur vërtetohet se pasuritë e dhëna në përdorim nuk kanë pësuar dëmtime dhe janë shlyer detyrimet përkatëse.

6. Vlerat minimale të tarifave e shpenzimeve të tjera të lidhura me riprodhimin e pasurive kulturore përcaktohen me udhëzim të institucionit ose entit publik kompetent, që e ka në administrim pasurinë kulturore.

Neni 188

Mbledhja dhe shpërndarja e të ardhurave

1. Institucionet e specializuara, institucionet dhe vendet e kulturës e muzetë, derdhin në llogari të subjekteve që kanë në administrim/institutet, vendet dhe pasuritë e veçanta të ardhurat që vijnë nga shitja e biletave të hyrjes, si dhe nga çmimet/tarifat e përdorimit, të shërbimeve dhe detyrimet e tjera të lidhura me riprodhimin e pasurive kulturore, në zbatim të parashikimeve të marrëveshjes së përmendur në pikën 5, të nenit 171, dhe në pikën 5, të nenit 172, të këtij ligji.

2. Të ardhurat, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, për pasuritë kulturore në administrim indirekt:

a) Kalojnë në favor të personit juridik jofitimprurës, të krijuar sipas nenit 171, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij ligji;

b) Administrohen në zbatim të parashikimit të pikës 4, të nenit 20, të këtij ligji, nëse nuk kanë krijuar persona juridikë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Të ardhurat e përmendura në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, përdoren ekskluzivisht për realizimin e ndërhyrjeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe funksionimin e institucioneve e vendeve të kulturës në pronësi ose përdorim shtetëror, si dhe në mbështetje të programeve të edukimit.

4. Të ardhurat, në kuptim të shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij neni, përdoren për rritjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore nga Fondi Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, i krijuar pranë ministrisë përgjegjëse për kulturën, sipas parashikimeve të këtij ligji.

PJESA E TRETË
MUZETË
TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kreu I
Përgjegjësitë dhe funksionet
në fushën e muzeve

Neni 189

Përcaktimi i marrëdhënieve
në fushën e muzeve

Pjesa e tretë e këtij ligji përcakton marrëdhëniet dhe rregullat për krijimin, akreditimin, funksionimin dhe mënyrën e organizimit të muzeve publikë e privatë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim ruajtjen, mbrojtjen, administrimin dhe ekspozimin e objekteve e të koleksioneve muzeore, si dhe kontrollin e veprimtarisë dhe vlerësimit të tyre.

Neni 190

Koncepti i muzeut

Muze është një institucion i përhershëm, jofitimprurës, edukativ, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, i cili pasuron fondin, studion, komunikon dhe ekspozon trashëgiminë materiale e jomateriale të njerëzimit dhe mjedisit rreth saj, me qëllim edukimin, studimin dhe gëzimin e saj nga ana e shoqërisë. Si të tillë, muzetë janë institucione që përfaqësojnë diversitetin natyror e kulturor të njerëzimit, duke luajtur një rol thelbësor në mbrojtjen, ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore.

Neni 191

Përgjegjësitë në aktivitetin e muzeve

1. Muzetë kanë detyrë të pasurojnë fondin, si dhe të ruajnë, mbrojnë e promovojnë trashëgiminë kulturore dhe natyrore, materiale e jomateriale të koleksioneve të tyre.
2. Muzetë kanë përgjegjësi të veçantë për kujdesin, aksesin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura e të ruajtura në koleksionet e tyre.
3. Muzetë kanë përgjegjësi në zhvillimin e rolit edukativ dhe tërheqjen e publikut të gjerë.
4. Muzetë janë përgjegjës për paraqitjen e koleksioneve muzeore të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të komuniteteve prej nga kanë ardhur, duke respektuar identitetin kombëtar, vendor, etnik, fetar apo politik.

Neni 192

Funksionet kryesore të muzeve

Funksionet kryesore të muzeve, në zbatim të këtij ligji, janë:

- a) Ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, e cila përfshin veprimtaritë që lidhen me administrimin e koleksioneve, analizën e rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve për gatishmërinë dhe planet e emergjencës, sigurinë, konservimin parandalues e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, për të siguruar integritetin e koleksioneve muzeore;
- b) Pasurimi i fondit, ekspozimi dhe hulumtimi i koleksioneve, funksione këto që mund të kryhen në bashkëpunim me të tretë, me qëllim përfitim të njohurive të thelluara, reflektimin mbi historinë në një kontekst bashkëkohor, interpretimin, përfaqësimin dhe prezantimin e koleksioneve ndaj publikut;
- c) Administrimi direkt e indirekt dhe bashkëpunimi me institucione publike ose private, me qëllim

krijimin e formave të reja të të ardhurave, burimeve të financimit, për rritjen e shërbimeve ndaj publikut;

ç) Edukimi, i cili përfshin edukimin formal e joformal të të mësuarit, zhvillimin dhe transmetimin e programeve edukative dhe pedagogjike nëpërmjet kulturës, rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nxitjen e krijimtarisë artistike kulturore, në bashkëpunim me institucionet arsimore;

d) Evidentimi dhe komunikimi, që përfshin mënyrën aktive të interpretimit e të shpërndarjes së njohurive mbi koleksionet muzeore, pasuritë kulturore, organizimit të ekspozitave dhe aktiviteteve promovuese për çdo grup-moshë, sipas rastit dhe në çdo formë të mundur të komunikimit me publikun.

Neni 193

Klasifikimi i muzeve

1. Në lidhje me propozuesit për krijimin e muzeve, muzetë klasifikohen në:

- a) Muze qendror;
- b) Muze vendor;
- c) Muze autonom;
- ç) Muze privat.

2. Sipas tematikës, muzetë klasifikohen në:

a) Të përgjithshëm, ku tematikat e aktiviteteve të tyre mbulojnë fusha të dijes apo artit, si dhe disponojnë fond kryesor të lidhur me vlera kulturore të klasifikimeve dhe llojeve të ndryshme;

b) Të specializuar, ku tematika e aktiviteteve të tyre mbulon një fushë të veçantë të dijes apo artit, një temë të veçantë të zhvillimit të shoqërisë apo natyrës, si dhe disponojnë fond kryesor të lidhur me vlera kulturore, të cilat përkojnë me këtë tematikë.

3. Sipas pronësisë së fondeve, muzetë ndahen në:

a) Muze publikë, që janë muzetë qendrorë, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, muzetë vendorë, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, dhe muzetë autonomë, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, dhe shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 214 të këtij ligji;

b) Muze privatë, që janë muzetë autonomë sipas pikës 1, të këtij neni, dhe shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 214, të këtij ligji, dhe muzetë privatë, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 194

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Muzetë, brenda fushës së veprimtarisë së tyre, bashkëpunojnë me muzetë e vendeve të tjera, aderojnë në organizata muzeore ndërkombëtare dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ato.

2. Efektet financiare për pjesëmarrjen e muzeut publik në organizmat ndërkombëtarë përballohen nga buxheti i institucionit apo nga organi nga i cili administrohet muzeu ose nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 195

Financimi i muzeve publikë dhe të ardhurat e krijuara

1. Muzetë publikë financohen nga fonde publike dhe çdo fond tjetër për kryerjen e funksioneve të tyre.

2. Muzetë publikë mund të përfitojnë burime financiare shtesë nga burime të tjera dhe donacionet.

3. Muzetë publikë krijojnë të ardhura dytësore nga përdorimi, administrimi dhe ofrimi i shërbimeve, të cilat transferohen në llogarinë e tyre, sipas udhëzimeve të përbashkëta të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat për tarifata dytësore, dhe ato përdoren vetëm për kryerjen e funksioneve të tyre.

Kreu II **Institucionet në fushën e muzeve**

Seksioni I *Dispozita të përgjithshme*

Neni 196

Kompetenca e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në fushën e muzeve ka këto kompetenca:

- a) Harton strategji kombëtare dhe politikën kombëtare në fushën e muzeve;
- b) Zhvillon politikat aktive në ruajtjen, hulumtimin, edukimin dhe komunikimin e fondeve muzeore, të përshtatura për kontekste kulturore dhe sociale;
- c) Harton strategji për pasurimin e fondeve muzeore dhe, në zbatim të tyre, parashikon fonde në buxhetin e shtetit për këtë qëllim;
- ç) Ndërmerr procedura për miratimin dhe harmonizimin e akteve ndërkombëtare në legjislacionin kombëtar për zhvillimin e standardeve dhe të politikave të muzeve;
- d) Ndihmon në qasjen në teknologji të muzeve, si dhe në rritjen e kapaciteteve për përvetësimin e njohurive e të aftësive për përdorimin e teknologjisë në mënyrë efektive;
- dh) Nxit e miraton bashkëpunimin dhe partneritetin ndërmjet muzeve dhe institucioneve kulturore e shkencore në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në rrjete profesionale, shoqata që nxisin një bashkëpunim të tillë dhe ekspozita ndërkombëtare, në shkëmbime dhe lëvizshmëri të koleksioneve.

Neni 197

Funksioni, përbërja dhe kompetencat e Këshillit Kombëtar të Muzeve

1. Këshilli Kombëtar i Muzeve (KKM) është një organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, i krijuar me qëllim marrjen e vendimeve për çështjet që kanë të bëjnë me strategjinë kombëtare në fushën e muzeve, për krijimin, ruajtjen dhe funksionimin e muzeve, si dhe promovimin, bashkëpunimin e institucioneve.

2. KKM-ja përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në përbërje të tij zgjidhen përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara dhe personalitete të shquara në fushën e muzeologjisë.

3. KKM-ja ka këto kompetenca:

- a) Përcakton normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sigurinë fizike të muzeve e të fondit muzeor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregullat në fuqi për fondin arkivor. Këto norma miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë muzetë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga lloji;
- b) Vendos në lidhje me krijimin, riorganizimin, akreditimin dhe mbylljen e muzeve;
- c) Këshillon ministrinë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore me opinione në lidhje me pjesë të buxhetit të shtetit dhe projektbuxhetet vendore, të cilat kanë të bëjnë me financimin e muzeve, si dhe në lidhje me çështje të tjera që lidhen me funksionimin e muzeve;
- ç) Koordinon punën e Bordit të Akreditimit të Muzeve, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- d) Nxit zhvillimin dhe bashkëpunimin e muzeve publikë e privatë;
- dh) Çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë ligj.

4. Funksionimi, organizimi, mënyra e mbledhjeve dhe e shpërblimit të anëtarëve të KKM-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 198

Kompetenca të përgjithshme të muzeve

1. Muzetë, në zhvillimin e aktiviteteve të tyre:
 - a) Kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore të komunitetit;
 - b) Bashkëpunojnë me subjektet arsimore, duke u ofruar personave të të gjitha moshave mundësi për të mësuar nëpërmjet kontaktit me materiale origjinale;
 - c) Sigurojnë aksesueshmërinë kulturore për të gjithë grup-moshat, nëpërmjet aksesit në hapësirat ekspozuese, dhomat e takimeve, faqet e internetit;
 - ç) Organizojnë ngjarje kulturore dhe aktivitete social-kulturore;
 - d) Veprojnë si qendra të ekspertizës objektive profesionale;
 - dh) Sigurojnë mundësinë për përfshirjen e komunitetit, nëpërmjet programeve vullnetare, grupeve të miqve apo programeve të trajnimit;
 - e) Punojnë në partneritet me subjekte të tjera kulturore, siç janë bibliotekat, arkivat, teatrot, qendrat e arteve, për zhvillimin e programeve dhe të projekteve të përbashkëta;
 - ë) Sigurojnë disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut për vizitorët dhe studiuesit;
 - f) Ofrojnë shërbime dhe përdorin të ardhurat e krijuara prej tyre, me qëllim funksionimin e muzeut, pasurimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e koleksioneve muzeore, restaurimin, përmirësimin e njohurive profesionale të punonjësve, stimulimin dhe sigurimin e punës kërkimore;
 - g) Respektojnë të drejtën e autorit në lidhje me koleksionet e muzeve në administrim të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit;
 - gj) Marrin fonde nga buxheti i shtetit ose organizma, partnerë ndërkombëtarë, për zbatimin e projekteve të arteve kulturore e historike, arteve të bukura dhe programeve të tjera të rëndësishme kombëtare;
 - h) Hyjnë në transaksione ligjore civile, në mënyrë që të promovojnë ruajtjen, plotësimin, hulumtimin e koleksioneve muzeore, si dhe transaksione të tjera, të cilat janë të nevojshme për sigurimin e funksionimit të muzeut;
 - i) Marrin mbështetjen metodologjike të Këshillit Kombëtar të Muzeve;
 - j) Hartojnë një raport vjetor për aktivitetet e kryera dhe përcjellin informacion pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - k) Krijojnë persona juridikë, me qëllim mbrojtjen, ruajtjen, vlerësimin dhe administrimin e fondit muzeor në administrim;
 - l) Organizojnë qarkullimin me dalje të përkohshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas marrjes së licencave dhe autorizimeve të caktuara, sipas rregullimeve ligjore në fuqi.
2. Muzetë qendrorë e vendorë nuk mund të tjetërsojnë ose të tërheqin objekte muzeore dhe koleksione nga koleksionet e muzeut pa lejen e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.
3. Të drejtat dhe detyrimet specifike të muzeve përcaktohen në aktet nënligjore, rregulloret e brendshme ose kontratat përkatëse të muzeve.
4. Një muze mund të kryejë aktivitete shkencore dhe të regjistrohet në regjistrin e institucioneve shkencore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin dhe shkencën.

Neni 199

Emërimi i drejtorëve të muzeve

1. Drejtori i muzeut qendror emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë për një mandat

trevjeçar, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve.

2. Drejtori i muzeut vendor emërohet nga titullari i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një mandat trevjeçar, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve.

3. Drejtori i muzeut privat dhe autonom emërohet në detyrë nga subjekti juridik themelues/propozues, duke marrë parasysh kriteret e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve.

4. Procedura e përzgjedhjes së drejtorëve të muzeve qendrorë e vendorë kryhet nëpërmjet konkursit publik, të realizuar, përkatësisht, nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 200

Konfliktet e interesit të stafit të muzeve

1. Drejtorët dhe punonjësit e muzeve qendrorë, vendorë e autonomë nuk kanë të drejtë të përfitojnë ose posedojnë fonde muzeore apo pasuri kulturore të muzeut në të cilin janë të punësuar.

2. Parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin kur pasuria kulturore është trashëgimi ligjore ose testamentare e subjekteve të përmendura në pikën 1, nëse kjo provohet me dokumentet ligjore përkatëse.

3. Subjektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e detyrës, plotësojnë deklaratën për konfliktin e interesit, formati i së cilës miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Për punonjësit në detyrë, kjo deklaratë plotësohet jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Subjektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete fitimprurëse në fushën e tyre të tematikës së pasurive kulturore.

Seksioni II

Muzetë me status kombëtar

Neni 201

Muzetë kombëtarë

1. Muze kombëtar është muzeu që plotëson tërësinë e këtyre kriterëve:

a) Posedon fond muzeor me vlera kulturore e historike me rëndësi kombëtare;

b) Realizon punë kërkimore dhe siguron hulumtim të plotë të koleksioneve të muzeut e të studimit në disiplinat shkencore;

c) Realizon ekspozita të përhershme dhe të përkohshme, të cilat, së bashku me llojet e tjera të komunikimit që lidhen me funksionimin e muzeut, edukojnë dhe zhvillojnë shoqërinë për të siguruar disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut dhe përdorimin e plotë të tyre;

ç) Gëzon kapacitete dhe ekspertizë profesionale, administrative e menaxheriale të domosdoshme për mirëfunksionimin e aktivitetit muzeor.

2. Statusin “Muze kombëtar” e gëzojnë institucionet muzeore në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe muzetë privatë.

Neni 202

Muzetë me status kombëtar

Muzetë me status kombëtar, në kuptim të këtij ligji, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, janë:

a) Muzeu Historik Kombëtar;

b) Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura;

c) Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”;

ç) Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar;

- d) Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia e gjetheve”;
- dh) Muzeu Kombëtar i Pavarësisë;
- e) Muzeu Kombëtar i Bashkëjetesës;
- ë) Qendra Muzeore Krujë-“Muzeu Kombëtar Skënderbeu, Muzeu Etnografik Krujë”;
- f) Qendra Muzeore Berat - Muzeu i ikonografisë “Onufri”, Muzeu Etnografik Berat;
- g) Qendra Muzeore Durrës - Muzeu Kombëtar Arkeologjik dhe Parku Arkeologjik Durrës.

Muzetë me status kombëtar zbatojnë parashikimet e këtij ligji për sa i përket ushtrimit të funksioneve të tyre si mbajtës, ruajtës, mbrojtës dhe vlerësues të pasurive kulturore në administrim të tyre.

Me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, Këshilli i Ministrave mund të miratojë krijimin e muzeve të rinj me status kombëtar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 203

Muzetë pa status kombëtar

Të gjithë muzetë, të cilët nuk plotësojnë tërësinë e kritereve të parashikuara në nenin 201, të këtij ligji, janë institucione muzeore që zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

Neni 204

Muzeu Historik Kombëtar

1. Muzeu Historik Kombëtar është muzeu kryesor i trashëgimisë kulturore në Shqipëri. MHK-ja është institucion shkencor e arkivor i trashëgimisë kulturore dhe muzeve, me status muze kombëtar, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me seli në qytetin e Tiranës.

2. Funkzioni themelor i MHK-së është përcimi i historisë së vendit, i cili ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e identitetit kombëtar, zhvillimin e rolit edukativ dhe në përcjelljen e këtij imazhi te vizitorët; studimi, kërkimi, konceptimi, projektimi, mbikëqyrja, konservimi, restaurimi, promovimi, publikimi, konsulenca dhe bashkëpunimi me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e tematikës.

3. MHK-ja nxit dialogun midis qytetarëve për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen shqiptare. Për këtë qëllim, ai përfton, ruan e studion provat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike e kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin dhe argëtimin.

4. Ekspozimi i fondit të MHK-së, zhvillimi i aktiviteteve ekspozuese dhe hapja e ekspozitave të përkohshme rregullohen nga parashikimet e këtij ligji dhe ligjit të artit e kulturës, për aq sa është i zbatueshëm.

5. MHK-ja funksionon si sekretariat teknik i KKM-së dhe Bordit të Akreditimit të Muzeve, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Në mbikëqyrjen tematike të MHK-së janë të gjithë muzetë kombëtarë të natyrave të ndryshme. Procedurat e mbikëqyrjes rregullohen me udhëzimet të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

7. MHK-ja mund të krijojë shoqatën e miqve të muzeut, e cila ka për qëllim dhënien e një kontributi moral e financiar në zhvillimin e veprimtarive dhe të projekteve të edukimit nëpërmjet artit të ndërmarrë nga institucioni, si dhe çdo lloj projekti tjetër. Marrëdhënia e anëtarëve me institucionin parashikohet në aktet e themelimit dhe vendimet e shoqatës.

Neni 205

Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura

1. Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura është një institucion i trashëgimisë kulturore, shkencore dhe arkivore, me statusin “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Tiranës.

2. Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura ka për funksion kryesor administrimin, mbrojtjen, ruajtjen

dhe promovimin e fondit kombëtar të arteve të bukura, studimin, kërkimin, konceptimin, projektimin, mbikëqyrjen, konservimin, restaurimin, promovimin, publikimin, konsulencën dhe bashkëpunimin me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e arteve të bukura.

3. Ekspozimi i fondit të muzeut, zhvillimi i aktiviteteve ekspozuese dhe hapja e ekspozitave të përkohshme rregullohen nga parashikimet e këtij ligji dhe ato të ligjit për artin dhe kulturën, për aq sa janë të zbatueshme.

4. Pranë Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura ngrihet dhe funksionon Qendra e Restaurimit dhe Studimit të Arteve të Bukura, e cila ngrihet edhe si qendër e restaurimit të materialeve dhe veprave të artit pamor, me synimin për të formuar restauratorët e ardhshëm në fushën e artit pamor, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e kësaj qendre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Nën mbikëqyrjen tematike të Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura janë të gjithë muzetë dhe galeritë e arteve të natyrave të ndryshme. Procedurat e mbikëqyrjes tematike rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

6. Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura mund të krijojë shoqatën e miqve të arteve të bukura, e cila ka për qëllim dhënien e një kontributi moral e financiar në zhvillimin e veprimtarive dhe projekteve të edukimit nëpërmjet artit, të ndërmarra nga institucioni, si dhe çdo lloj projekti tjetër. Marrëdhënia e anëtarëve me institucionin parashikohet në aktet e themelimit dhe vendimet e shoqatës.

Neni 206

Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”

1. Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, më poshtë referuar si muzeu “Marubi”, është institucion shkencor dhe arkivor, me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Shkodrës.

2. Muzeu “Marubi” ka detyrë themelore studimin, kërkimin, konceptimin, projektimin, mbikëqyrjen, konservimin, restaurimin, promo-vimin, publikimin, konsulencën dhe bashkë-punimin me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e fotografisë.

3. Nën mbikëqyrjen tematike të muzeut “Marubi” janë muzetë, galeritë, pinakotekat dhe ente të natyrave të ndryshme në fushën e fotografisë. Procedurat e mbikëqyrjes rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Pranë muzeut “Marubi” ngrihet dhe funksionon fondacioni “Marubi”, i cili ngrihet edhe si qendër e restaurimit të fotografisë, me synimin për të formuar restauratorët e ardhshëm të materialeve fotografike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Gjithashtu, fondacioni “Marubi” ushtron funksione të tjera, të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe në aktin e themelimit.

Neni 207

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar

1. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është institucion arkivor, me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Korçës.

2. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar ka detyrë themelore studimin, kërkimin, konceptimin, projektimin, mbikëqyrjen, konservimin, restaurimin, promovimin, publikimin, konsulencën dhe bashkëpunimin me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e ikonografisë.

3. Pranë Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar ngrihet dhe funksionon Qendra e Restaurimit dhe Studimit të Ikonave, e cila ngrihet edhe si qendër e restaurimit të materialeve dhe veprave ikonografike, me synimin për të formuar restauratorët e ardhshëm në fushën e ikonografisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e kësaj qendre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 208

**Muzeu Kombëtar i Përgjimeve
“Shtëpia me gjethe”**

1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” është një institucion i specializuar në fushën muzeore, me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Tiranës.

2. Funksioni themelor i këtij muzeu është përkujtimi i dhunës psikologjike të regjimit komunist dhe kontrolli i qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit, me interes për vizitorët vendas dhe të huaj.

3. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e këtij muzeu rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 209

Muzeu Kombëtar i Pavarësisë

1. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë është institucion arkivor në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Vlorës.

2. Funksioni themelor i Muzeut Kombëtar të Pavarësisë është studimi, kërkimi, arkivimi, promovimi, publikimi, konsulenca dhe bashkëpunimi me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, për periudhën historike të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar.

3. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e këtij muzeu rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 210

Muzeu Kombëtar i Bashkëjetesës

1. Muzeu Kombëtar i Bashkëjetesës është institucion arkivor në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Tiranës.

2. Funksioni themelor i Muzeut Kombëtar të Bashkëjetesës është studimi, kërkimi, ruajtja, mbrojtja vlerësimi, administrimi, promovimi, publikimi, konsulenca dhe bashkëpunimi me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e bashkëjetesës fetare dhe tolerancës në Shqipëri.

3. Funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e këtij muzeu rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 211

Qendra Muzeore Krujë

Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” dhe Muzeu Kombëtar Etnografik, Krujë

1. Qendra Muzeore Krujë është institucion arkivor, me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin Krujë, e cila administron Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” dhe Muzeun Etnografik Krujë.

2. Funksioni themelor i Muzeut Kombëtar “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” është përçimi i rolit dhe i raporteve të botës shqiptare në periudhën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut me vende të Evropës dhe me Perandorinë Osmane, principatave shqiptare, luftës kundër osmanëve, si dhe qëndresës së shqiptarëve në Mesjetë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e identitetit kombëtar, zhvillimin e rolit edukativ, si dhe për përcjelljen e këtij imazhi te vizitorët.

3. Funksioni themelor i Muzeut Etnografik Krujë është pasqyrimi i provave materiale të stilit të jetesës, zejtarisë, aftësisë, ritualeve dhe besimeve të zonës së Krujës.

Neni 212

Qendra Muzeore Durrës
Muzeu Kombëtar i Arkeologjisë dhe
Parku Arkeologjik Durrës

1. Qendra Muzeore Durrës (QMD) është institucion me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Durrësit, e cila administron Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë dhe Parkun Arkeologjik Durrës, kufijtë e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe ka kodin e etikës, ku janë përcaktuar vlerat dhe parimet themelore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i saj.

2. Qendra Muzeore Durrës ka si funksion themelor ruajtjen, mbrojtjen, hulumtimin, administrimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore në Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë dhe Parkun Arkeologjik Durrës.

3. Parku Arkeologjik Durrës është territor i përcaktuar me kufij të qartë, në qytetin e Durrësit, në të cilin përfshihen dëshmi të rëndësishme arkeologjike dhe bashkëprani e pasurive kulturore, historike, arkitektonike, urbanistike dhe të peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

4. Muzeu Kombëtar i Arkeologjisë ka për detyrë përmirësimin dhe pasurimin e mëtejshëm të ekspozimit, duke hulumtuar fondin e pasur muzeor arkeologjik të tij.

5. QMD-ja ka për detyrë prezantimin dhe interpretimin në mënyrë aktive të njohurive mbi artefaktet e zbuluara nga gërmimet arkeologjike, kryesisht në rajonin e Durrësit, por jo vetëm, të periudhës ilire, antike greke, romake dhe të mesjetës. Ajo organizon ekspozita dhe aktivitete promovuese, në çdo formë të mundur të komunikimit me publikun.

6. QMD-ja bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj me DRTK-në Durrës dhe strukturat e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 213

Qendra Muzeore Berat
Muzeu Ikonografik “Onufri” dhe
Muzeu Etnografik Berat

1. Qendra Muzeore Berat është institucion i specializuar dhe arkivor, me status “muze kombëtar”, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me seli në qytetin e Beratit, e cila administron Muzeun Ikonografik “Onufri” dhe Muzeun Etnografik Berat.

2. Funksioni themelor i Muzeut Ikonografik “Onufri” është përçimi i interpretimit të veprave të Onufrit, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e identitetit kombëtar, zhvillimi i rolit edukativ, si dhe për përcjelljen e këtij imazhi te vizitorët dhe në botën e jashtme.

3. Funksioni themelor i Muzeut Etnografik Berat është pasqyrimi i provave materiale të stilit të jetesës, zejtarisë, aftësisë, ritualeve dhe besimeve të zonës së Beratit.

TITULLI II

KRIJIMI, AKREDITIMI DHE
MBYLLJA E MUZEVE

Neni 214

Krijimi dhe mbyllja e muzeve

1. Muze qendror është institucioni publik që krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe miratimit të Këshillit Kombëtar të Muzeve. Struktura organizative miratohet me urdhër të Kryeministrit.

2. Muze vendor është institucioni publik që krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me

vendim të këshillit bashkiak, me propozim të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe miratim të Këshillit Kombëtar të Muzeve. Struktura organizative miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

3. Muze autonom është:

a) Institucioni publik që krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të një institucioni publik, të ndryshëm nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të ndryshëm nga njësia e vetëqeverisjes vendore, dhe miratimit të Këshillit Kombëtar të Muzeve. Struktura organizative miratohet me urdhër të Kryeministrit;

b) Personi juridik privat, i cili krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga personi juridik publik qendror ose vendor, me kapital shtetëror, ose ndonjë person tjetër juridik privat, por që pjesëmarrës ose themelues ka një person juridik publik, dhe miratimit të Këshillit Kombëtar të Muzeve. Struktura organizative miratohet me urdhër të Kryeministrit.

4. Muze privat është personi juridik privat, i cili krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas propozimit nga personat fizikë apo juridikë, pronarë ose posedues të koleksioneve muzeorë, dhe miratimit të Këshillit Kombëtar të Muzeve. Struktura administrative miratohet me vendim të themeluesit.

Neni 215

Procedura e krijimit dhe regjistrimit të muzeve

1. Institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë mund të paraqesin kërkesën e tyre të shoqëruar me dokumentacionin përkatës pranë Muzeut Historik Kombëtar, në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve, me qëllim marrjen e vendimit paraprak për krijimin e një muzeu. Format i kërkesës, dokumentacioni shoqërues dhe procedura e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e sekretariatit teknik rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

2. Dokumentacioni për krijimin e një muzeu, ndër të tjera, duhet të provojë:

a) Ekzistencën e objekteve muzeore, koleksioneve të shoqëruara me dokumentacionet përkatëse të lëshuara nga IKRTK-ja;

b) Ekzistencën e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen, mbrojtjen e objekteve dhe zhvillimin e aktivitetit muzeor;

c) Burime njerëzore e financiare, që sigurojnë qëndrueshmërinë e muzeut;

ç) Strategjinë për zhvillimin e aktivitetit muzeor dhe muzeografinë.

3. Këshilli Kombëtar i Muzeve, nëse e konsideron të plotë informacionin e paraqitur nga subjektet në pikën 1, të këtij neni, brenda 60 ditëve nga depozitimi i tij, merr vendimin paraprak mbi pajtueshmërinë e kërkesës me dispozitat ligjore të këtij ligji. Vendimi i KKM-së parashikon afatin, brenda të cilit kërkuesi është i detyruar të ndër marrë hapat ligjorë për krijimin e muzeut si një organizatë jofitimprurëse.

4. Mospërmbyllja e këtij detyrimi nga ana e kërkuesit në afatin e përcaktuar në vendim, apo i çdo kushti tjetër të vendosur prej KKM-së, sjell shfuqizimin e vendimit. Subjektet e pikës 1, të këtij neni, përpara përfundimit të afatit mund të kërkojnë zgjatjen e tij me një periudhë jo më shumë se afati i përcaktuar në vendim. Në rastet e përfundimit të afateve, subjektet e pikës 1 riparaqesin kërkesën pranë KKM-së.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Muzeve, për pajtueshmërinë e muzeut apo rrëzimin e kërkesës, i njoftohet palës propozuese. Vendimi mund të kundërshtohet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

6. Muzeu Historik Kombëtar krijon dhe mban Regjistrin Kombëtar të Muzeve. Në kërkesën për regjistrim, subjektet kërkuese duhet të vërtetojnë plotësimin e kushteve dhe të afateve të përcaktuara në vendimin e KKM-së, si dhe statusin juridik të subjektit, si organizatë jofitimprurëse.

Neni 216

Akreditimi i muzeve

1. Muzetë akreditohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pas propozimit të Këshillit Kombëtar të Muzeve, në bazë të raportit të verifikimit nga Bordi i Akreditimit, i ngritur pranë Këshillit Kombëtar të Muzeve.

2. Akreditimi i muzeve është një proces që kryhet periodikisht, çdo 5 vjet, dhe, në raste të veçanta, kur ka indicie për mosplotësim të kushteve të caktuara nga muzeu, me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore ky proces kryhet rast pas rasti.

3. Procesi i akreditimit kalon në tri faza, të cilat janë:

a) Procesi i verifikimit nga ana e Bordit të Akreditimit;

b) Procesi i shqyrtimit nga KKM-ja;

c) Regjistrimi në listën e muzeve të akredituar.

4. Një muze i krijuar në kushtet e nenit 215, të këtij ligji mund të akreditohet nëse plotëson, ndër të tjera, kushtet e përgjithshme të mëposhtme:

a) Plotëson kriteret e përgjithshme të krijimit të muzeut;

b) Është kryer inventari i koleksioneve të muzeut;

c) Disponon ambientet, pajisjet dhe sistemet e sigurisë që garantojnë ruajtjen e koleksioneve të muzeut;

ç) Siguron disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut për shoqërinë;

d) Ka të hartuar një strategji për funksionimin dhe zhvillimin e muzeut.

5. Muzetë publikë detyrohen të kryejnë akreditimin jo më vonë se një periudhë kohore prej 5 vjetësh nga miratimi i këtij ligji ose nga krijimi i tyre. Muzetë privatë aplikojnë për akreditim me nismën e tyre.

6. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore krijon dhe përditëson një seksion të veçantë në Regjistrin Kombëtar të Muzeve në lidhje me akreditimin.

Neni 217

Bordi i Akreditimit të Muzeve

1. Bordi i Akreditimit të Muzeve përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë 2-vjeçare me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, prej të cilëve:

- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

- 1 ekspert i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vlerësues të pasurive të luajshme pranë IKRTK-së;

- 1 ekspert i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vlerësues të pasurive të paluajshme pranë IKTK-së;

- 1 ekspert i përzgjedhur nga KKM-ja;

- 1 ekspert i përzgjedhur nga KKMPK-ja.

2. Bordi i Akreditimit të Muzeve ngrihet dhe funksionon pranë KKM-së. Mënyra e funksionimit rregullohet sipas parashikimit të nenit 41 të këtij ligji. Shpërblimi i anëtarëve të bordit të akreditimit të muzeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 218

Procedura e akreditimit të muzeve

1. Subjektet e interesuara ose ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas parashikimeve të nenit 194, të këtij ligji, paraqesin pranë MHK-së, në cilësinë e sekretariatit teknik të KKM-së, kërkesën për akreditim të institucionit muzeor. MHK-ja, brenda një afati prej 15 ditësh nga kërkesa, i paraqet Bordit të Akreditimit të Muzeve relacionin mbi përputhshmërinë formale të kërkesës

me formatin dhe dokumentacionin që shoqëron kërkesën, të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Bordi i Akreditimit, pas marrjes së relacionit dhe dokumentacionit që shoqëron kërkesën nga MHK-ja, fillon procesin e verifikimit, i cili përfundon me një raport paraprak. Ky raport i njoftohet subjekteve të interesuara, të cilat, brenda 30 ditëve, paraqesin vëzhgimet e tyre. Raporti përfundimtar në vijim të vëzhgimeve të subjekteve të interesuara i paraqitet KKM-së jo më vonë se 8 muaj, nga paraqitja e kërkesës. Bordi i Akreditimit të Muzeve, në fund të raportit, i propozon Këshillit Kombëtar të Muzeve dhënien ose jo të akreditimit për muzeun.

3. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Muzeve për akreditimin e muzeut apo rrëzimin e kërkesës i njoftohet palës propozuese dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, e cila, nëse propozimi është pozitiv, lëshon certifikatën e akreditimit për muzeun. Vendimi i KKM-së mund të ankimohej në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

4. Format i certifikatës së akreditimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës.

Neni 219

Të drejtat e muzeve të akredituar

1. Muzetë e akredituar kanë këto të drejta:

a) Përfitojnë mbështetje nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në lidhje me programet e tyre të edukimit;

b) Promovohen nga institucionet qendrore e vendore në fushën e turizmit dhe mbështetet pjesëmarrja e tyre në rrejtet ndërkombëtare;

c) Kanë të drejtën e parablerjes së fondeve muzeore të muzeve në proces mbylljeje dhe likuidimi;

ç) Përfitojnë rimbursim nga ministria përgjegjëse për kulturën, të vlerës së taksës mbi ndërtesën, në të cilën kryhet aktiviteti muzeor.

2. Fondi muzeor i muzeut të akredituar përfshihet në Fondin Muzeor Kombëtar.

Neni 220

Procedurat e mbylljes së muzeve

1. Muzetë mbyllen në rastet, kur:

a) Pushojnë së përmbushuri kushtet e veçanta të krijimit;

b) Nuk kryejnë më aktivitetin për të cilin janë krijuar;

c) Nuk kanë më interes të zhvillojnë aktivitetet;

ç) Për çdo arsye tjetër.

2. Subjekti propozues për krijimin e muzeut i kërkon Këshillit Kombëtar të Muzeve mbylljen e muzeut kur vërtetohen rastet e pikës 1 të këtij neni. Këshilli Kombëtar i Muzeve, brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës, vendos miratimin e mbylljes së muzeut, si dhe vendos në lidhje me shpërndarjen dhe destinacionin e fondit të tij muzeor.

3. Në rastin e muzeve publikë, Këshilli Kombëtar i Muzeve, në vendimin e mbylljes, përcakton depozitimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve të muzeut pranë një muzeu qendror, i cili përmbush kriteret për ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve muzeore.

4. Në rastin e muzeve privatë, në kërkesën e tyre për mbyllje subjekti kërkues duhet të specifikojë vendndodhjen ku do të mbahen objektet muzeore, në rast ndryshimi të vendndodhjes. Në vendimin e saj KKM-ja, pas marrjes së mendimit nga muzeu, i cili, në kuptim të këtij ligji, ka mbikëqyrjen tematike të tipologjisë së muzeut, dhe DRTK-ja, sipas parashikimeve të pjesës së dytë të këtij ligji, japin mendimin e tyre në lidhje me përputhshmërinë e vendndodhjes së re me regjimin e ruajtjes dhe të mbrojtjes së objekteve muzeore. Në rast mospërputhshmërie të vendndodhjes së re me regjimin e ruajtjes e të mbrojtjes së objekteve, KKM-ja vendos për qëndrimin e përkohshëm të tyre në muzetë publikë.

5. Brenda 60 ditëve, nga vendimi i KKM-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, për muzetë qendrorë, të këshillit bashkiak, për muzetë vendorë, me vendim të titullarit ose organeve kolegjiale, për muzetë autonomë, me vendim të personit juridik, si dhe me deklaratë të personit fizik, për muzetë privatë, përfundon procesi i mbylljes së muzeve.

6. Brenda 30 ditëve nga marrja e vendimeve të organeve të përmendura në pikat 4 e 5, të këtij neni, dhe deklaratës së personit fizik, vendimi publikohet, përkatësisht, në Fletoren Zyrtare, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në vendet e njoftimeve, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative. Këto vendime i njoftohen brenda 30 ditëve nga publikimi MHK-së dhe IKRTK-së, për efekt të përditësimit të regjistrave kombëtarë.

7. Nëse, në momentin e mbylljes së muzeve privatë, pronari vendos të shesë objektet muzeore, muzetë publikë dhe muzetë e akredituar kanë të drejtën e parablerjes së koleksioneve dhe të objekteve muzeore që ai disponon, në kushtet e parashikuara në pjesën II të këtij ligji.

TITULLI III FONDET MUZEORE DHE FONDI MUZEOR KOMBËTAR

Kreu I Koleksionet muzeore

Neni 221 **Regjistrimi i koleksioneve**

1. Objektet muzeore dhe koleksionet, që janë pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore, regjistrohen në regjistrat e veçantë të institucioneve që i administrojnë, si dhe nga IKRTK-ja, në zbatim të parashikimeve të pjesës II, të këtij ligji, të kësaj pjese, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Objekte muzeore, pjesë të koleksioneve muzeore, çregjistrohen nga regjistri i muzeut nëse:

- a) Janë zhvlerësuar ose dëmtuar;
- b) Janë të vjedhura;
- c) Janë eksportuar në mënyrë të përhershme;
- ç) Janë shkëmbyer;
- d) Administrimi i tyre është transferuar.

3. Të dhënat e veçanta për koleksionet mbahen nga muzetë në mënyrë kronologjike dhe katalogohen mbi bazën e një përpunimi profesional e vlerësimi shkencor, në mënyrë që të identifikohen objektet muzeore, pjesë të koleksioneve, ose të caktohet vlera e tij kulturore, artistike, historike ose shkencore. Këta regjistra janë objekt kontrolli dhe monitorimi nga muzeu përgjegjës për mbikëqyrjen tematike, si dhe nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore.

4. Një pasuri e luajtshme kulturore, e lidhur me një koleksion muzeor ose jo, regjistrohet në regjistrin e IKRTK-së si objekt i lidhur me koleksionin pas miratimit nga komisioni i vlerësimit pranë IKRTK-së. Për dijëni, njoftimi i këtij regjistrimi i dërgohet edhe pronarit të koleksionit.

Neni 222 **Fondi Muzeor Kombëtar**

1. Fondet e pasurive kulturore të luajtshme, në kuptim të këtij ligji, që janë fonde muzeore të muzeve të akredituar, përbëjnë Fondin Muzeor Kombëtar, i cili mbrohet nga shteti, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Fondi Muzeor Kombëtar formohet nga tërësia e koleksioneve të muzeve të akredituar qendrorë e vendorë dhe atyre autonomë e privatë.

3. Objektet dhe koleksionet e Fondit Muzeor Kombëtar përfshihen në Katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar - një bazë të dhënash, që përmban informacionin bazë në lidhje me objektet dhe koleksionet

muzeore, katalog, i cili mbahet dhe përditësohet nga IKRTK-ja. Këshilli Kombëtar i Muzeve përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin, plotësimin, përditësimin e Katalogut të Fondit Muzeor Kombëtar.

4. Një objekt ose koleksion muzeor çregjistrohet nga Fondi Muzeor Kombëtar, por vazhdon të jetë objekt i regjimeve mbrojtëse e ruajtëse të pasurive kulturore të luajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, në rastet e çregjistrimit nga fondi muzeor i muzeut të akredituar, kur ai:

- a) Ka dëmtime të mëdha, për shkak të të cilave nuk mund të restaurohet;
- b) Ka humbur ose, natyrshëm, është shpërbërë;
- c) Është marrë në mënyrë të paligjshme;
- ç) E ka humbur vlerën e lidhur me muzeun.

5. Me propozimin e përbashkët të IKRTK-së e IKTK-së dhe miratimin e KKM-së hartohen masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe çarkullimin e objekteve muzeore e të koleksioneve muzeore.

Neni 223

Koleksionimi i objekteve muzeore

1. Objektet muzeore koleksionohen nëpërmjet hulumtimit në terren, blerjes, donacioneve, shkëmbimit ose në çdo mënyrë tjetër, në përputhje me këtë ligj, pas verifikimit të origjinës së secilit objekt.

2. Muzetë krijojnë një program të koleksionimit të objekteve muzeore për një periudhë 5-vjeçare.

3. Muzetë bashkëpunojnë dhe harmonizojnë programet e tyre të koleksionimit në përputhje me fushat dhe kufijtë e koleksionimit të objekteve të tyre muzeore.

Neni 224

Pasurimi i fondeve muzeore

1. Muzetë publikë ose privatë pasurojnë fondet e tyre muzeore në përputhje me orientimin e tyre profesional, tipologjinë, dhe në zbatim të parashikimeve të përgjithshme të kreu I, të titullit III, të pjesës II, të këtij ligji.

2. Shpenzimet në lidhje me pasurimin e fondeve muzeore parashikohen dhe mbulohen nga burimet financiare të muzeve publikë e privatë.

3. Kërkesa e muzeut publik për pasurim të fondit muzeor dhe dokumentacioni shoqëruar i paraqitet IKRTK-së për të përcaktuar vlerën maksimale të transaksionit. Kërkesa për pasurim të fondeve muzeore, e paraqitur nga ana e muzeve publikë dhe privatë, shqyrtohet e miratohet nga Këshilli Kombëtar i Muzeve, i cili konfirmon vlerën financiare të koleksioneve në kohën e blerjes së tyre, pas marrjes së mendimit nga ana e IKRTK-së.

4. Rregullat, në lidhje me pasurimin e koleksioneve muzeore me prejardhje nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, përcaktohen me urdher të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Muzetë nuk mund të pasurojnë fondin muzeor nëse:

- a) Objektet kanë prejardhje të dyshimtë;
- b) Mungon certifikata e objektit që blihet, dhurohet, trashëgohet ose këmbëhet;
- c) Posedohet në mënyrë të paligjshme ose është eksportuar në mënyrë të paligjshme nga vendi i origjinës apo nga ndonjë vend i ndërmjetëm, në të cilin ai mund të ketë qenë në pronësi;
- ç) Ka shkaqe të arsyeshme të dyshohet se restaurimi i tyre përfshin shkatërrimin ose dëmtimin e pasurive kulturore, të vendeve arkeologjike apo gjeologjike ose specieve dhe habitateve natyrore;

d) Objektet janë mostra biologjike apo gjeologjike që janë mbledhur, shitur, ose transferuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në lidhje me mbrojtjen e kafshëve të egra dhe ruajtjen e historisë natyrore.

6. Koleksionet e mbetjeve mortore e të materialeve të një rëndësie të shenjtë bëhen pjesë e fondit

muzeor vetëm nëse mund të vendosen në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me standardet profesionale, interesat dhe besimet e anëtarëve të komunitetit, grupeve etnike ose fetare, nga të cilat objektet kanë origjinën, kur këto janë të njohura.

7. Koleksionet, që përfshijnë mostra të gjalla botanike e zoologjike, bëhen pjesë e fondit muzeor vetëm nëse bëhen vlerësime të veçanta për mjedisin natyror e shoqëror nga të cilat ato vijnë, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e kafshëve të egra dhe ruajtjen e historisë natyrore.

Neni 225

Tjetërsimi/shkëmbimi i fondeve muzeore

1. Pasuritë kulturore, pjesë e fondeve muzeore, tjetërsohen vetëm në zbatim të parashikimeve të kreut I, të titullit III, të pjesës II, të këtij ligji.

2. Shkëmbimi i fondeve muzeore ndërmjet muzeve realizohet në bazë të një marrëveshjeje shkëmbimi, të lidhur ndërmjet titullarëve të institucioneve muzeore, pas marrjes së miratimit nga ana e institucioneve themeluese dhe nga KKM-ja.

3. Marrëveshja e shkëmbimit të koleksioneve muzeore duhet të përcaktojë, ndër të tjera:

a) Vlerën e objekteve/koleksioneve muzeore/ objekteve të lidhura, që shkëmbehen;

b) Qëllimin dhe nevojën e shkëmbimit;

c) Kohëzgjatjen;

ç) Përgjegjësitë për marrjen e masave ruajtëse e mbrojtëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes;

d) Sanksionet dhe rastet e zgjidhjes së tyre.

4. Gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes së parashikuar në pikën 3, të këtij neni, palët nuk mund të eksportojnë, importojnë apo qarkullojnë në territor objektet e shkëmbyera pa miratimin me shkrim të subjektit që ka në pronësi ose posedim koleksionin muzeor.

Neni 226

Inventarizimi dhe rivlerësimi i objekteve muzeore

1. Raporti i inventarizimit të objekteve muzeore përmban numrin dhe gjendjen e objekteve muzeore, dokumentacionin e tyre dhe masat ruajtëse e mbrojtëse.

2. Muzeu, periodikisht, kryen rivlerësim teknik të objekteve muzeore, në varësi të llojit dhe qëllimit, jo më pak se një herë në tre vjet.

3. Gjatë rivlerësimit teknik mbahet një raport i objekteve muzeore të dëmtuara e shkatërruara.

4. Procedura dhe metoda e rivlerësimit të objekteve muzeore përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Raporti përfundimtar i rivlerësimit të objekteve muzeore përditëson raportin e inventarizimit.

Kreu II

Masat ruajtëse dhe mbrojtëse në fushën e muzeve

Neni 227

Masat ruajtëse dhe mbrojtëse në lidhje me Fondin Muzeor Kombëtar

1. Institucionet publike dhe personat privatë, të cilët kanë pasuritë e tyre pjesë të Fondit Muzeor Kombëtar, zbatojnë parashikimet e përgjithshme mbi masat ruajtëse të parashikuara në pjesën II, të këtij ligji, dhe sigurojnë marrjen e masave për aksesin e publikut, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

2. Në vijim të parashikimeve të pjesës II, të këtij ligji, për objektet muzeore dhe koleksionet muzeore pjesë e Fondit Muzeor Kombëtar, zbatohen rregullimet si më poshtë:

a) Në rastet e tjetërsimit të objekteve muzeore, të përfshira në Fondin Muzeor Kombëtar, muzetë e akredituar kanë të drejtën e parablerjes;

b) Ndalohet vendosja e barrëve, pengut ose sekuestros mbi objektet muzeore ose koleksionet e përfshira në Fondin Muzeor Kombëtar.

3. Nëse një muze nuk siguron ruajtjen e një koleksioni apo të një objekti të përfshirë në fondin e tij muzeor, në përputhje me rregulloren e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Muzeve, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 199, të këtij ligji, ose objekti muzeor apo koleksioni rezultojnë të kenë pësuar dëme të konsiderueshme, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga pronari /administratori i muzeut, e verifikuar kjo nga kontrolli teknik, i kryer nga DRTK-ja kompetente për territorin e vendndodhjes së muzeut, DRTK-ja propozon marrjen e masave urgjente ose të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Në këtë rast zbatohen dispozitat përkatëse të këtij ligji.

Neni 228

Konservimi e restaurimi i objekteve dhe dokumentacionit muzeor

1. Muzetë sigurojnë konservimin parandalues e të përhershëm të objekteve muzeore dhe dokumentacionit muzeor, proces që zhvillohet në vendet e ruajtjes, hapësirat ekspozitore, sallat e seminareve, bibliotekat, arkivat dhe gjatë transportit.

2. Me autorizim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, proceset e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, mund të kryhen në qendrat e restaurimit, të parashikuara në këtë ligj, dhe në qendrat e listuara të restaurimit e konservimit, listë e hartuar dhe e përditësuar nga IKTK-ja.

3. Aktivitetet parandaluese të konservimit përfshijnë marrjen e masave, me qëllim sigurimin për mikroklimë optimale e dritë, si dhe kryerjen e kontrollit të dezinfektimit e procedura të tjera parandaluese.

4. Është i detyrueshëm fotografimi çdo 5 vjet i çdo objekti muzeor dhe mikrofilmimi i librave të inventarit, si një masë mbrojtëse.

Neni 229

Masat mbrojtëse të koleksioneve dhe objekteve muzeore

Muzetë, për të siguruar mbrojtjen e koleksioneve dhe të objekteve muzeore, zbatojnë parashikimet e pjesës II, të këtij ligji, në lidhje me masat mbrojtëse të pasurive të luajtshme, si dhe:

a) Marrin të gjitha masat, me qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e ndërtesave e të objekteve ku janë të vendosura koleksionet;

b) Marrin të gjitha masat për mbrojtje të veçantë për koleksionet në formën e trajtimit bazë, konservimit, ruajtjes dhe restaurimit;

c) Sigurojnë mbrojtjen preventive dhe depozitim të veçantë të koleksioneve;

ç) Marrin përsipër mbrojtjen e koleksioneve gjatë transportit, ekspozitave dhe gjatë shfrytëzimit;

d) Kryejnë kategorizimin dhe vlerësimin e koleksioneve.

Neni 230

Kontrolli dhe inspektimi

1. Kontrolli teknik dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së muzeve ushtrohen nga institucionet e specializuara, sipas kompetencave të tyre, dhe muzetë e mbikëqyrjes tematike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Veprimtaria e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nuk zëvendëson funksionin e inspektimit në fushën e muzeve të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Kreu III

Administrimi dhe përdorimi

Neni 231

Administrimi i muzeve

Muzetë administrohen në mënyrë direkte dhe indirekte, sipas parashikimeve të seksionit II, të titullit të V, të këtij ligji.

Neni 232

Përdorimi dhe aksesimi në koleksione

Muzetë përdorin koleksionet dhe i bëjnë ato të aksesueshme për publikun nëpërmjet realizimit të:

- a) Ekspozitave të përhershme;
- b) Ekspozitave afatgjata, afatshkurtra dhe lëvizëse;
- c) Publikimeve dhe aktiviteteve editoriale;
- ç) Aktiviteteve kulturore e arsimore në muze dhe me objektet muzeore;
- d) Aktiviteteve me tema shkencore e kërkimore, të lidhura me fondin muzeor.

TITULLI IV

SHËRBIMET NË MUZE

Neni 233

Aksesi për publikun në muze

1. Aksesi i publikut në muze është falas ose me pagesë. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera publike, fondacionet e posaçme apo ato të krijuara me këtë ligj, mund të hyjnë në marrëveshje për të rregulluar të drejtën e aksesit të publikut në muzetë e akredituar.

2. Me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore ose vendimarrjes së institucioneve publike dhe fondacioneve që kanë në administrim pasuri kulturore, përcaktohen:

- a) Rastet e hyrjes me ose pa pagesë;
- b) Kategoritë e biletave dhe kriteret e përcaktimit të çmimit. Në rastin e marrëveshjeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, çmimi i biletës përfshihet në të drejtat dhe detyrimet që palët kanë rënë dakord në këto marrëveshje;
- c) Mënyrën e emetimit, shpërndarjes, shitjes së biletave të hyrjes.

3. Muzetë i ofrojnë mundësinë publikut për t'u vizituar kundrejt një çmimi, i cili përcaktohet në biletën e muzeut. Format i dhe çmimi i biletës për muzetë:

- a) Me status kombëtar, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) Vendorë, miratohen nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore, nga e cila varet muzeu;
- c) E institucioneve publike, përcaktohen nga organi drejtues i institucionit, në varësi të të cilit është muzeu;
- ç) Privatë, përcaktohen nga organi drejtues i muzeut privat.

Neni 234

Tipologjitë e shërbimeve

1. Muzetë kryejnë veprimtari dhe ofrojnë shërbime, të cilat janë të rëndësishme për muzeun dhe ushtrimin e të drejtave të përdoruesve, të parashikuara në aktin e krijimit, si dhe në vendimin e KKM-së për riorganizimin e muzeve.

2. Muzetë ofrojnë shërbimet e parashikuara në aktin e krijimit, të lidhura me natyrën e aktivitetit muzeor, si dhe ofrojnë shërbime asistence kulturore, edukative e pritëse për publikun, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Vlera e tarifave të shërbimeve dhe përdorimi i të ardhurave që krijohen nga ofrimi i shërbimeve të muzeve publikë përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat, si dhe parashikimeve të nenit 20 të këtij ligji.

Neni 235

Hulumtimi në muze

1. Hulumtimi, si një shërbim në muze, është sistematik, profesional e shkencor dhe kryhet me qëllim mbledhjen, vlerësimin dhe ekspozimin e objekteve muzeore.

2. Hulumtimi kryhet në mënyrë të tillë që, gjatë mbledhjes së të dhënave, të gjithë pjesëmarrësit veprojnë në përputhje me standardet e profesionit të tyre, për të parandaluar çfarëdo veprimi joetik e të paligjshëm.

3. Hulumtimi dhe mbledhja e objekteve muzeore kryhet në përputhje me rregullimet ligjore të pasurive kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 236

Dokumentimi muzeor

1. Muzetë mbajnë të dhëna mbi objektet muzeore, të cilat janë të aksesueshme për publikun.

2. Muzetë mbajnë regjistër inventari, të dhënat për hyrjet e daljet e objekteve muzeore, katalogët e koleksioneve muzeore, bazën e të dhënave elektronike, si dhe të dhëna të tjera, të përshkruara me këtë ligj.

3. Udhëzimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore përcakton formatin dhe metodën e mbajtjes së dokumentacionit muzeor.

Neni 237

Shërbimi i mbajtjes në ruajtje të përkohshme dhe magazinimi i objekteve muzeore

1. Muzetë publikë ofrojnë shërbimin e mbajtjes në ruajtje të përkohshme të objekteve muzeore të një muzeu tjetër, për të cilat ruajtja në muzeun e tyre nuk është e përshtatshme, ose objekteve të lidhura me një koleksion në posedim apo pasuri të luajtshme, në pronësi të një personi fizik apo juridik, privat ose publik, me kusht që ky shërbim të jetë në përputhje me natyrën, veprimtarinë dhe funksionimin e muzeut pritës dhe nëse muzeu pritës garanton respektimin e kushteve për ruajtjen dhe mbrojtjen e objektit, pasuri kulturore.

2. Udhëzimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore përcakton aktet e nevojshme, kushtet, afatin, garancinë dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave për ofrimin e shërbimit të mbajtjes në ruajtje/magazinim të përkohshëm të objekteve muzeore.

3. Tarifat nga këto veprimtari përdoren sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 238

Ekspozimi i objekteve muzeore

1. Muzetë organizojnë ekspozita të përhershme e të përkohshme të objekteve muzeore të muzeut, në zbatim të parashikimeve të nenit 95, të këtij ligji, në veçanti dhe pjesës II, të këtij ligji, në përgjithësi.

2. Katalogu i ekspozitës së përhershme publikohet jo më vonë se një vit pas hapjes së ekspozitës së përhershme, ndërsa, për ekspozitat e përkohshme, katalogu i ekspozitës publikohet përpara hapjes së saj.

3. Institucionet e qeverisjes qendrore, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, mund të japin garanci për kompensimin e dëmit për objektet muzeore dhe ekspozitat e

organizuara jashtë territorit të Shqipërisë nga muzetë publikë, nëse:

a) Hyrja e objekteve muzeore, që do të ekspozohen jashtë vendit, në ekspozita të veçanta shkencore, kulturore, natyrore, me vlera artistike ose historike, në shtetin tjetër është e kushtëzuar me një ofrim sigurimi;

b) Shpenzimet e sigurimit me kompanitë e sigurimit janë jashtëzakonisht të larta, për shkak të vlerës së deklaruar të objektit muzeor.

4. Garancia, e përmendur në pikën 3, të këtij neni, mund të jepet vetëm nëse organizatorët e ekspozitës sigurojnë:

a) Vazhdimin e mbrojtjes fizike të objekteve muzeore nga momenti i marrjes deri në momentin e dorëzimit të tyre;

b) Mbajtjen në klimë të përshtatshme dhe plotësimin e kushteve të tjera, në varësi të llojit të objektit muzeor;

c) Që ndërtesa dhe sallat e ekspozimit nuk rrezikojnë sigurinë e objekteve muzeore.

5. Garancia nuk mund të jepet për objekte muzeore dhe ekspozita të organizuara për qëllime biznesi.

6. Zyra e eksportit pranë IKRTK-së monitoron plotësimin e kërkesave të përmendura në këtë nen.

Neni 239

Riprodhimi i objekteve muzeore dhe kopja e autorizuar

1. Objektet muzeore mund të riprodhohen/ modelohen për qëllim shitjeje në përputhje me parashikimet e këtij ligji, në përgjithësi, dhe me pjesën II, të tij, në veçanti.

2. Një kopje e autorizuar e një objekti muzeor është një objekt i ri i modeluar, që rindërton një objekt muzeor me karakteristikat e tij themelore.

3. Një kopje e autorizuar realizohet kur:

a) Është e nevojshme, për arsye sigurie;

b) Një objekt muzeor përkeqësohet vazhdimisht, për shkak të ekspozimit të tij;

c) Ka një nevojë të shfaqet objekti muzeor në një hapësirë jashtë hapësirës së ekspozitës së tij në muze;

ç) Objekti muzeor është i zhdukur, por dokumentacioni i tij shoqëruar në muze ende ekziston.

4. Një kopje e autorizuar e objektit muzeor realizohet vetëm për nevoja të muzeut, mbahet në posedim të subjektit që posedon objektin muzeor dhe ajo nuk mund të përdoret për qëllime fitimprurëse.

5. Muzeu është i detyruar:

a) Të vendosë një etiketë në çdo kopje të autorizuar të një objekti muzeor, e cila lexon “kopje muze”;

b) Të mbajë e të regjistrojë në regjistrin e tij listën e kopjeve të autorizuara të objekteve muzeore, si dhe të kërkojë nga IKRTK-ja lëshimin e një vërtetimi për çdo kopje të autorizuar të objekteve muzeore.

6. Metoda e mbajtjes së regjistrit të kopjeve të objekteve muzeore, si dhe forma e vërtetimit për një kopje të autorizuar të një objekti muzeor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 240

Kopje për shitje

1. Kopje për shitje është një objekt i modeluar sipas një objekti muzeor të veçantë, në një shkallë të ndryshme nga ajo e objektit muzeor, i cili riprodhohet me qëllim shitjeje apo një mënyre tjetër përdorimi, në kushtet e parashikuara nga neni 169 i këtij ligji.

2. Kopja e përmendur në pikën 1, të këtij neni, mund të riprodhohet nga persona fizikë ose juridikë të

licencuar, në kushte dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga udhëzimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, detyrohen të vendosin një etiketë në secilën kopje për shitje, e cila përmban:

- a) Nënshkrimin “kopje”;
- b) Titullin e objektit muzeor;
- c) Periudhën dhe vendndodhjen e objektit;
- ç) Origjinën e objektit;
- d) Emrin e autorit të saj;
- dh) emrin e muzeut, i cili posedon objektin muzeor.

4. Udhëzimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore përcakton tarifën për riprodhimin e objekteve muzeore në kushtet e këtij neni.

PJESA E KATËRT PASURITË E PEIZAZHIT KULTUROR

TITULLI I RUAJTJA DHE VLERËSIMI

Kreu I Dispozita të përgjithshme

Neni 241

Peizazhi kulturor

1. Mbrojtja e peizazhit kulturor, për qëllimet e këtij ligji, synon të njohë, të ruajë dhe, atje ku është e mundur, të sigurojë mbrojtjen e vlerave kulturore që përbëjnë shprehje të peizazhit. Në rast ndërhyrjeje në peizazh, subjektet zbatuese sigurojnë ruajtjen e aspekteve dhe të karakteristikave të veçanta të tij.

2. Vlerësimi i peizazhit kulturor kontribuon në nxitjen e zhvillimit të kulturës. Për këtë qëllim, administrata publike nxit dhe mbështet, brenda kompetencave që i njeh ligji, veprimtari të posaçme për njohjen, informimin, trajnimin, rikualifikimin dhe shfrytëzimin e peizazhit. Veprimtaria e vlerësimit të peizazhit kulturor realizohet duke respektuar nevojat e mbrojtjes.

Neni 242

Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Republika e Shqipërisë vepron në përputhje me detyrimet dhe parimet e bashkëpunimit ndërmjet shteteve, të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e ruajtjes dhe vlerësimit të peizazhit kulturor.

2. Shpërndarja e kompetencave në fushën e peizazhit përcaktohet në përputhje me parimet kushtetuese dhe organizimin administrativ të vendit.

Neni 243

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike për ruajtjen dhe vlerësimin e peizazhit kulturor

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e qeverisjes qendrore e vendore përcaktojnë dhe koordinojnë politikën për ruajtjen dhe vlerësimin e peizazhit kulturor, duke marrë në konsideratë edhe studimet, analizat dhe propozimet e organeve të specializuara, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban dhe territorin.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë, gjithashtu, për përcaktimin e politikave e të kritereve që lidhen me veprimtarinë e planifikimit të territorit,

si dhe për menaxhimin e ndërhyrjeve që janë pasojë e tyre, me qëllim garantimin e ruajtjes, rikuperimit dhe vlerësimit të tipareve e të karakteristikave të peizazhit, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 241 të këtij ligji. Politikat dhe kriteret e përcaktuara më sipër synojnë, gjithashtu, edhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë veprimtaritë e planifikimit, në përputhje me politikat dhe kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe marrin masa për përshtatjen e dokumenteve ekzistuese të planifikimit me këto politika.

Kreu II

Planifikimi i peizazhit

Neni 244

Planifikimi i peizazhit kulturor

1. Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa që gjithë territori të njihet, planifikohet dhe administrohet në mënyrë të përshtatshme, në bazë të vlerave të ndryshme që shprehen nga kontekstet e ndryshme përbërëse. Për këtë qëllim, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, sipas fushës së përgjegjësive, dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, harton planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara.

2. Përgatitja e planeve kombëtare të peizazhit kufizohet në pasuritë e peizazhit, të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 245, të këtij ligji, në format e parashikuara nga ky nen. Planet kombëtare të peizazhit njohin aspektet dhe karakteristikat e veçanta të territorit ku zbatohen e të peizazhit dhe përcaktojnë fushat e veprimit, duke vendosur rregulla specifike, për qëllimet e përcaktuara në nenet 241 dhe 243 të këtij ligji.

3. Për secilën fushë planet e peizazhit përcaktojnë rregulla të posaçme dhe parashikime që kanë për qëllim, në mënyrë të veçantë:

a) Ruajtjen e elementeve përbërëse dhe të morfologjisë së pasurive të peizazhit të vendosura nën mbrojtje, duke marrë parasysh edhe tipologjitë arkitektonike, teknikat dhe materialet e ndërtimit, si dhe nevojat e restaurimit të vlerave të peizazhit;

b) Rikualifikimin e zonave të dëmtuara apo të degraduara;

c) Ruajtjen e karakteristikave të peizazhit të fushave të tjera territoriale, duke siguruar, njëkohësisht, përdorimin sa më të kufizuar të territorit;

ç) Identifikimin e linjave të zhvillimit urbanistik e ndërtimor, në funksion të përshtatshmërisë së tyre me vlerat e ndryshme të njohura dhe të mbrojtura të peizazhit, duke i dedikuar kujdes të veçantë ruajtjes së peizazhit bujqësor dhe siteve të vendosura në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Neni 245

Plani Kombëtar i Peizazhit

1. Planit Kombëtar i Peizazhit përmban:

a) Vlerësimin e territorit objekt planifikimi, nëpërmjet analizave të karakteristikave të peizazhit, të fiksuara nga natyra, historia dhe bashkëveprimi i tyre, në kuptim të neneve 241 deri 244 të këtij ligji;

b) Vlerësimin e pasurive të peizazhit kulturor, të deklaruara me interes të veçantë publik, në bazë të nenit 250, të këtij ligji, kufizimin dhe përfaqësimin e tyre në një shkallë të përshtatshme për t'u identifikuar, si dhe përcaktimin e rregullave të përdorimit, sipas parashikimeve të neneve 249 e 250 të këtij ligji;

c) Vlerësimin e territoreve të parashikuara në nenin 247, të këtij ligji, kufizimin e tyre në një shkallë të përshtatshme për identifikimin dhe përcaktimin e specifikeve të përdorimit, me qëllim sigurimin e

ruajtjes së karakteristikave dalluese të këtyre zonave, si dhe, në përputhje me këto karakteristika, edhe vlerësimin;

ç) Identifikimin e mundshëm të pasurive të paluajtshme ose zonave me interes të veçantë publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 246, të këtij ligji, kufizimin e tyre në një shkallë të përshtatshme për identifikimin, si dhe përcaktimin e specifikimeve të përdorimit, në kuptim të parashikimeve të nenit 250 të këtij ligji;

d) Identifikimin e konteksteve të tjera të mundshme, të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 246, të këtij ligji, të cilat do t'i nënshtrohen masave specifike të ruajtjes dhe përdorimit;

dh) Analizën e dinamikave të transformimit të territoreve, me qëllim identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe të elementeve më të ndjeshme të peizazhit, si dhe krahasimin me dokumente të tjera programimi, planifikimi dhe mbrojtjeje të tokës;

e) Identifikimin e ndërhyrjeve për kthimin në identitet e rikualifikimin e territoreve të dëmtuara rëndë apo të degraduara, si dhe të ndërhyrjeve të tjera jetëzuese, të përshtatshme me nevojat e mbrojtjes;

ë) Identifikimin e masave të nevojshme për përfshirjen korrekte në kontekstin peizazhor të ndërhyrjeve për transformimin e territorit, me qëllim realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të zonave të përfshira;

f) Identifikimin e fushave të ndryshme dhe të objektivave cilësorë, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 244, të këtij ligji.

2. Plani mund të parashikojë identifikimin e zonave:

a) Të peizazhit që janë objekt mbrojtjeje, sipas nenit 247, të këtij ligji, dhe pasuritë e peizazhit kulturor, të deklaruara në përputhje me parashikimet e këtij kreu, në të cilat kryerja e ndërhyrjeve mund të realizohet vetëm pas kontrollit të përputhshmërisë së ndërhyrjeve me parashikimet e planit të peizazhit dhe planit vendor;

b) Të komprometuara rëndë ose të degraduara, në të cilat zbatimi i ndërhyrjeve me qëllim rimëkëmbjen dhe rikualifikimin nuk kërkon lejen, sipas nenit 252 të këtij ligji.

3. Plani i peizazhit mund të identifikojë edhe linjat udhëzuese për projektet e ruajtjes, rikuperimit, rikualifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të zonave në nivel vendor, duke treguar mjetet e zbatimit dhe duke përfshirë stimujt e mundshëm.

4. Plani Kombëtar i Peizazhit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Nga data e miratimit të planit të peizazhit nuk lejohet asnjë ndërhyrje në pasuritë e paluajtshme dhe zonat e parashikuara në nenin 247, të këtij ligji, që bie ndesh me masat mbrojtëse, të parashikuara në planin e peizazhit. Nga data e miratimit të Planit Kombëtar të Peizazhit, rregullat e përcaktuara në të janë menjëherë të zbatueshme dhe të detyrueshme për dokumentet vendore të planifikimit.

Kreu III

Identifikimi i pasurive të peizazhit kulturor

Neni 246

Pasuritë e peizazhit kulturor

1. Janë pasuri të peizazhit kulturor:

a) Pasuritë e paluajtshme dhe zonat, sipas nenit 248, të verifikuara e të deklaruara në bazë të neneve 249 dhe 250 të këtij ligji;

b) Zonat e parashikuara në nenin 247 të këtij ligji;

c) Pasuritë e tjera të paluajtshme dhe zonat e identifikuara në mënyrë specifike, sipas nenit 248, të këtij ligji, dhe që janë objekt mbrojtjeje në bazë të Planit Kombëtar të Peizazhit.

2. Pasuritë e peizazhit kulturor përbëjnë zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare, për qëllimet e legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Neni 247

Zonat e peizazhit të mbrojtura me ligj

Përbëjnë, në çdo rast, zona të peizazhit dhe i nënshtrohen dispozitave të këtij kreu pasuritë e mëposhtme, me interes të veçantë peizazhistik:

- a) Territoret bregdetare, që përfshihen në një brez prej 300 metrash nga bregu i detit, edhe për terrenet që ngrihen mbi det;
- b) Territoret kufizuese të liqeneve, në një brez prej 300 metrash nga bregu, edhe për terrenet që ngrihen mbi liqen;
- c) Lumenjtë, përrenjtë, burimet e tjera ujore;
- ç) Malet mbi 1 600 metra mbi nivelin e detit;
- d) Parqet dhe rezervat kombëtare e vendore, si dhe zonat e mbrojtura jashtë parqeve;
- dh) Territoret e mbuluara me pyje;
- e) Zonat me interes arkeologjik.

Neni 248

Pasuri të paluajtshme dhe zona me interes të veçantë publik

Janë pasuri peizazhi kulturore dhe objekt i dispozitave të këtij kreu, për shkak të interesit të veçantë publik që paraqesin:

- a) Pasuritë e paluajtshme, që kanë karakter të konsiderueshëm bukurie natyrore, veçanti gjeologjike ose kujtesë historike, përfshirë këtu pemët monumentale;
- b) Vilat, kopshtet dhe parqet, që nuk janë objekt mbrojtjeje, sipas dispozitave të pjesës II, të këtij ligji, që dallohen për bukurinë e tyre të pazakontë;
- c) Komplekset e pasurive të paluajtshme, që përbëjnë një aspekt karakteristik me vlera estetike dhe tradicionale, përfshirë qendrat historike;
- ç) Bukuritë panoramike, si dhe ato pika vëzhgimi ose tarraca natyrore, të hapura për publikun, prej të cilave shihohet spektakli i atyre bukurive.

Neni 249

Procedura e verifikimit të interesit të veçantë të pasurive të peizazhit kulturor

1. IKTK-ja, kryesisht, ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore e vendore, fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik, sipas parashikimeve të nenit 248, të këtij ligji, për pasuritë e paluajtshme dhe zonat për të cilat është marrë iniciativa.

2. Propozimi i shpalljes së interesit të veçantë publik, i përmendur në pikën 1, të këtij neni, shoqëruar me planimetrinë e hartuar në një shkallë që mundëson identifikimin e saktë të pasurive të paluajtshme dhe të zonave përkatëse, publikohet për 60 ditë në zyrat e njësisë së qeverisjes vendore e qendrore, të institucioneve të specializuara të kompetencës, si dhe i njoftohet publikut nëpërmjet mjeteve të konsultimit publik.

3. Për pasuritë kulturore, të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 248, të këtij ligji, fillimi i procedurave të shpalljes i njoftohet, gjithashtu, edhe pronarit, poseduesit dhe mbajtësit të pasurisë. Njoftimi përmban elementet hipotekore identifikuese të pasurisë kulturore dhe propozimin e kërkuesit.

4. Brenda 30 ditëve, nga periudha e publikimit, e parashikuar në pikat 2 e 3, të këtij neni, organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e interesuara, përfshirë subjektet e tjera të interesuara, mund të parashtrajnë vërejtjet e tyre. Pronarët, poseduesit dhe mbajtësit e pasurisë mund të paraqesin vëzhgimet dhe dokumentacionin, mbi të cilin mbështesin vëzhgimet e tyre, jo më vonë se 30 ditë nga momenti i

njoftimit, parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Vendimi i KKTKM-së, i cili merret brenda 90 ditëve nga paraqitja e propozimit, merr në konsideratë vlerat historike, kulturore, natyrore, morfologjike dhe estetike, që shprehen nga aspektet dhe karakteristikat e veçanta të pasurive të paluajtshme ose të zonave të marra në konsideratë, vlerën identitare të tyre në raport me territorin ku ndodhen, si dhe përmban propozime për rregulla përdorimi që garantojnë ruajtjen e vlerave të shprehura.

6. Efektet juridike, të parashikuara në pikën 1, të nenit 251, të këtij ligji, fillojnë nga dita e parë e publikimit, parashikuar në pikën 2, të këtij neni, dhe e komunikimit të pronarit, përmendur në pikën 3 të këtij neni. Vendimi negativ i KKTKM-së i nënshtrohet së njëjtës procedurë publikimi dhe njoftimi.

Neni 250

Procedura e deklarimit të pasurive të peizazhit kulturor

1. Deklarimi i pasurive të peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe zonat me interes të veçantë publik kryhet me urdhër të ministrit, bazuar në vendimin pozitiv të KKTKM-së për verifikimin e interesit të veçantë të këtyre pasurive e zonave të veçanta, dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

2. Deklarimi i interesit të veçantë publik për pasurinë e peizazhit kulturor parashikon disiplinën e veçantë që do të zbatohet, me qëllim sigurimin dhe ruajtjen e vlerave të shprehura nga aspektet dhe karakteristikat e veçanta të territorit në fjalë.

3. Pasuritë e deklaruara “pasuri peizazhi kulturor” janë pjesë përbërëse e Planit Kombëtar të Peizazhit, si dhe e dokumenteve të planifikimit vendor dhe nuk mund të ndryshohen apo eliminohen gjatë procesit për hartimin apo rishikimin e planit.

4. Deklarimi i pasurisë së peizazhit kulturor, kur ka për objekt pasuri të paluajtshme, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 248, të këtij ligji, i njoftohet pronarit, poseduesit apo mbajtësit, depozitohet në çdo bashki të interesuar, si dhe regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme që administrohen nga ZRPP-ja.

Kreu IV

Kontrolli dhe administrimi i objekteve që i nënshtrohen mbrojtjes

Neni 251

Leja e peizazhit kulturor

1. Pronarët, poseduesit dhe mbajtësit e pasurive të peizazhit kulturor, të deklaruar sipas parashikimeve të nenit 250, të këtij ligji, dhe të pasurive në zonat e parashikuara në Planin Kombëtar të Peizazhit nuk mund të shkatërrojnë dhe as të kryejnë ndryshime që mund të dëmtojnë pasuritë, objekt mbrojtjeje.

2. Subjektet, sipas pikës 1, të këtij neni, kanë detyrimin të paraqesin pranë autoriteteve publike kompetente projektin e ndërhyrjeve që synojnë të kryejnë, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, dhe të evitojnë të kryejnë punime për aq kohë sa nuk kanë marrë autorizimin e nevojshëm.

3. Dokumentacioni që i bashkëlidhet projektit synon të bëjë të mundur kontrollin e përputhshmërisë së interesit të peizazhit të mbrojtur me ndërhyrjen që propozohet të kryhet.

4. Leja e peizazhit kulturor është kusht për pajisjen me leje ndërtimi. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye, autorizimi nuk mund të lëshohet pas fillimit, qoftë edhe të pjesshëm, të ndërhyrjeve ndërtimore, apo me qëllim rregullimin e pjesshëm të pasojave që vijnë prej tyre. Autorizimi është i vlefshëm për një afat 1-vjeçar, me kalimin e të cilit kryerja e punimeve sipas projektit duhet t'i nënshtrohet një lejeje të re.

5. Leja lëshohet nga IKTK-ja, brenda 120 ditëve kalendrike nga data e kërkesës pas miratimit, pasi projekti më parë të jetë miratuar me vendim të KKTKM-së, i cili verifikon përputhjen e ndërhyrjes

konkrete me parashikimet e planeve të rregullimit të peizazhit; siguron respektim të vlerave të shpallura të peizazhit; përputhje të kriterëve të administrimit të godinës apo zonës; koherencë me objektivat e cilësisë së peizazhit.

6. Leja mund të kundërshtohet në gjykatën administrative nga organizatat që kanë interesa dhe veprojnë në fushën e mjedisit apo peizazhit, si nga çdo subjekt tjetër publik ose privat që ka interes, sipas përcaktimeve dhe afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Pranë IKTK-së krijohet dhe mbahet një listë e përditësuar, e cila mund të konsultohet me shënimet mbi datën e lejeve të ndërhyrjeve në pasuritë e peizazhit. Një kopje e kësaj liste i dërgohet për informacion DRTK-së, IKRTK-së dhe Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

8. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në lidhje me kërkesat për aktivitete minerare në pasuritë dhe zonat e peizazhit kulturor.

Neni 252

Ndërhyrjet pa leje

Me përjashtim të parashikimeve të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 242, të këtij ligji, nuk kërkohet leje për:

a) Ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme, të jashtëzakonshme, të konsolidimit statik dhe të restaurimit ruajtës të peizazhit, që nuk ndryshon gjendjen në të cilën ai ndodhet dhe pamjen e jashtme të ndërtesave;

b) Ndërhyrjet që kryhen për ushtrimin e aktivitetit agraro-pyjor-blegtoral dhe që nuk sjellin ndryshimin e qëndrueshëm të gjendjes së peizazhit me ndërtime dhe vepra të tjera civile, me kusht që të bëhet fjalë për vepra që nuk ndryshojnë strukturën hidrogeologjike të territorit;

c) Prerjen e bimësisë, pyllëzimin, ripyllëzimin, veprat e bonifikimit, veprat kundra zjarrit dhe që bëhen në pyje, kur janë të parashikuara dhe të autorizuara në bazë të dispozitave të fushës.

Neni 253

Ndërhyrje që u nënshtrohen kushteve të veçanta

Në rastet e shtrimit të rrugëve ose hapjes së gropave, hapjes së kanaleve për vendosje të rrjeteve industriale ose civile, në shërbim të zonave të specifikuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të nenit 247, të këtij ligji, ose në afërsi të objekteve të parashikuara në shkronjat “a”, dhe “b”, të të njëjtit nen, IKTK-ja, në kushtet e procedurës së parashikuar në pikën 5, të nenit 251 të këtij ligji, duke parë funksionin ekonomik të veprave për t’u realizuar ose atyre të realizuara, i rekomandon KKTKM-së vendosjen e distancave, masat/ hapësirat dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi, të nevojshme për të siguruar ruajtjen e vlerave të shprehura nga pasuritë në parashikimet e këtij kreu.

Neni 254

Materialet promovuese

1. Në afërsi të pasurive të peizazhit, të përcaktuara në nenin 246, të këtij ligji, ndalohet vendosja e billbordeve apo mjeteve të tjera publicitare, nëse nuk është marrë, paraprakisht, autorizimi i organeve kompetente.

2. Përgjatë rrugëve të zonave ose pranë pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, ndalohet vendosja e billbordeve apo mjeteve të tjera reklamuese, me përjashtim të rasteve të autorizuara nga legjislacioni në fushën e sigurisë rrugore dhe të asaj të publicitetit në rrugë dhe mjete, pas aprovimit të IKTK-së dhe mendimit pozitiv të DRTK-së për përputhshmërinë e vendosjes dhe të tipologjisë së tipit të reklamimit me vlerat e peizazhit të ndërtimeve apo zonave, subjekt i mbrojtjes.

Neni 255

Ngjyra e fasadave të ndërtesave

1. Në rastet kur lyerja e fasadave të ndërtesave, që ndodhen në pasuritë e deklaruara pasuri peizazhi kulturor, i nënshtrohet detyrimit për të marrë leje, në bazë të parashikimeve të nenit 251, IKTK-ja, pas marrjes së mendimit pozitiv nga KKTKM-ja, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 253, të këtij ligji, mund të vendosë që fasadat të lyen me një ngjyrë, e cila është në harmoni me tërësinë e ndërtesave dhe mjedisit/peizazhit.

2. Në rast se pronarët, poseduesit ose mbajtësit e objekteve të paluajtshme, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, zbatojnë detyrimin brenda një afati të arsyeshëm, IKTK-ja ose DRTK-ja, nëse është e deleguar prej tij, merr masa për kryerjen e punimeve, kryesisht ose nëpërmjet subjekteve të licencuara. Shpenzimet e ndërhyrjes mbulohen nga pronari/poseduesi.

3. Për objektet e paluajtshme, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 50, të këtij ligji, të deklaruara me interes kulturor, në kuptim të nenit 61, dhe të objekteve të paluajtshme, të parashikuara në pikën 1, të nenit 50, zbatohen dispozitat e pjesës II, të këtij ligji.

Neni 256

Monitorimi

1. Funkcionet e monitorimit të pasurive të peizazhit, të mbrojtura nga kjo pjesë, ushtrohen bashkërisht, nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të sigurojnë funksionimin e dispozitave të këtij ligji nga ana e institucioneve që ushtrojnë kompetencat në fushën e peizazhit. Në rast mosushtrimi të këtyre kompetencave, pavarësisht njoftimit, këto kompetenca mund të ushtrohen drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

PJESA E PESTË

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 257

Kundërvajtjet administrative të lidhura me inspektimin

Moszbatimi i masave të inspektimit, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 74, të këtij ligji, në rastet kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 4 000 000 lekë.

Neni 258

Kundërvajtjet administrative të lidhura me mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 200 000 deri në 4 000 000 lekë:

- a) Kryerja e ndërhyrjeve në kundërshtim me parashikimet e nenit 76 të këtij ligji;
- b) Kryerja e ndërhyrjeve në kundërshtim me parashikimet e nenit 77 të këtij ligji;
- c) Kryerja e ndërhyrjeve në kundërshtim me parashikimet e nenit 79 të këtij ligji;
- ç) Vazhdimi i punimeve në kundërshtim me masat parandaluese, sipas nenit 81 të këtij ligji;
- d) Mospërmbyshja e detyrimit për të ofruar garantimin e sigurisë, të ruajtjes dhe inventarizimit të pasurive kulturore në përputhje me parashikimet e nenit 85 të këtij ligji.

2. Pezullimi i aktivitetit, për më shumë se 90 ditë, nga subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në pasuritë kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 20, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 40 000 lekë.

3. Moszbatimi i masave të mbrojtjes indirekte, sipas pikës 6, të nenit 96, të këtij ligji, kur nuk përbën veçer penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 800 000 lekë.

4. Ekspozimi i pasurive kulturore pa u pajisur me leje, në zbatim të parashikimeve të pikës 7, të nenit 99, të këtij ligji, kur nuk përbën veçer penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 80 000 lekë.

5. Organizimi i veprimtarive kulturore në ambientet e pasurive kulturore apo të zonave të mbrojtura si pasuri kulturore pa miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas parashikimeve të nenit 100, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 600 000 lekë.

6. Vendosja e materialeve informuese ose reklamuese, apo fotografimi ose filmimi për qëllime fitimprurëse i pasurive kulturore pa miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas nenit 101, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë.

Neni 259

Kundërvajtjet administrative të lidhura me qarkullimin e pasurive kulturore

1. Tjetërsimi i pasurive kulturore në kundërshtim me ndalimet e neneve 106, 107 e 108, të këtij ligji, kur nuk përbën veçer penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, nga 200 000 deri në 3 000 000 lekë.

2. Përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, nga 20 000 deri në 50 000 lekë, moszbatimi i detyrimit për njoftim pranë IKRTK-së të tjetërsimit të pasurisë kulturore, sipas parashikimeve të nenit 112 të këtij ligji.

3. Ushtrimi i veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore pa u pajisur me licencën përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 116, të këtij ligji, kur nuk përbën veçer penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 4 000 000 lekë. Dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar për këtë shkelje subjekti që është dënuar një herë me kryerjen e së njëjtës kundërvajtje në një periudhë 10-vjeçare.

4. Ushtrimi i veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore, që nuk përmbush detyrimin për raportim mujor, parashikuar nga neni 116, i këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 40 000 lekë.

5. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë veçer penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 200 000 deri në 4 000 000 lekë:

a) Nxjerrja pa kthim, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të pasurive kulturore, në kundërshtim me ndalimin e parashikuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 123, të këtij ligji;

b) Nxjerrja pa kthim, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të pasurive kulturore pa u pajisur me licencë të qarkullimit të lirë, në kundërshtim me nenin 125, të këtij ligji;

c) Nxjerrja, përkohësisht, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të pasurive kulturore pa u pajisur me licencë të qarkullimit të përkohshëm, në kundërshtim me nenin 128 të këtij ligji;

ç) Futja në territorin e të Republikës së Shqipërisë të pasurive kulturore pa u pajisur me licencë paraprake, sipas nenit 129 të këtij ligji;

d) Mosmarrja e masave të duhura për ruajtjen ose transferimin e pasurive kombëtare, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në licencën e qarkullimit të përkohshëm, në përputhje me nenin 128 të këtij ligji;

dh) Mungesa e posedimit të dokumentit të origjinës, në përputhje me këtë ligj.

6. Shkeljet e pikës 5 dënohen me dyfishin e gjobës së parashikuar për shkeljen përkatëse nëse subjektet kanë qenë të dënuara më parë për të njëjtën kundërvajtje.

Neni 260

**Kundërvajtjet administrative të lidhura
me hulumtimet arkeologjike dhe gjetjet**

Kur nuk përbën veprë penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 4 000 000 lekë:

a) Gërmimi i paautorizuar, me karakter arkeologjik, dhe përdorimi i aparaturave metalkër-kuese nga subjekte të paautorizuara, në kundërshtim me ndalimin e nenit 133 të këtij ligji. Dënimi mund të përfshijë edhe sekuestrimin e çdo metal-detektori apo mjeteve të tjera teknike, si dhe të gjitha pajisjet e përdorura për kërkim të mbetjeve arkeologjike;

b) Kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjekte të palicencuara, në kundërshtim me parashikimet e nenit 136 të këtij ligji;

c) Kryerja e veprimtarisë arkeologjike nga subjekte të licencuara ose çdo subjekt tjetër në kundërshtim me parashikimet e nenit 139 të këtij ligji;

ç) Mosdeklarimet ose mosruajtja e gjetjeve në përputhje me nenin 145 të këtij ligji;

d) Mosruajtja e gjetjeve rastësore nga ana e personit dhe drejtuesit teknik, që i kanë konstatuar gjetjet, deri në momentin e vendimit të KKTKM-së, në zbatim të parashikimeve të nenit 145 të këtij ligji.

dh) Mosraportimi në organet kompetente dhe mosruajtja e përkohshme e gjetjeve rastësore në territor, në kuptim të nenit 146 të këtij ligji.

Neni 261

Kundërvajtjet administrative të lidhura me veprimtarinë arkeologjike nënujore

Janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 deri në 4 000 000 lekë:

a) Kryerja e veprimtarive arkeologjike nënujore nga persona ose subjekte të palicencuar ose pa lejen përkatëse, sipas nenit 155 të këtij ligji;

b) Mosraportimi në organet kompetente dhe mospërbushja e detyrimit për ruajtjen e përkohshme të gjetjes, sipas parashikimeve të nenit 159 të këtij ligji;

c) Mospërbushja e detyrimit për deklarim të gjetjeve detare të zbuluara gjatë zbatimit të punimeve brenda afatit të parashikuar ligjor, në kushtet e pikës 1, të nenit 160, të këtij ligji, dhe mosruajtja e tyre e përkohshme në kushtet e pikës 3, të nenit 160, të këtij ligji.

Neni 262

**Kundërvajtjet administrative të lidhura me përdorimin, shfrytëzimin dhe rijetëzimin e pasurive
kulturore**

Kur nuk përbën veprë penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 60 000 lekë riprodhimi i pasurive të trashëgimisë kulturore në kundërshtim me parashikimet e nenit 180 të këtij ligji.

Të ardhurat e mbledhura nga kundërvajtjet administrative derdhen në Fondin Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale.

PJESA E GJASHTË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

TITULLI I
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE NË LIDHJE ME PJESËN E PARË

Kreu I
Dispozita të fundit

Neni 263

Nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që brenda:

a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura, në zbatim të pikës 3, të nenit 11, të këtij ligji;

b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimin e subjekteve juridike, me qëllim vlerësimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore, në zbatim të pikës 4, të nenit 12, të këtij ligji;

c) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e rregullave të administrimit të Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale, në zbatim të pikës 3, të nenit 19, të këtij ligji;

ç) 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, në zbatim të pikës 4, nenit 27, të këtij ligji;

d) 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimet për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së institucioneve të specializuara, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të pikës 1, të nenit 28, në zbatim të pikës 2, të nenit 28, të këtij ligji. Në zbatim të kësaj pike, struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimeve të cituara në këtë pike;

dh) 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim” (QRKR), në zbatim të pikës 9, të nenit 29, të këtij ligji;

e) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës së Restaurimit të Filmit”, në zbatim të pikës 4, nenit 34, të këtij ligji;

ë) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës së Restaurimit të Materialeve Bibliotekare”, në zbatim të pikës 5, nenit 35, të këtij ligji;

f) 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale në fushën e trashëgimisë kulturore, në zbatim të pikës 2, nenit 37, të këtij ligji;

g) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen dhe metodologjinë e përgatitjes së planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore, në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji.

Neni 264

Nxjerrja e akteve nënligjore të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore që brenda:

- a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve, në zbatim të këtij ligji;
- b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë strategjinë kombëtare mbi kulturën, në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji;
- c) 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kriteret dhe procedurat standarde, në zbatim të pikës 3, të nenit 10, të këtij ligji;
- ç) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore, në zbatim të pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji;
- d) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, në zbatim të pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji;
- dh) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së, sekretarive teknike dhe sportelit unik të KKTKM-së, në zbatim të pikës 4, të nenit 38, të këtij ligji;
- e) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregulloren për veprimtarinë e KKTKJ-së dhe sekretarisë teknike, në zbatim të pikës 4, të nenit 39, të këtij ligji;
- ë) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike, në zbatim të pikës 4, të nenit 40, të këtij ligji;
- f) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë urdhrin për rregullimin e veprimtarisë së KKM-së, të Bordit të Akreditimit të Muzeve dhe sekretarisë teknike, në zbatim të pikës 5, të nenit 41, të këtij ligji.

Neni 265

Nxjerrja e akteve nënligjore të përbashkëta të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe ministrive përgjegjëse të fushave të tjera

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKTK-ja, në zbatim të pikës 10, të nenit 29, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga DRTK-të, në zbatim të pikës 6, nenit 31, të këtij ligji.
3. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKRTK-ja, në zbatim të pikës 7, nenit 32, të këtij ligji.

TITULLI II

PARASHIKIME KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE NË LIDHJE ME PJESËN E DYTË

Kreu I

Dispozita kalimtare

Neni 266

Dispozita kalimtare

1. Në kuptim të pikës 7, të nenit 82, të këtij ligji, brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet fizike ose juridike, të licencuara përpara miratimit të këtij ligji, për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse

e projektuese në pasuritë kulturore materiale, kanë detyrimin të marrin kreditet, sipas një programi formimi intensiv vazhdues, miratuar me urdhër të titullarit të IKTK-së.

2. Në kuptim të nenit 116 e në vijim, të këtij ligji, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari tregtare të pasurisë kulturore detyrohen të licencohen për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Në kuptim të nenit 136 e në vijim, si dhe të nenit 157 e në vijim, brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet fizike ose juridike, të licencuar përpara miratimit të këtij ligji për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse dhe projektuese në pasuritë kulturore materiale, kanë detyrimin të marrin kreditet, sipas një programi formimi intensiv vazhdues, miratuar me urdhër të titullarit të IKTK-së. Parashikimet e pikës 3, të nenit 136, dhe pikës 4, të nenit 157, të këtij ligji, hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në legjislacionin në fuqi “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kreu II **Dispozita përfundimtare**

Neni 267

Nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që brenda:

a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, në zbatim të pikës 2, të nenit 59, të këtij ligji;

b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre, në zbatim të pikës 3, nenit 72, të këtij ligji;

c) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore, në zbatim të pikës 1, të nenit 82, të këtij ligji;

ç) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurat për dhënie, pezullimin ose revokimin e tyre, si dhe kuotizacioni vjetor i tyre për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të këtij ligji;

d) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për procedurat e përzgjedhjes për investimet me fonde publike, në zbatim të pikës 3, nenit 90, të këtij ligji;

dh) 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, në zbatim të pikës 1, nenit 96, të këtij ligji;

e) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për procedurat dhe kriteret e konkurrimit për tjetërsimin e pasurive kulturore jopublike në pronësi të shtetit, në zbatim të pikës 3, të nenit 109, të këtij ligji;

ë) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore, në zbatim të pikës 3, të nenit 116, të këtij ligji;

f) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë procedurat e krijimit dhe administrimit

të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, në zbatim të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji;

g) 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për procedurat për hulumtimet arkeologjike, në zbatim të pikës 6, të nenit 133, të këtij ligji;

gj) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për krijimin dhe funksionimin e sistemit të bazës së të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 135, të këtij ligji;

h) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike, në zbatim të pikës 4, të nenit 136, të këtij ligji;

i) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në zbatim të pikës 3, të nenit 139, të këtij ligji;

j) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kufijtë e territorit gjeografik, strukturën dhe organikën e NJAKPA-ve, në zbatim të pikës 1 dhe 9, të nenit 142, të këtij ligji;

k) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e zonave arkeologjike nënujore, në zbatim të nenit 153 të këtij ligji;

l) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për procedurën e shpalljes publike të pasurive kulturore që zbulohen në det, në zbatim të pikës 2, të nenit 154, të këtij ligji;

ll) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për kushtet dhe kriteret për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore, si dhe të aktiviteteve të tjera që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike e historike nënujore, në zbatim të nenit 156 të këtij ligji;

m) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të posaçme të licencimit për kryerjen e veprimtarive arkeologjike nënujore dhe monitorimin e tyre, në zbatim të pikës 5 dhe 6 të nenit 157 të këtij ligji;

n) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore, në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 171, të këtij ligji;

nj) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për procedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore, në zbatim të neneve 178, pika 3, dhe 184, pika 4, të këtij ligji;

o) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme të kontratës së rijetëzimit, në zbatim të pikës 2, nenit 186, të këtij ligji.

Neni 268

Nxjerrja e akteve nënligjore të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore që brenda:

a) 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme, në zbatim të pikës 6, nenit 53, të këtij ligji;

b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat dhe mënyrat e inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të pasurive kulturore, në zbatim të pikës 2, nenit 56, të këtij ligji;

c) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për funksionimin e “Sistemit digjital për bazën e të dhënave të pasurive kulturore”, në zbatim të pikës 8, të nenit 56, të këtij ligji;

ç) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjinë e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të aplikimit, në zbatim të pikës 1 të nenit 58, të këtij ligji;

d) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimin e tyre për verifikim, në zbatim të pikës 2, nenit 58, të këtij ligji;

dh) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për mënyrën e funksionimit të komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomateriale, në zbatim të pikës 1, të nenit 59, të këtij ligji;

e) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së, në zbatim të pikës 2, të nenit 59, të këtij ligji;

ë) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme, në zbatim të pikës 12, nenit 71, të këtij ligji;

f) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurën e kontrollit teknik të pasurive kulturore të luajtshme, në zbatim të pikës 13, të nenit 71, të këtij ligji;

g) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë urdhrin për formatin e kërkesës dhe dokumentacionin shoqërues për lëshimin e lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore, në zbatim të pikës 1, nenit 80, të këtij ligji;

gj) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues të personave të pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe me licencë për kryerjen e veprimtarive arkeologjike, në zbatim të pikës 6, nenit 82, dhe të pikës 2 të nenit 137 të këtij ligji;

h) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për mënyrën dhe formën e mbajtjes së informacionit nga subjektet publike ose private për pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrim, në zbatim të pikës 3, nenit 85, të këtij ligji;

i) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse, në zbatim të pikës 9, të nenit 92, të këtij ligji;

j) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat për dhënien e miratimit për ekspozimin e pasurive kulturore dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të tyre, si dhe për procedurat, mënyrat dhe kushtet e lëshimit të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut, në zbatim të pikave 3 e 5, të nenit 99, të këtij ligji;

k) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatjen dhe tarifatat për dhënien e miratimit dhe deklarin e interesit kulturor, në zbatim të pikës 3, të nenit 100, të këtij ligji;

l) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatjen dhe tarifatat për dhënien e miratimit, në zbatim të pikës 3, nenit 101, të këtij ligji;

ll) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve, në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, të këtij ligji;

m) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për administrimin e fondit të ruajtjes së vlerave kulturore jomateriale, masën dhe kriteret e shpërblimit artistik për veprimtari dhe aktivitete të fushës së vlerave jomateriale, në zbatim të pikës 2, nenit 104, të këtij ligji;

n) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për masat për njohjen, respektimin, përhapjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, në zbatim të pikës 2, nenit 105, të këtij ligji;

nj) 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për krijimin dhe funksionimin e “Regjistrit të tregtimit të pasurive kulturore”, në zbatim të pikës 7, të nenit 116, të këtij ligji;

- o) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë vendit, në zbatim të pikës 4, të nenit 123, të këtij ligji;
- p) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë përcaktimet e përgjithshme, në zbatim të neneve 124, pika 3, dhe 128, pika 3, të këtij ligji;
- q) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për kushtet, mënyrën, procedurën dhe formën për lëshimin ose rinovimin e licencës së importit, në zbatim të pikës 6, nenit 129, të këtij ligji;
- r) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura, në zbatim të pikës 6, të nenit 130, të këtij ligji;
- rr) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjike, në zbatim të nenit 140 të këtij ligji;
- s) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për mënyrën e vlerësimit të gjetjeve rastësore të objekteve arkeologjike, në zbatim të pikës 2, nenit 150, të këtij ligji;
- sh) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për format e mbështetjes së veprimtarive dhe strukturave për vlerësimin e pasurive kulturore në pronësi private, në zbatim të pikës 2, të nenit 165, të këtij ligji;
- t) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas rastit, të miratojë tarifatat për të ardhurat nga biletat dhe çdo shërbim tjetër për rastet e hyrjes me pagesë në institucionet dhe vendet e kulturës, në zbatim të pikës 7, të nenit 176, të këtij ligji;
- th) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për përcaktimin e rregullave për dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë të pasurive kulturore, në zbatim të pikës 2, nenit 179, të këtij ligji;
- u) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për rregullat e hollësishme për riprodhimin dhe përdorimin e tërthortë të pasurive kulturore, në zbatim të pikave 1 dhe 2, nenit 180, të këtij ligji.

Neni 269

Nxjerrja e akteve nënligjore të përbashkëta të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrave përgjegjës për fusha të tjera

Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat që brenda:

- a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për tarifatat e aplikimit për procedurën e verifikimit të interesit kulturor, në zbatim të pikës 4, të nenit 58, të këtij ligji;
- b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për vlerat mbi të cilat është i detyrueshëm një përshkrim më i detajuar i pasurive kulturore, objekte të veprimeve tregtare, në zbatim të pikës 8, të nenit 116, të këtij ligji;
- c) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për tarifatat e të gjitha formave të përdorimit të pasurive kulturore, në zbatim të pikës 4, të nenit 178, të këtij ligji.

Neni 270

Nxjerrja e akteve nënligjore të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve të tjera administruese të pasurive kulturore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore të miratojë, brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, në zbatim të pikës 1, të nenit 96, të këtij ligji.

2. Ngarkohen institucionet publike, që kanë në administrim pasurinë kulturore që, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të përcaktojnë, me udhëzim, vlerat minimale të tarifave e të shpenzimeve të tjera, të lidhura me riprodhimin e pasurive kulturore, në zbatim të pikës 6, të nenit 187, të këtij ligji.

TITULLI III

PARASHIKIMET KALIMTARE DHE TË FUNDIT NË LIDHJE ME PJESËN E TRETË

Kreu I

Dispozita kalimtare

Neni 271

1. Dispozitat për muzetë, parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “ë”, “f”, dhe “g”, të pikës 1, të nenit 202, të këtij ligji, hyjnë në fuqi në momentin që funksionojnë strukturat e tyre.

2. Në kuptim të shkronjës “dh”, të pikës 5, të nenit 259, të këtij ligji, detyrimi për posedimin e dokumentit të origjinës hyn në fuqi pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 130 të këtij ligji.

Kreu II

Dispozita të fundit

Neni 272

Nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore që brenda:

a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin, mënyrën e mbledhjeve dhe shpërblimin e anëtarëve të KKM-së, në zbatim të pikës 4, të nenit 197, të këtij ligji;

b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Arteve të Bukura, në zbatim të pikës 4, të nenit 205, të këtij ligji;

c) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për ushtrimin e funksioneve të fondacionit “Marubi”, në zbatim të pikës 4, të nenit 206, të këtij ligji;

ç) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Ikonave, në zbatim të pikës 3, të nenit 207, të këtij ligji;

d) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”, në zbatim të pikës 3, nenit 208, të këtij ligji;

dh) 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë, në zbatim të pikës 3, nenit 209, të këtij ligji;

e) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Bashkëjetesës, në zbatim të pikës 3, nenit 210, të këtij ligji;

ë) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për përcaktimin e kufijve të Parkut Arkeologjik Durrës, në zbatim të pikës 1, nenit 212, të këtij ligji;

f) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për krijimin, riorganizimin, përbërjen dhe funksionet e muzeve qendrorë, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë

kulturore, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Muzeve, në zbatim të pikës 1, të nenit 214, të këtij ligji. Struktura administrative e këtyre muzeve miratohet me urdhër të Kryeministrit, brenda këtij afati;

g) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për krijimin, riorganizimin, mbylljen e muzeve autonome, pas miratimit në KKM, në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 214, të këtij ligji. Struktura organizative e këtyre muzeve miratohet me urdhër të titullarit të tyre brenda këtij afati;

gj) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë vendimin për shpërblimin e anëtarëve të bordit të akreditimit të muzeve, në zbatim të pikës 2, të nenit 217, të këtij ligji.

Neni 273

Nxjerrja e akteve nënligjore të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore

Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore që brenda:

a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë formatin e deklaratës në lidhje me pasuritë kulturore që subjektet e nenit 200 kanë në posedim, në zbatim të pikës 3, të nenit 200, të këtij ligji;

b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat e mbikëqyrjes, në zbatim të pikës 6, nenit 204, të këtij ligji;

c) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat e mbikëqyrjes, në zbatim të pikës 5, nenit 205, të këtij ligji;

ç) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurat e mbikëqyrjes, në zbatim të pikës 3, të nenit 206, të këtij ligji;

d) 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për formatin e kërkesës, dokumentacionin shoqërues dhe procedurën e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e sekretariatit teknik, në zbatim të neneve 215, pika 1, dhe 218, pika 1, të këtij ligji;

dh) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë formatin e certifikatës së akreditimit, në zbatim të pikës 4, nenit 218, të këtij ligji;

e) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregullat në lidhje me pasurimin e koleksioneve muzeore me prejardhje nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në zbatim të pikës 4, të nenit 224, të këtij ligji;

ë) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për procedurën dhe metodën e rivlerësimit të objekteve muzeore, në zbatim të pikës 4, të nenit 226, të këtij ligji;

f) 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë urdhrin ose të dalë vendimi i institucioneve publike dhe fondacioneve, që kanë në administrim pasuri kulturore, për aksesin e publikut në muze, në zbatim të pikës 2, nenit 233, të këtij ligji;

g) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për përcaktimin e formatit dhe metodën e mbajtjes së dokumentacionit muzeor, si dhe tarifave të shërbimeve për publikun, në zbatim të pikës 3, nenit 236, të këtij ligji;

gj) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për përcaktimin e akteve të nevojshme, kushteve, afatit, garancisë dhe tarifave për ofrimin e shërbimit të mbajtjes në ruajtje/magazininim të përkohshëm të objekteve muzeore, në zbatim të pikës 2, nenit 237, të këtij ligji;

h) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për metodën e mbajtjes së regjistrit të kopjeve të objekteve muzeore, si dhe formën e vërtetimit për një kopje të autorizuar të një objekti muzeor, në zbatim të pikës 6, të nenit 239, të këtij ligji;

i) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë udhëzimin për përcaktimin e kushteve dhe tarifave për riprodhimin e objekteve muzeore, në zbatim të pikave 2 dhe 4, të nenit 240, të këtij ligji.

Neni 274

Nxjerrja e akteve nënligjore të përbashkëta të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrave përgjegjës për fusha të tjera

Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat që brenda:

- a) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për tarifatat dytësore të muzeve, në zbatim të pikës 3, nenit 195, të këtij ligji;
- b) 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për vlerat e tarifave të shërbimeve dhe përdorimin e të ardhurave që krijohen nga ofrimi i shërbimeve të muzeve publikë, në zbatim të pikës 3, të nenit 234, të këtij ligji.

Neni 275

Nxjerrja e akteve nënligjore nga institucione të tjera

1. Ngarkohen këshillat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, Akademia e Shkencave dhe institucionet që kanë muze në varësi të tyre që, brenda 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të kryejnë riorganizimin dhe miratimin e statuteve të muzeve në varësi të tyre, në zbatim të pikës 2, të nenit 214, të këtij ligji, si dhe strukturën administrative të këtyre muzeve.

2. Ngarkohen institucionet e specializuara, organet kolegjiale që, brenda 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të bëjnë hartimin dhe/ose përditësimin e akteve të themelimit dhe atyre të funksionimit të brendshëm, në zbatim dhe në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

TITULLI IV

PARASHIKIME KALIMTARE DHE TË FUNDIT NË LIDHJE ME PJESËN E KATËRT

Neni 276

Hartimi i Planit Kombëtar të Peizazhit

Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore që, brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të hartojë Planin Kombëtar të Peizazhit dhe të propozojë miratimin e tij në Këshillin e Ministrave, në zbatim të pikës 4, të nenit 245, të këtij ligji.

Neni 277

Nxjerrja e akteve nënligjore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore që, brenda 36 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të marrin masa për përshtatjen e dokumenteve ekzistuese të planifikimit, në zbatim të pikës 3, të nenit 243, të këtij ligji.

TITULLI V

AKTE QË SHFUQIZOHEN

Neni 278

Shfuqizime

1. Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Ligji nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
3. Aktet nënligjore të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligji.

4. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

TITULLI VI HYRJA NË FUQI

Neni 279 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.5.2018

Shpallur me dekretin nr. 10806, datë 7.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

